



Misioni i BE-së për Sundimin e Ligjit Raporti i Monitorimit të Drejtësisë

**Gjetjet dhe rekomandimet
Nëntor 2021 – Shtator 2022**

Nëntor 2022



Misioni i BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë – EULEX Raporti i Monitorimit të Drejtësisë

Gjetjet dhe rekomandimet
Nëntor 2021 – Shtator 2022

Nëntor 2022

TABELA E PËRMBAJTJES

Lista e shkurtesave	5
Parathënie	7
1.Hyrje	9
2.Gjetjet e monitorimit sistematik	10
2.1 Ecuria e rasteve të profilit të lartë.....	10
2.2 Trendi në rritje i seancave dëgjimore produktive.....	13
2.3 Zbatimi i dënimeve plotësuese.....	15
2.4 Caktimi i seancave gjyqësore.....	20
2.5 Administrata e gjykatës - Sistemi Informativ i Menaxhimit të Lëndëve.....	21
3. Gjetjet e Monitorimit Tematik	23
3.1 Anti-korrupsioni.....	23
3.2 Korrupsioni në sistemin shëndetësor.....	26
3.3 Krimet nga e drejta ndërkombëtare.....	29
3.4 Dhuna në baza gjinore.....	31
3.5 Ndjekja penale e rasteve të terrorizmit.....	35
3.6 Liria e shprehjes - krimet kundër gazetarëve.....	36
3.7 Drejtësia për të miturit: aplikimi i ‘masave të diversitetit’ për kryerësit e mitur.....	39
3.8 Të drejtat pronësore.....	42
3.9 Privatizimi dhe likuidimi.....	44
Shtojca I – Lista e rasteve të monitoruara dhe të referuara	46
Ish-rastet e EULEX-it.....	46
Ish-rastet e krimeve të luftës të EULEX-it.....	51
Raste që nuk janë trajtuar nga EULEX-i në të kaluarën.....	52
Raste të krimeve të luftës që nuk janë trajtuar nga EULEX-i në të kaluarën.....	55

LISTA E SHKURTESAVE

AKM	Agjencia Kosovare e Mirëbesimit
AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit
AKP	Agjencia Kosovare e Pronës
CAL	Caktimi Automatik i Lëndëve
DHPGJS	Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme
GJA	Gjykata e Apelit
GJEDNJ	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
GJS	Gjykata Supreme
GJTH	Gjykata Themelore
KDM	Kodi i Drejtësisë për të Mitur
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KP	Kodi Penal
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
KPRSFJ	Kodi Penal i Jugosllavisë
KPP	Kodi i Procedurës Penale
LESK	Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Kriminale
LESP	Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale
NJHKL	Njësia për Hetimin e Krimeve të Luftës (PK)
NJHS	Njësia për Hetime Speciale (PK) (ish-TFAK)
PTH	Prokuroria Themelore
PK	Policia e Kosovës
PSRK	Prokuroria Speciale
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
SIML	Sistemi Informativ për Menaxhimin e Lëndëve
SHKK	Shërbimi Korrektues i Kosovës
SHSK	Shërbimi Sprovues i Kosovës
TFAK	Task Forca Anti-Korrupsion (PK)
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

PARATHËNIE

Kam kënaqësinë ta paraqes *Raportin e tretë publik për Monitorimin e Drejtësisë* nga Misioni i BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX). Në vijim të zvogëlimit gradual të mandatit ekzekutiv të tij në fund të vitit 2018, Misioni është angazhuar në një monitorim të fuqishëm të sistemit të drejtësisë në Kosovë. Që nga atëherë, EULEX-i ka nxjerrë pesë Raporte të përgjithshme për Monitorimin e Drejtësisë; dy të parët ishin ndarë vetëm me gjyqësorin dhe institucionet me përgjegjësi specifike në sektorin e sundimit të ligjit, ndërsa raportet e nxjerra nga viti 2020 janë bërë publike për të siguruar që qytetarët dhe shoqëria civile të kenë mundësinë që ta kuptojnë më mirë se si zbatohet sundimi i ligjit në Kosovë. Si pjesë e një varg raportesh publike për fushat eaktuara të sundimit të ligjit, për më shumë, në korrik të këtij viti Misioni e publikoi një raport duke u fokusuar në trajtimin e rasteve të dhunimit nga sistemi i drejtësisë në Kosovë.

Duke siguruar që raportet tona të jenë në dispozicion në gjuhën shqipe, serbe, angleze, kurse këtë vit për herë të parë edhe në alfabetin Braille, Misioni EULEX është duke mëtuar që të kontribuojë në angazhimet e vazhdueshme për ta forcuar sistemin e drejtësisë në Kosovë. Si Mision, ne jemi të vendosur që të sigurojmë transparencë lidhur me punën tonë dhe të nxisni një debat publik të mirë-informuar lidhur me mjetet juridike konkrete për ta përmirësuar llogaridhënien dhe ndarjen më efikase të drejtësisë, duke përmendur dhe nxjerrë shembuj konkret dhe rekomandime specifike që synojnë përmirësimin e sundimit të ligjit.

Mbështetja e sundimit të ligjit ka të bëjë, në fund të fundit, me veprimet e përditshme të individëve, të cilët për shkak të pozitës dhe përgjegjësisë të tyre që i kanë në institucione të ndryshme dhe në shoqërinë civile mund ta bëjnë ndryshimin, për të mirë apo për të keq, në jetën e grave, burrave, vajzave dhe djemve të Kosovës. Ndërsa institucionet dhe ata që e zbatojnë ligjin, siç janë gjyqtarët dhe prokurorët, duhet të japin llogari për veprimet e tyre, të gjitha pjesët e shoqërisë, përfshirë organizatat e shoqërisë civile, mediat dhe qytetarët e informuar kanë një rol për ta luajtur në promovimin llogaridhënies, transparencës dhe efikasitetit të drejtësisë.

Në përgjithësi, ky raport i identifikon disa zhvillime të fundit dhe relativisht inkurajuese në zbatimin e drejtësisë në Kosovë andaj Misioni është i kënaqur kur sheh se disa nga rekomandimet e raporteve të mëparshme janë duke u zbatuar nga gjyqësori. Kështu, për shembull, shkalla e seancave joproduktive nga ato që janë monitoruar nga Misioni ka rënë dhe disa raste të profilit të lartë të monitoruara janë duke u trajtuar në mënyrë më aktive.

Pavarësisht nga disa prej këtyre përmirësimeve, instrumentet në dispozicion për ta luftuar korrupsionin vazhdojnë të mos shfrytëzohen sa duhet, përfshirë aplikimin e masave të diversitetit; gjithashtu shumë raste të korrupsionit të profilit të lartë vazhdojnë të vuajnë nga ngecjet; kurse progresi në ndjekjen e krimeve të luftës është i kufizuar në një numër të vogël të rasteve. Për më tepër, ndarja e drejtësisë në rastet e kërcënimeve kundër gazetarëve dhe dhunës në baza gjinore është jo konsekuente ku drejtësia aplikohet në mënyrë të pabarabartë. Bashkëpunimi dhe koordinimi ndërmjet pjesëve të ndryshme të gjyqësorit, si dhe brenda institucioneve si Policia e Kosovës dhe prokuroria, ndonjëherë gjithashtu mungon.

Sikur në raportet e mëparshme, ky raport nuk do ishte i mundur pa bashkëpunimin dhe angazhimin e institucioneve përkatëse të Kosovës. Ai ka për synim që, në përputhje me mandatin e EULEX-it si Mision për Sundimin e Ligjit, t'i ndihmojë edhe më tej autoritetet e Kosovës në përmirësimin e funksionimit të sistemit të drejtësisë. Ne besojmë se ai do të pranohet nga homologët tanë vendas në frymën e njëjtë konstruktive sikur edhe raportet e mëparshme dhe do kontribuojë në avancimin e Kosovës në rrugëtimin evropian të saj.

Lars-Gunnar Wigemark

1. HYRJJE

Sikur edhe raportet pararendëse, ky Raport për Monitorimin e Drejtësisë e bën vlerësimin e aspekteve specifike të funksionimit të tërë zinxhirit të drejtësisë penale – në fazat policore, të prokurorisë dhe gjykatave – duke e kombinuar një perspektivë sistematike dhe tematike të pasqyruar në strukturën e këtij Raporti.

Pjesa e titulluar “Monitorimi Sistemik” ka të bëjë me çështjet e identifikuar kryesisht, ndonëse jo ekskluzivisht, nëpërmjet monitorimit të rasteve individuale, të cilat tregojnë për probleme që ka mundësi të jenë të natyrës më të gjerë dhe sistematike. Në këtë raport, kjo e përfshin ecurinë në rastet e profilit të lartë, raportin e seancave gjyqësore produktive kundrejt atyre joproduktive, zbatimin e dënimeve plotësuese, caktimin e seancave gjyqësore, si dhe zbatimin e sistemit informativ për menaxhimin e lëndëve.

Pjesa e titulluar “Monitorimi Tematik” fokusohet në çështjet e identifikuar nëpërmjet monitorimit të trajtimit të llojeve specifike të veprave penale, si korrupsioni, dhuna në baza gjinore, terrorizmi dhe krimet sipas të drejtës ndërkombëtare. Ajo gjithashtu i përfshin fushat e reja të cilat nuk ishin përfshirë në raportet e mëparshme si veprat kundër gazetarëve dhe aplikimin e masave të diveritetit ndaj të miturve në kontakt me ligjin. Kjo pjesë gjithashtu përfshin një kapitull për procedimin e rasteve civile lidhur me disa lloje të kontesteve pronësore.

Sikur në raportet e mëparshme, gjetjet për secilën prej çështjeve të analizuar shoqërohen me rekomandime të përshtatura për autoritetet përkatëse lidhur me mënyrat për adresimin e disa aspekteve të caktuara ku janë identifikuar mangësitë.

Gjetjet dhe rekomandimet e përfshira në këtë raport bazohen në monitorimin e rreth 300 rasteve, si dhe në të dhënat dhe informacionet e marra nga institucionet përkatëse dhe nga konsultimet me zyrtarët e policisë, prokurorive dhe gjykatave, si dhe anëtarëve të shoqatave të avokatëve dhe shoqërisë civile.

Një pasqyrë e të gjitha rasteve gjyqësore të përmendura dhe referuar në këtë raport është paraqitur në Shtojcën e Rasteve.

Shumica e gjetjeve kanë të bëjnë me periudhën nëntor 2021 deri në shtator 2022; megjithatë, raporti gjithashtu përfshin informata për zhvillimet që kanë ndodhur edhe pas kësaj date për shkak të rëndësisë së tyre.

2. GJETJET E MONITORIMIT SISTEMATIK

2.1 Ecuria e rasteve të profilit të lartë

Gjatë periudhës raportuese, EULEX-i vazhdoi të monitorojë nga afër rastet e profilit të lartë, duke e përcjellë progresin e tyre dhe rekomandimet e dhëna nga Misioni për gjyqësorin në *Raportet e mëparshme të Monitorimit të Drejtësisë*. Për qëllime monitorimi, EULEX-i i klasifikon si ‘raste të profilit të lartë’ ato raste në të cilat të pandehurit kishin pozita të larta politike ose administrative, akuzat e ngritura kundër tyre kishin të bënin me grupe të mëdha, të organizuara, vepra të rënda penale dhe dëme me vlerë të lartë, si dhe raste të trajtuara më parë nga EULEX-i dhe që janë ende në proces. Veprat kryesore penale kanë të bëjnë, *ndër të tjera*, me krimin e organizuar, korrupsionin e nivelit të lartë ose krimet e dhunshme. Për shkak të numrit të madh të rasteve të tilla, Misioni ka kapacitet të monitorojë vetëm disa prej tyre.

Më parë, EULEX-i kishte vërejtur se një numër i konsiderueshëm i rasteve të monitoruara të profilit të lartë po shënonin një ritëm të ngadaltë të procedurave, pjesërisht për shkak të ndikimit të pandemisë COVID-19 në punën e prokurorive dhe gjykatave. Hetimet dhe procedurat gjyqësore të gjata në këto raste kontribuojnë në perceptimin e publikut se shkelësit e profilit të lartë përjashtoheshin nga pasojat ligjore për veprimet e paligjshme dhe se rastet përkitazi me veprat e lidhura me korrupsionin kishin trajtim preferencial nga sistemi i drejtësisë. EULEX-i është i kënaqur që ka parë ndryshime gjatë kësaj periudhe raportuese, ku disa raste të profilit të lartë tani janë aktive pasi kishin qëndruar në heshtje për periudha të gjata.

Raste të profilit të lartë që po shënojnë progres

Në ish-rastin e EULEX-it *Olympus I* (i njohur edhe si *rasti Toka*), në të cilin të pandehurit u paditën në vitin 2016 me akuzën se kishin fituar në mënyrë të paligjshme pronësinë e tokës në pronësi shoqërore dhe pronave të tjera, procedurat e monitoruara të gjykimit po regjistronin një ritëm produktiv deri sa puna e gjykatës u ndikua nga zbatimi i masave për pandeminë. Në afërsi të përfundimit të gjykimit, procedurat hynë në një ritëm të ngadaltë të shkaktuar nga ndryshimet në përbërjen e trupit gjykues, pasi një gjyqtar ndërroi jetë. Në vitin 2022, u caktua një gjyqtar i ri për këtë rast. Ai caktoi dy seanca në qershor të vitit 2022 dhe gjykimi duhej të niste nga fillimi, siç e parasheh ligji për rastet në të cilat nuk ishte zhvilluar asnjë aktivitet për tre muaj apo më shumë radhazi. Gjithashtu, dy nga të pandehurit që kishin qenë në paraburgim për një periudhë shumë të gjatë (më shumë se gjashtë vjet), u liruan në arrest shtëpiak në qershor 2022, gjë që shënoi një zhvillim të rëndësishëm. Në *Raportin* e tij të mëparshëm të *Monitorimit të Drejtësisë*, të publikuar në dhjetor 2021, Misioni kishte vënë në dukje tashmë se si kohët e gjata të paraburgimit në procedurat paraprake ngrejnë shqetësime serioze për të drejtat e njeriut.

Një ritëm i ngjashëm i rritur i procedurave u regjistrua në ish-rastin e EULEX-it *Olympus II*, i cili është i lidhur me rastin e sipërpërmendur *Olympus I (Rasti Toka)*. Në rastin *Olympus II*, 16 të pandehur akuzohen kryesisht për pastrim parash bazuar në aktakuzën e ngritur në vitin 2016. Pasi Gjykata e Apelit (GJA) e miratoi ankesën e Prokurorisë Speciale (PSRK) kundër vendimit

fillestar të Gjykatës Themelore (GJTH) të Prishtinës për ta hedhur poshtë aktakuzën në korrik 2021, lënda u kthye për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë më 2 nëntor 2021. Që nga maji 2022, seancat janë zhvilluar rregullisht, kurse më 7 nëntor 2022 gjykata e shkallës së parë shpalli aktgjykimin duke i liruar nga akuza të gjithë të pandehurit.

Në ish-rastin e EULEX-it *Naser Kelmendi*, i pandehuri fillimisht ishte akuzuar në vitin 2014 për krim të organizuar, vrasje të rëndë, posedim, shpërndarje ose shitje e paautorizuar e narkotikëve dhe prodhim dhe përpunim i paautorizuar i narkotikëve. Aktgjykimi fillestar është dhënë në vitin 2018 dhe procedurat e rigjykimit kanë filluar në vitin 2019. Kjo u pasua me një periudhë të konsiderueshme pasiviteti deri në fillim të vitit 2022, kur u caktuan disa seanca gjyqësore. Kështu, procedurat rifilluan gjatë periudhës raportuese, duke i dhënë fund pothuajse tre viteve të pasivitetit.

Në ish-rastin e EULEX-it *Grande I* dhe *Grande II*, një grup të pandehurish, përfshirë djalin e presidentit të ndjerë Rugova, u akuzuan në vitin 2016 për disa vepra penale ku dyshohej se nëpërmjet mjeteve mashtruese kishin blerë nga Ambasada e Italisë viza Schengen për individë nga Kosova. EULEX-i monitoroi një ritëm relativisht të ngadaltë të procedurave të shqyrtimit gjyqësor para dhe gjatë pandemisë COVID-19, por më vonë, të dyja rastet filluan të regjistrojnë seanca produktive. Që nga prilli i vitit 2021, seancat dëgjimore në rastin *Grande I* janë zhvilluar rregullisht, ndërsa seancat dëgjimore në rastin *Grande II* filluan të caktohen në prill 2022, pasi procedurat kishin qenë në heshtje për dy vjet.

Ish-rasti i EULEX-it *City Club* gjithashtu ka përparuar gjatë periudhës raportuese. Rigjykimi filloi në Gjykatën Themelore të Gjakovës më 23 nëntor 2020 dhe më pas u mbajtën më shumë se 20 seanca. Aktgjykimi është shpallur më 14 mars 2022. I pandehuri është dënuar me dënim të përgjithshëm prej 24 vitesh burg për vrasje të rëndë, tentativë për vrasje të rëndë, shkakim të rrezikut të përgjithshëm dhe mbajtje dhe përdorim të paligjshëm të armës. Në shtator 2022, EULEX-i u informua se aktgjykimi iu dorëzua palëve dhe u ankimua.

Rastet *Stenta* kanë të bëjnë me korrupsionin e nivelit të lartë në shërbimet mjekësore dhe pamundësinë e agjencive të zbatimit të ligjit dhe gjyqësorit për t'i mbrojtur të drejtat e qytetarëve dhe për të siguruar dëmshpërblime për palët e dëmtuara. Rasti fillestar u nda në tre raste, *Stenta I, II dhe III*. Për shkak të numrit të madh të pandehurve dhe për shkak se disa prej tyre mungonin shpesh në seancat gjyqësore për shkak të sëmundjes, *Stenta II* u nda gjithashtu në dy pjesë, *Stenta II.1* dhe *Stenta II.2*, kjo e fundit ka të bëjë me të pandehurit që mungonin. Kryetari i trupit gjykues e shtyu përpara rastin *Stenta I* dhe caktoi seanca të rregullta dëgjimore gjatë pranverës dhe verës së viti 2022, gjë që mundësoi përfundimin e rigjykimit në fund të korrikut. Aktgjykimi u shpall më 1 gusht, ku të dy të pandehurit u shpallën të pafajshëm edhe një herë. Të gjitha rastet e tjera *Stenta* janë ende në ngecje.

Raste të profilit të lartë pa përparim të dukshëm

Gjatë periudhës së raportimit, disa raste të profilit të lartë mbetën me ritme të ngadalta ose të heshtura. Siç u theksua më lart, rasti *Stenta II.1* po përparonte deri në maj 2022, megjithëse mjaft ngadalë, me seanca të shumta që u shtynë për shkak të mungesës së të pandehurve. Gjithashtu, për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore të kryetarit të trupit gjykues, që atëherë nuk janë caktuar

seanca të reja. Në rastin *Stenta II.2*, në të cilin akuzohen gjashtë të pandehur, nuk është mbajtur asnjë seancë produktive që nga tetori i vitit 2021. Seancat janë shtyrë vazhdimisht, kryesisht për shkak të mungesës së të pandehurve, siç thuhet për arsye shëndetësore. Rasti *Stenta III* ka shënuar përparimin më të vogël, ku nuk është caktuar asnjë seancë që nga nëntori 2021.

Në rastin *Drenica I*, procedurat kanë ngecur pasi që Gjykata Supreme (GJS) e ktheu lëndën në Gjykatën Themelore të Mitrovicës për rigjykim në qershor të vitit 2018. Ky është një rast i mëparshëm i EULEX-it në të cilin të pandehur të profilit të lartë akuzoheshin se kishin kryer Krime të luftës kundër popullatës civile ndërmjet qershorit dhe shtatorit 1998 në lidhje me Qendrën e Paraburgimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në Likoc të Skenderajt. Pas qershorit të vitit 2018, Gjykata Themelore e Mitrovicës ka tentuar ta transferojë këtë lëndë të ndjeshme në një gjykatë tjetër, gjë që është refuzuar. Kanë kaluar më shumë se katër vjet që kur GJS-ja e dërgoi rastin për rigjykim në Gjykatën Themelore të Mitrovicës pa pasur asnjë progres.

Ish-rasti i EULEX-it *Toka 4*, ku aktakuza u ngrit në vitin 2016 kundër një grupi të madh të pandehurish për pronësi të paligjshme të tokës në pronësi shoqërore, dhe që lidhet me rastin *Olympus I* dhe Rastin *Olympus II*, është një shembull tjetër i një rasti të profilit të lartë, i cili prej disa vitesh është i heshtur. Edhe pse vlera e lartë e rastit është dashur ta shtyjë gjykatën që të jetë më e zellshme në sigurimin e menaxhimit efikas të procedurës së shqyrtimit gjyqësor, në këtë rast nuk është vërejtur ndonjë zhvillim domethënës. Rasti është në fazën e shqyrtimit kryesor dhe nuk është mbajtur asnjë seancë produktive që nga viti 2019. Në vitin 2022 ishin caktuar dy seanca, por që të dyja është dashur të shtyeshin për shkak të mungesës së prokurorit dhe një anëtari të trupit gjykues, ndërsa pas kësaj nuk janë caktuar seanca shtesë.

Dy të pandehurit e mbetur në ish-rastin e EULEX-it *Arratisja nga Spitali*, të akuzuar për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit, u liruan në shkurt pas rigjykimit, ndërsa aktgjykimi u apelua nga Prokuroria Speciale (PSRK). Rasti ishte ndarë në shkurt të vitit 2020 për t'i përshpejtuar procedurat. Vlen të përmendet se pjesa e ndarë lidhur me akuzat për frikësim të dëshmitarëve, ka mbetur joaktive, pa u mbajtur as edhe një seancë e vetme.

Asnjë progres i rëndësishëm nuk është shënuar që nga viti 2020 në ish-rastin e EULEX-it *Medicus*. Pas më shumë se një viti pasiviteti për shkak të vështirësisë në gjetjen e numrit të konsiderueshëm të të dëmtuarve dhe dëshmitarëve, seanca është caktuar më 1 mars 2022, por është dashur të anulohet për shkak të grevës së stafit të administratës në Gjykatën Themelore të Prishtinës. Gjithashtu, gjykimi u vonua në mënyrë të përsëritur, pjesërisht për shkak të kërkesave të gjyqtarit për t'u larguar nga lënda për arsye të ndryshme, të cilat përfundimisht u refuzuan nga kryetari i Gjykatës Themelore. Më në fund u zhvillua një seancë dëgjimore më 9 shtator dhe rasti pritej të merrte hov. Megjithatë, në seancën e mbajtur më 2 nëntor, të gjitha palët u pajtuan se aktakuza duhej të ndryshohej, gjë që do të rezultojë në një zvarritje të mëtejme të konsiderueshme të procedurës.

Detaje shtesë për të gjitha rastet e përmendura më sipër mund të gjenden në Shtojcën në fund të këtij raporti.

Rekomandime:

- Prokuroritë dhe gjykatat duhet të monitorojnë në mënyrë më sistematike procedimin e rasteve të profilit të lartë, t'i bëjnë të ditura procedurat jashtëzakonisht të gjata dhe rigjykimet e përsëritura, t'i identifikojnë shkaqet e këtyre vonesave dhe t'i korrigojnë ato.
- Gjyqësori i Kosovës duhet t'i jep prioritet rasteve që tërheqin interes të konsiderueshëm publik dhe mediatik, si dhe rastet që përfshijnë korrupsion të nivelit të lartë dhe politikanë apo figura të tjera publike, në përputhje me *Planin Strategjik të KGJK-së për Zgjidhjen Efikase të Lëndëve të Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar 2022-2024*¹.

2.2 Trendi në rritje i seancave dëgjimore produktive

Për ta garantuar të drejtën për një gjykim të drejtë brenda një kohe të arsyeshme në përputhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), është me rëndësi të kufizohet për aq sa ka mundësi numri i seancave që shtyhen pa çuar në ndonjë progres domethënës në procedurë. Një seancë dëgjimore mund të konsiderohet 'produktive' kur mbahet siç është planifikuar dhe është bërë përparim drejt gjykimit, për shembull, kur paraqiten kërkesa ose kundërshtime ndaj provave, të pandehurit, palët e dëmtuara ose dëshmitarët ekzaminohen, ose kur jepen argumentet hapëse dhe përfundimtare. Nga ana tjetër, një seancë konsiderohet 'joproduktive' kur shtyhet pa ndonjë përparim domethënës.


Pas gjetjeve të publikuara në *Raportet e mëparshme të Monitorimit të Drejtësisë*, EULEX-i ka vazhduar ta monitoroj nga afër raportin e seancave produktive ndaj atyre joproduktive në rastet që i monitoron. Në periudhën nëntor 2021 deri në gusht 2022, EULEX-i ka monitoruar gjithsej 352 seanca, prej të cilave 91 ishin joproduktive (26%). Siç u theksua në Raportin e mëparshëm të *Monitorimit të Drejtësisë*, raporti i seancave joproduktive të regjistruara nga Misioni midis marsit 2020 dhe tetorit 2021 ishte 30%². Kjo rënie mund t'i atribuohet përkushtimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) për ta adresuar këtë çështje pas rekomandimeve të EULEX-it për këtë çështje.

Dy arsyt kryesore që çuan në seanca joproduktive gjatë periudhës raportuese mbetën mungesa ose kërkesa e të pandehurit për shtyrjen e seancës (39 seanca gjyqësore), të pasuara nga mungesa ose kërkesa e avokatëve mbrojtës për shtyrjen e seancës, kryesisht me pretendimin se kishin nevojë për më shumë kohë për ta përgatitur rastin ose duke deklaruar se ishin të sëmurë (15 seanca gjyqësore). Disa seanca u desh të shtyheshin për shkak të mungesës së prokurorëve, gjyqtarëve, dëshmitarëve, ekspertëve apo palëve të dëmtuara.

¹ 'Plani strategjik i KGJK-së për zgjidhjen efikase të lëndëve të korrupsionit dhe krimin të organizuar 2022-2024', https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/decisions/44297_Vendimi_KGJK_se_Nr_292_2021_Miratohet_Plani_Strategjik_per_Zgjidhjen_Efikase_te_Lendeve_te_Korrupsionit_dhe_Krimin_te_Organizuar_2022-2024.pdf, uebsajti i KGJK vetëm në versionin shqip, KGJK, tetor 2021, (qasur më 3 tetor 2022).

² Në periudhën e mëparshme të raportimit, shumë seanca u shtynë si rezultat i kufizimeve të lidhura me pandeminë ose për shkak të pretendimeve se palët ishin të infektuara me virusin.

Arsyet e seancave joproductive



EULEX-i gjithashtu vërejtë se kur një palë mungonte në seancë, në shumicën e rasteve nuk jepej arsyeja e mungesës, ose të paktën nuk ishte me shkrim, një aspekt ky që shpesh u shpërfill nga gjykatat. Në një aspekt pozitiv, në rastin *Grande II*, trupi gjykues i gjobiti dy avokatë mbrojtës me nga 200 euro secilin për mungesën e tyre të paarsyetuar, gjë që nuk kishte ndodhur më parë. EULEX-i kishte rekomanduar fuqimisht, përfshirë edhe në Raportin e fundit të *Monitorimit të Drejtësisë*, që gjykatat të përdorin masat ndëshkuese të parashikuara nga Kodi i *Procedurës Penale* (KPP) për të sanksionuar palët që shkaktojnë vonesa të paarsyetuara në procedurë³.

Nga gjithsej 352 seanca të monitoruara gjatë periudhës raportuese, 169 kishin të bënin me raste të profilit të lartë. Në këtë grup, 31% (53 seanca) ishin joproductive, që është numër relativisht i lartë duke pasur parasysh se këto raste duhet të gjykohen me shpejtësi për shkak të peshës së veprave penale ose profilit të pandehurve (në përputhje me kornizën rregullative të KGJK-së siç u përmend më lart). Nga ana pozitive, raporti i seancave joproductive në rastet e krimeve të luftës ishte më i ulët, përkatësisht 21% (4 nga 19).

Rekomandime:

- Gjyqtarët duhet të jenë më të thuktë në verifikimin e arsyeve të mungesës së palëve dhe në zbatimin e masave të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, përfshirë masat ndëshkimore dhe disiplinore.
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe kryetarët e gjykatave duhet të mbajnë shënim rastet kur nuk zbatohen masat ligjore dhe të kërkojnë përgjegjësi nga gjyqtarët përkatës.
- Gjykatat duhet të kërkojnë përgjegjësi nga prokurorët për vonesat ose mungesat e tyre të paarsyetuara, duke njoftuar Kryeprokurorin e prokurorisë përkatëse.
- Gjykatat duhet të gjobisin avokatët mbrojtës për zvarritjen e procedurave dhe të njoftojnë Odën e Avokatëve.

³ Kodi i Procedurës Penale, 04/L-123, i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013, neni 64, i autorizon gjykatat që të gjobisin avokatët për vonimin e procedurës me shumë deri në 250 euro dhe gjithashtu i detyron të njoftojnë Odën e Avokatëve. Kur vonesa të tilla shkaktohen nga prokurorët, gjykatave u kërkohet të njoftojnë Kryeprokurorin e prokurorisë së tyre përkatëse. [PENALE NR. 04/L-123 KODI I PROCEDURËS \(rks-gov.net\)](#) (qasur më 16 shtator 2022). Kodi i Procedurës Penale, 08/L-032, i publikuar më 17 gusht 2022, i cili do të hyjë në fuqi më 17 shkurt 2023, neni 65, parasheh të njëjtat masa, ndërsa gjobën e ka ngritur në 1000 euro. (qasur më 22 tetor 2022).

2.3 Zbatimi i dënimeve plotësuese

EULEX-i ka vazhduar monitorimin e zbatimit të sanksioneve penale, një element i rëndësishëm por shpesh i anashkaluar në zinxhirin e drejtësisë penale. Për qëllime të këtij raporti, EULEX-i është fokusuar në zbatimin e dënimeve plotësuese. Dënimet plotësuese kanë për qëllim forcimin e efektit të dënimeve kryesore (si ato kryesore ashtu edhe ato alternative) dhe mund të shqiptohen vetëm në lidhje me to⁴.

Neni 59 i *Kodit Penal*⁵ përcakton një listë me tetë lloje të ndryshme të dënimeve plotësuese, duke përfshirë *ndalimin e ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik* (paragrafi 2.3.) dhe *ndalimin e ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës* (paragrafi 2.4.). Nenet 62 dhe 63 rregullojnë më tej këto dy dënime plotësuese. Për shembull, këto nene specifikojnë nëse dënimi plotësues është i detyrueshëm dhe përcaktojnë intervalin e periudhës kur një personi i ndalohet të ushtrojë funksione publike, në varësi të llojit të veprës dhe nëse kryerësit i është shqiptuar dënimi me burgim, dënimi me kusht ose gjoba. Në *Kodin Penal* të vitit 2019, u futën dispozita të reja në nenet 62⁶ dhe 63⁷, të cilat e bënë të detyrueshëm shqiptimin e dy dënimeve plotësuese të përmendura, *ndër të tjera*, në rastet e korrupsionit dhe dhunës në familje. Duke marrë parasysh rëndësinë e këtyre kategorive të veprave, EULEX-i e ka fokusuar monitorimin e tij në aplikimin dhe zbatimin e dënimeve plotësuese të shqiptuara në lidhje me aktgjykimet për raste të korrupsionit.

Si konstatim i përgjithshëm, EULEX-i ka vërejtur mospërputhje dhe mungesë të praktikave të standardizuara në zbatimin e këtyre dy kategorive të dënimeve plotësuese. Për shembull, bazuar në hulumtimin e të gjitha Gjykatave Themelore (GJTH), duket se ka mungesë të përgjithshme të mirëkuptimit në mesin e stafit lidhur me konceptin e dënimeve plotësuese dhe përgjegjësitë e personelit në lidhje me zbatimin e tyre. Për më tepër, Misioni konstatoi se zbatimi i sanksioneve penale nuk trajtohej në mënyrë konsekuente si përgjegjësi e zyrtarit ekzekutues për sanksionet kriminale në GJTH dhe se kjo detyrë shpesh shpërndahej ndërmjet zyrave apo stafit të ndryshëm. Në Raportin e tij të mëparshëm të *Monitorimit të Drejtësisë* në dhjetor 2021, EULEX-i theksoi nevojën për të definuar më mirë rolin dhe përgjegjësitë e zyrtarit ekzekutues për sanksionet penale në zbatimin e këtyre sanksioneve, përfshirë dënimet plotësuese; gjetjet e Misionit tregojnë se progresi në këtë drejtim ishte i papërfillshëm.

EULEX-i gjithashtu vuri në dukje se shumica e gjykatave nuk i zbatuan dy dispozita specifike në *Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale* (LESP), të cilat e adresojnë zbatimin e dy

4 Kodi Penal, 06/L-074, 14 janar 2019, neni 40, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413> (qasur më 16 shtator 2022): Dënimet kryesore janë 1) dënimi me burgim të përjetshëm, 2) dënimi me burgim dhe 3) dënimi me gjobë; Neni 41: Dënimet alternative janë 1) dënim me kusht, 2) dënim me gjysmë liri dhe 3) urdhër për punë në dobi të përgjithshme.

5 Kodi Penal, 06/L-074, 14 janar 2019, neni 59, paragrafi 2, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413> (qasur më 16 shtator 2022): Dënimet plotësuese janë: 1) heqja e të drejtës për t'u zgjedhur, 2) urdhër për të paguar dëmshpërblim për humbjen ose dëmin, 3) ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratë publike ose shërbimin publik, 4) ndalimi i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, 5) ndalimi i drejtimit të mjetit motorik, 6) konfiskimi i patentë shoferit, 7) urdhri për publikimin e aktgjykimet dhe 8) dëbimi i të huajit nga Kosova.

6 Kodi Penal, 06/L-074, 14 janar 2019, neni 62, paragrafi 3, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413> (qasur më 16 shtator 2022): Gjykata e ndalon personin zyrtar të ushtrojë funksionin e tij/saj në funksionet e administratës publike ose në shërbimin publik për një (1) deri në dhjetë (10) vjet pas vuajtjes së dënimit me burgim, nëse personi është dënuar për ndonjë nga veprat penale nga kreu XXXIII (Korrupsioni dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare) të këtij Kodi. Paragrafi 4: Gjykata ia ndalon personit zyrtar të ushtrojë funksionin e tij/saj në administratën publike ose në shërbimin publik për një (1) deri në pesë (5) vjet, nëse i njëjti person është dënuar për dhunë në familje sipas nenit 248 të këtij Kodi.

7 Kodi Penal, 06/L-074, 14 janar 2019, neni 63, paragrafi 4, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413> (qasur më 16 shtator 2022): Gjykata do të ndalojë personin zyrtar të ushtrojë profesion, veprimtari të pavarur, detyrë menaxheriale ose administrative prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet, nëse personi është dënuar për ndonjë nga veprat e kreu XXXIII. (Korrupsioni dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare) të këtij Kodi.

dënimeve plotësuese të lartpërmendura. Neni 160 i LESP-së⁸ parashikon që aktgjykimet që përfshijnë dënimin plotësues për ndalimin e ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik, i dërgohen menjëherë Ministrisë së Administratës Publike⁹, që është institucion i mandatuar për mbikëqyrjen e ekzekutimit të këtij lloji të caktuar të dënimeve plotësuese. Në rast se personi i dënuar nuk e respekton dënimin plotësues, Ministria është e obliguar që ta informojë gjykatën kompetente.

Në mënyrë të ngjashme, neni 161 i LESP-së¹⁰ përcakton se gjykatat janë të detyruara që menjëherë t'i dërgojnë aktgjykimet duke përfshirë ndalimin e ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, *ndër të tjera*, ndërmarrjes publike ose private ku personi i dënuar ka qenë i punësuar dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale¹¹, e cila duhet ta mbikëqyrë ekzekutimin e këtij lloji specifik të dënimit plotësues. U vu re se disa gjykata ia komunikojnë dënimin vetëm institucionit publik ose privat në të cilin ishte i punësuar i dënuari dhe jo Ministrisë, ndërsa gjykatat e tjera nuk e informuan institucionin publik, pasi nga këto gjykata supozohej se institucioni publik përkatës ishte njoftuar tashmë si palë e dëmtuar në procedurë. Megjithatë, ky supozim është kryesisht i gabuar, pasi EULEX-i konstatoi se institucionet publike shpesh e luajnë një rol shumë pasiv në procedurat gjyqësore në të cilat ato kanë cilësinë e palës së dëmtuar, veçanërisht në rastet e korrupsionit¹². Njëra nga gjykatat themelore supozoi se regjistrimi i dënimeve plotësuese në Sistemin Qendror të Dosjeve Penale¹³ ishte i mjaftueshëm, gjë që nuk është. EULEX-i gjithashtu vuri në dukje se dënimet plotësuese shpesh nuk ishin të regjistruara siç duhet ose në mënyrë të pasaktë në këtë Sistemi Qendror të Dosjeve Penale.

Si Ministria e Punëve të Brendshme, ashtu edhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e kanë informuar EULEX-in se asnjëra prej tyre nuk ka marrë ndonjëherë ndonjë vendim nga gjykatat që i ngarkon me mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve plotësuese në fushën e tyre përkatëse të kompetencës.

EULEX-i më tej ka vërejtur se nuk kishte sistem për mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave përkatëse statistikore për aplikimin dhe zbatimin e dënimeve plotësuese nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) në nivelin qendror apo nga Gjykatat Themelore, gjë e cila ia vështirësoj misionit sigurimin e të dhënave për të bërë një vlerësim. Në funksion të kësaj, Misioni zgjodhi që ta shqyrtojë çështjen nga një këndvështrim tjetër, duke i identifikuar aktgjykimet e rasteve ku dënimi plotësues i ndalimit të ushtrimit të funksioneve në administratën publike apo shërbimin publik është dashur të shqiptohet në pajtim me nenin 62, paragrafi 3 i *Kodit Penal* në aktgjykimet në lidhje me korrupsionin¹⁴. Më pas Misioni verifikoi nëse dënimet plotësuese, të detyrueshme në këto dënime për korrupsion në rast dënimi me burgim, ishin shqiptuar vërtet siç kërkohet me ligj:

8 Emri i ligjit u ndryshua nga LESP në LESK (Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Kriminale). Neni 160 i LESP tani është neni 155 i LESK.

9 Ministria e Administratës Publike është shkruarë në Ministrinë e Punëve të Brendshme në vitin 2020.

10 Emri i ligjit u ndryshua nga LESP në LESK (Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Kriminale). Neni 161 i LESP tani është neni 156 i LESK.


11 Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale tani quhet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

12 Çështja e pasivitetit të monitoruar të institucioneve publike si palë të dëmtuara në rastet e korrupsionit është identifikuar nga Misioni si një tendencë shqetësuese në Raportin e mëparshëm të monitorimit të drejtësisë të dhjetorit 2021.


13 Sistemi aktual i dosjeve penale funksionon bazuar në Rregulloren e KGJK-së 124/2018 - Mbajtja e evidencës për personat e dënuar dhe funksionon bazuar në një mekanizëm koordinues ndërmjet KGJK-së dhe gjykatave. Megjithatë, me mbështetjen e BE-së, aktualisht është duke u ngritur një sistem i ri kombëtar i centralizuar i të dhënave penale. Është një sistem elektronik i vetëm, i unifikuar, më i avancuar për mbajtjen e dosjeve kriminale.

14 Kodi Penal, 06/L-074, 14 janar 2019, neni 62, paragrafi 3, <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/A5713395-507E-4538-BED6-2FA2510F3FCD.pdf>, (qasur më 14 shtator 2022): Gjykata e ndalon personin zyrtar të ushtrorë funksionin e tij/saj në funksionet e administratës publike ose në shërbimin publik për një (1) deri në dhjetë (10) vjet pas vuajtjes së dënimit me burgim, nëse personi është dënuar për ndonjë nga veprat penale nga kreu XXXIII (Korrupsioni dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare) të këtij Kodi.

- Bazuar në vlerësimin e 19 aktgjykimeve fajësuese në bazë të Nenit 414 të *Kodit Penal* (keqpërdorimi i pozitës zyrtare), Misioni ka konstatuar se dënime plotësuese janë shqiptuar në dy aktgjykime, ndërsa në dy aktgjykime dënimi me burgim është pezulluar dhe në 13 aktgjykime dënimi me burgim është shndërruar në gjobë me të cilën është shmangur dënimi plotësues i obligueshëm. Për më tepër, ishin edhe dy aktgjykime ku ka ekzistuar detyrimi për shqiptimin e dënimit plotësues, por që kjo nuk është shqiptuar nga gjykata, duke vepruar kështu në kundërshtim me ligjin.




- Bazuar në vlerësimin e tri aktgjykimeve fajësuese në bazë të Nenit 418 të *Kodit Penal* (përvetësim në detyrë), Misioni konstatoi se dënime plotësuese nuk u shqiptuan. Në dy aktgjykime dënimi me burgim u bë dënim me kusht ose u shndërrua në gjobë me të cilin është shmangur dënimi plotësues. Në një aktgjykim ekzistonte detyrimi për shqiptimin e dënimit plotësues, por që nuk ishte shqiptuar nga gjykata, në kundërshtim me ligjin.




- Bazuar në vlerësimin e tetë aktgjykimeve fajësuese në bazë të Nenit 421 të *Kodit Penal* (marrje ryshfeti), Misioni konstatoi se në dy aktgjykime dënime plotësuese u shqiptuan, ndërsa në dy aktgjykime dënimi me burgim u shndërrua në gjobë me të cilin është shmangur dënimi plotësues. Më tej, ishin tri aktgjykime në të cilat ekzistonte detyrimi për shqiptimin e dënimit plotësues, gjë që u shpërfill nga gjykata, në kundërshtim me ligjin.

Aktgjykime fajësuese Neni 421 Kodi Penal Code




- Bazuar në vlerësimin e tre aktgjykimeve fajësuese në bazë të Nenit 427 të *Kodit Penal* (falsifikimi i dokumentit zyrtar), Misioni konstatoi se nuk ishte shqiptuar asnjë dënim plotësues, pasi në të tre aktgjykimet, dënimi me burgim prej gjashtë muajsh ishte shndërruar në gjobë, me të cilin shmangej dënimi plotësues i obligueshëm. Vlen të përmendet se shtrirja e dënimit me burgim për këtë vepër është nga gjashtë muaj deri në pesë vjet, që nënkupton se në të tre aktgjykimet është shqiptuar dënim minimal. Gjithashtu, dënimi me burgim prej gjashtë muajsh përben kohëzgjatjen maksimale e cila lejohet të shndërrohet në gjobë. Si përfundim, në të tre aktgjykimet u shqiptuan dënime minimale me burgim dhe të gjitha më vonë u shndërruan në gjobë, gjë që rezultoi me shmangje të zbatimit të detyrueshëm të dënimit plotësues.

Aktgjykime fajësuese Neni 427 Kodi Penal



- Bazuar në vlerësimin e 44 aktgjykimeve fajësuese në bazë të Nenit 430 të *Kodit Penal* (Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave/hyrave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare), Misioni konstatoi se në dy aktgjykime u shqiptuan dënime plotësuese, ndërsa në 36 aktgjykime si dënim është shqiptuar vetëm gjobë. Në pesë aktgjykime, dënimi me burgim u pezullua apo shndërrua në gjobë me çka është shmangur dënimi plotësues i obligueshëm, ndërsa një aktgjykim me gjobë është pezulluar.



Rekomandime:

- Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) duhet të sigurojë ekzistimin e një sistemi të unifikuar për zbatimin e dënimeve plotësuese. Për këtë qëllim, KGJK-ja duhet t'i qartësojë të gjitha aspektet relevante përmes akteve nënligjore, në të cilat të specifikohen qartë përgjegjësitë e secilit akter.
- KGJK duhet të krijojë një sistem të automatizuar të mbledhjes së të dhënave për dënimet plotësuese dhe zbatimin e tyre përmes Sistemit Informativ për Menaxhimin e Lëndëve (SIML). Për këtë qëllim, duhet të krijohet një fushë specifike e të dhënave në SIML që të përmbajë të gjitha informacionet përkatëse si datën përkatëse të komunikimit të dënimit plotësues, emrat e institucioneve të cilave iu është komunikuar dhe atë të nëpunësit që e ka lëshuar.
- KGJK-ja duhet të sigurojë që Sistemi Qendror i Dosjeve Penale të përmbajë të dhënat e plota lidhur me dënimet plotësuese. Për ta lehtësuar këtë, duhet të krijohet një fushë specifike e të dhënave në këtë sistem për të përfshirë informacionin e detyrueshëm për ekzistencën e një dënimi plotësues, natyrën e tij dhe kohëzgjatjen specifike.
- KGJK-ja duhet t'i udhëzojë gjykatat që t'ua komunikojnë me kohë dënimet plotësuese institucioneve përkatëse në përputhje me nenet 160 dhe 161 të LESP-së (tani nenet 150 dhe 156 në LESP-në e ri) dhe duhet të përcjellin rregullisht zbatimin efektiv të neneve 62 dhe 63 të *Kodit Penal*.
- KGJK-ja duhet të krijojë një mekanizëm monitorues për të vlerësuar nëse gjyqtarët i zbatojnë dënimet e detyrueshme plotësuese sipas nenit 62 dhe 63 të *Kodit Penal* dhe të vërtetojnë nëse në rastet e korrupsionit gjykatat tentojnë të konvertojnë dënimet me burgim në gjobë, duke çuar jo vetëm në shmangien e dënimeve me burgim, por edhe për shmangien e zbatimit të detyrueshëm të dënimeve plotësuese.

2.4 Caktimi i seancave gjyqësore

Kohëzgjatja e tepruar e procedurave gjyqësore dhe ndikimi i kësaj në të drejtën për gjykim brenda një kohe të arsyeshme, siç garantohet me Nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, është një çështje që përsëritet në Kosovë. Intervalet e tej zgjatura dhe të paarsyetuara ndërmjet seancave gjyqësore mund të jenë një nga shkaqet e vonesave të paarsyeshme. Prandaj, caktimi i seancave gjyqësore bëhet një aspekt i rëndësishëm për sigurimin e ecurisë efikase të procedurës gjyqësore.

Është praktikë e zakonshme që gjykatat në Kosovë të mos i caktojnë të gjitha seancat në fillim të gjykimit. Në shumë raste, data e seancave të ardhshme caktohet pas çdo seance gjyqësore, apo edhe më vonë.

Ka shumë çka që mund të përfitohet duke mbajtur shqyrtimin gjyqësor sa më konciz. Për shembull, palëve dhe trupit gjykues do t'u duhej më pak kohë për t'u përgatitur para çdo seance, marrja në pyetje e palëve, dëshmitarëve dhe ekspertëve mund të ishte më koherente dhe në përgjithësi, do të kishte më pak nevojë për përsëritjen e veprimeve në procedurë. Prandaj, plani për caktimin e të gjithë shqyrtimit gjyqësor duhet të miratohet që në fillim të procedurës gjyqësore. Nëse kjo nuk është e mundur, seanca vijuese duhet të caktohet sa më shpejt që të jetë e mundur dhe mundësisht të caktohen disa seanca të njëpasnjëshme¹⁵. Caktimi i disa seancave paraprakisht e bën gjithashtu më të mundshme që të gjitha palët të marrin pjesë në to, duke qenë se ato janë tashme të informuara për datat shumë më përpara. Kjo nga ana tjetër është e favorshme për të shmangur vonesat e mëtejshme në procedurë. Caktimi i disa seancave të njëpasnjëshme paraprakisht ka rezultuar të jetë i një rëndësie të veçantë për gjykimet me një numër të madh të pandehurish, pasi këto gjykime në mënyrë joproporcionale janë të prira që të vuajnë nga seancat joproduktive, dhe rrjedhimisht vonesa të mëtejshme për shkak të mungesës së një apo të më shumë të pandehurve. Në fund të fundit, i gjithë shqyrtimi gjyqësor duhet të planifikohet dhe caktohet në një fazë të hershme ku të gjitha palët duhet të jenë të përkushtuar për shqyrtimin gjyqësor konkret deri në përfundimin e tij.

Gjatë periudhës nëntor 2021 deri në korrik 2022, EULEX-i e ka përcjellë caktimin e seancave gjyqësore në shqyrtimet kryesore në proces që janë monitoruar nga Misioni. Nga 179 seanca në të cilat ishte caktuar seanca gjyqësore, seanca në vijim është caktuar brenda një muaji në 79 raste (44%), brenda dy muajve në 81 raste (45%) dhe brenda më shumë se dy muajve në 19 raste (11%). Në 109 raste (61%), ishte caktuar vetëm një seancë e radhës, kurse në 70 raste (39%) u caktuan dy ose më shumë seanca të radhës.

Rekomandime:

- Gjykatat duhet të caktojnë seancën e radhës brenda një muaji sa herë që kjo është e mundur.
- Në gjykimet që kanë të bëjnë me një numër të madh të pandehurish, gjykatat duhet të planifikojnë disa seanca një pas një gjatë ditëve të radhës, pasi kjo ka rezultuar se e rrit efikasitetin në zhvillimin e këtyre gjykimeve.
- Gjykatat duhet të miratojnë një plan për të caktuar tërë shqyrtimin gjyqësor në një fazë të hershme të procedurës.
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet ta mbikëqyrë dhe monitorojë performancën e gjykatave për sa i përket aftësisë së tij për të planifikuar dhe caktuar seancat e gjykimit si tregues i efikasitetit.

¹⁵ Rëndësia e caktimit të seancave të njëpasnjëshme përmendet në Planin strategjik të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për zgjidhjen efektive të lëndëve të korrupsionit dhe krimit të organizuar 2022-2024, të miratuar më 18 tetor 2021.

2.5 Administrata e gjykatës - Sistemi Informativ i Menaxhimit të Lëndëve

EULEX-i ka vazhduar të monitorojë zbatimin e Sistemit Informativ të Menaxhimit të Lëndëve (SIML) nëpër gjykatat e Kosovës. SIML është sistem elektronik i cili ruan të dhëna të ndryshme të lëndëve, duke mundësuar qasjen më të shpejtë në dosjet gjyqësore dhe përditësimet e rasteve.

EULEX-i ka vërejtur se SIML është futur në zbatim dhe është funksional në të gjitha gjykatat, ndërsa Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme për Çështje të Privatizimit (DHPGJS) ishte e fundit që e futi në zbatim. Trajnimi fillestar për SIML për stafin e DHPGJS filloi në prill.

Aspektet pozitive të zbatimit të SIML u vërtetuan vazhdimisht nga përdoruesit e tij nëpër gjykata. Shumica e gjyqtarëve konfirmuan dobinë e sistemit për rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe sigurisë në gjykata. Megjithatë, ende ekzistojnë disa sfida. Gjyqtarët ankohen për nevojën e kryerjes së hapave procedural shtesë gjatë përdorimit të sistemit, ndërsa të tjerët hasin në vështirësi për përshtatje me teknologjitë e reja. Një problem madhor për DHPGJS është regjistrimi në sistem i shumë lëndëve të vjetra, që e rëndon më tej punën e administratës së gjykatave që veçse ka mungesë të stafit. Ndërsa SIML ofron statistika dhe u lejon gjykatave të gjenerojnë një vëllim të caktuar të dhënash, ai ende nuk është në gjendje të prodhojë të gjithë informacionin e nevojshëm, veçanërisht për natyrën e rasteve specifike dhe për vjetërsinë e tyre.

EULEX-i gjithashtu bëri vlerësim të zbatimit të Modullit të Caktimit Automatik të Lëndëve (CAL) të SIML, i dizajnuar për të eliminuar ndërhyrjet në caktimin e lëndëve. Moduli CAL funksionon pa ndonjë pengesë serioze nëpër gjykatat themelore që nga shkurti i vitit 2020, ndërsa në Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme që nga dhjetori 2021 dhe marsi 2022 përkatësisht. Kjo ka zvogëluar ndjeshëm mundësinë e manipulimit të caktimit të lëndëve, gjë që shpresohet të rrisë besimin e publikut në gjyqësor. Kjo ishte një çështje në veçanti shqetësuese në të kaluarën, siç monitorohej nga EULEX-i, ku rastet e profilit të lartë shpesh i caktoheshin të njëjtit trup gjykues në Gjykatën Themelore të Prishtinës, një shkelje e qartë e detyrimit për caktimi e lëndëve me short, diçka që në atë kohë ende nuk ishte automatizuar.

Sistemi i CAL funksionon plotësisht në GJA dhe GJS kur bëhet fjalë për caktimin automatik të trupave gjykuese me nga tre gjyqtar, por ende jo nëpër gjykatat themelore, në të cilat mund të caktohen automatikisht nga vetëm një gjyqtar. Zhvillimi i mëtejshëm i sistemit ka vazhduar që nga dhjetori i vitit 2021 dhe funksioni që mundëson caktimin automatik të trupave gjykues me nga tre gjyqtarë në gjykatat themelore aktualisht është në fazën e testimit. Mbyllja e këtij boshllëku do të përbënte një hap të rëndësishëm përpara pasi kjo pamundësi e sistemit ka rezultuar në një numër të konsiderueshëm të lartë të lëndëve që ende caktohen manualisht në gjykatat themelore.

EULEX-i gjithashtu vazhdoi të monitorojë zbatimin e regjistrave elektronikë, një modul i prezantuar në fillim të vitit 2021 dhe që synon të zëvendësojë regjistrimin manual të lëndëve që nga janari 2022. Monitorimi nga EULEX-i konstatoi se disa shkrimore nëpër gjykata mbanin librat e regjistrimit në letër paralelisht me SIML, duke pohuar se ato 'iu duheshin për të qenë më të sigurt' ose 'vetëm sa për regjistër'.

EULEX-i bëri vlerësim edhe të ndërveprimit të SIML në mes të Gjykatave Themelore (GJTH) dhe Prokurorive Themelore (PTH), i cili është në funksion që nga 30 shtatori 2020. Është vërejtur se procesi i shkëmbimit të dhënave ishte në përgjithësi i besueshëm gjatë ditëve të punës, por që probleme vazhdonin të ndodhnin në disa PTH/GJTH, veçanërisht gjatë fundjavave dhe në rastet

në procedurë paraprake. Për shembull, PTH shpesh gjatë fundjavave dërgojnë raste në gjykata në kopje fizike për shkak të mungesës së stafit kujdestar në thirrje për regjistrimin e dosjeve në SIML, duke bartur kështu detyrën e regjistrimit të lëndëve në SIML tek stafi i gjykatës.

Për më tepër, siç është raportuar më parë nga EULEX-i, prokuroritë dhe gjykatat themelore ende ndikohen nga mungesa e stafit, shpesh për shkak të procedurave të gjata të rekrutimit, dhe nga numri i pamjaftueshëm i përkthyesve/interpretëve, kryesisht për gjuhën serbe, dhe në Prizren edhe për gjuhën turke.

Një fazë e fundit trevjeçare e projektit SIML (deri në maj 2025), e financuar nga Qeveria Norvegjeze, do të synojë të sigurojë përdorimin e plotë dhe optimal të sistemit SIML në të gjitha gjykatat dhe prokuroritë, siç është qëllimi, në mënyrë që të vazhdohet më tej me përmirësimin e efikasitetit, llogaridhënies dhe transparencës në sistemin e drejtësisë dhe të sigurojë qëndrueshmërinë e SIML. Për më tepër, ai do të synojë të ndihmojë KGJK-në dhe KPK-në në marrjen e përgjegjësisë së plotë për sigurimin e buxhetit të nevojshëm për financimin e projektit SIML në të ardhmen.

Rekomandime:

- Me mbështetjen e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), gjykatat themelore dhe prokuroritë themelore duhet të sigurojnë një sistem të kujdestarive në thirrje gjatë fundjavave me staf të aftë për të përdorur SIML-in.
- KGJK duhet të sigurojë lidhje interneti më të qëndrueshme nëpër gjykata.
- Ministria e Drejtësisë dhe KGJK-ja duhet të sigurojnë që shërbimet e përkthimit dhe interpretimit të organizohen më mirë dhe të mundësojnë procedura më efikase të rekrutimit për përkthyes/interpret.
- KGJK-ja dhe KPK-ja duhet të përmirësojnë proceset e rekrutimit të stafit të gjykatave dhe prokurorive themelore, duke përfshirë një planifikim me kohë të zëvendësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve që pensionohen.

3. GJETJET E MONITORIMIT TEMATIK

3.1 Anti-korrupsioni

3.1.1 Njësia Speciale për Hetime në kuadër të Policisë së Kosovës

Njësia Speciale për Hetime (NJHS) e Policisë së Kosovës (PK) vazhdon të luajë një rol të rëndësishëm në hetimin e rasteve të korrupsionit të profilit të lartë, përkundër faktit se ende nuk ka një bazë të qartë ligjore. NJHS-së iu dha statusi i përkohshëm juridik më 25 nëntor 2020, në bazë të një vendimi të ministrit të atëhershëm të Punëve të Brendshme¹⁶. Në këtë vendim thuhet se Njësia Speciale për Hetime është krijuar me mandat të përkohshëm në kuadër të Departamentit të Hetimeve të Policisë së Kosovës, me autoritet të plotë për të vazhduar hetimin e rasteve të ish-Task Forcës Anti-Korrupsion (TFAK), e cila ishte shpërbërë më 19 tetor 2020 nga Ushtruesi i atëhershëm i Detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës.

Bashkëpunimi ndërmjet NJHS-së dhe Prokurorisë Speciale (PSRK) u zyrtarizua përmes një shkëmbimi letrash ndërmjet PSRK-së dhe PK-së në fund të vitit 2020. Pozicioni i NJHS-së do të rritet edhe më tej nga fakti se roli i saj i rëndësishëm në luftimin e korrupsionit është i qartë në nenin 16 të Projektligjit për Prokurorinë Speciale¹⁷. Megjithatë, këto zhvillime pozitive duhet të plotësohen me sigurimin e një baze të duhur ligjore për NJHS, e cila kërkon ndryshime në Ligjin për Policinë.

Misioni ka vërejtur me shqetësim se entitetet tjera brenda PK-së nuk i ofrojnë NJHS-së informacione relevante në mënyrë sistematike dhe të rregullt. Për shembull, pak raste janë referuar në NJHS nga Drejtoria e Inteligjencës dhe Analizës së PK-së dhe nga Agjencia Kosovare e Inteligjencës, kurse pothuajse të gjitha rastet e hetuara nga NJHS-ja janë të iniciuara nga vetë ajo. Për më tepër, EULEX-i konstatoi se qasja e NJHS-së në informatat e mbajtura nga agjencitë e tjera, si Administrata Tatimore, Dogana dhe Njësia e Inteligjencës Financiare, e cila është njësi e pavarur në kuadër të Ministrisë së Financave, ishte e kufizuar dhe e penguar nga mungesa e bashkëpunimit. Fakti që NJHS nuk ka një bazë ligjore i kontribuon këtij bashkëpunimi të dobët ndërinstucional, i cili e pengon NJHS-në që të fillojë hetime të shënjestruara dhe e ngadalëson procesin hetimor.

Përkundër këtyre sfidave, gjatë vitit të kaluar prokuroria i ka ngritur nëntë aktakuza në bazë të kallëzimeve penale të NJHS-së, shtatë kallëzime penale u dorëzuan nga NJHS-ja në prokurori, ndërsa katër raste janë mbyllur në fazën e hetimeve. NJHS-ja aktualisht në portfolion e saj i ka më shumë se 50 raste korrupsioni, pothuajse gjysma e të cilave janë të një natyre të profilit të lartë.

3.1.2 Rastet e korrupsionit të profilit të lartë të kthyera për rigjykim nga Gjykata e Apelit

Rastet e korrupsionit të profilit të lartë kthehen shpesh për rigjykim nga GJA me argumentin se raportet e ekspertëve në të cilat janë mbështetur vendimet e shkallës së parë, ose nuk ishin hartuar me saktësi ose nuk ishin shqyrtuar plotësisht nga gjykata, gjë që shfaqet nga dy të shembujt e mëposhtëm.

16 Vendimi 915/2020 për themelimin e Njesisë së Hetimeve Speciale në kuadër të Departamentit të Hetimeve, 25 nëntor 2020.

17 Projektligji për Prokurorinë Speciale, https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/PLperProkurorineSpeciale_upXj2AuNhX.pdf, (qasur më 12 tetor 2022).

Në rastin kundër Pal Lekajt, ish-Kryetar i Gjakovës dhe ish-Ministër i Infrastrukturës, dhe Gani Rama, zyrtar i komunës, në Gjykatën Themelore të Gjakovës, të dy u akuzuan për përvetësim në detyrë dhe keqpërdorim të pozitës zyrtare. Më 19 shkurt 2021, gjykata dënoi Gani Ramën me një vit dhe Pal Lekajn me një vit e gjashtë muaj burgim me kusht. Të pandehurit u ankuan kundër këtij vendimi dhe më 23 gusht 2021, GJA vendosi ta kthejë rastin në rigjykim me arsyetimin se gjykata e shkallës së parë duhet të vlerësojë sërish tre raportet financiare të ekspertëve. Ky ishte tashmë rigjykimi i tretë për Gani Ramën dhe i pari për Pal Lekajn. Më 21 janar, të dy u shpallën të pafajshëm. Gjykata e bazoi përfundimin e saj kryesisht në dy nga tre raportet financiare të ofruara nga ekspertët. Më 22 gusht, GJA e konfirmoi lirimin nga akuza.

Shembulli i dytë është *Rasti i 3%-it*. Të pandehurit, ish-Kryeministri i Kosovës Bujar Bukoshi dhe ish-deputeti Naser Osmani, dyshohet se kishin përvetësuar para publike në shumën mbi 150 mijë euro. Më 13 korrik 2021, GJA e ktheu rastin në rigjykim në Gjykatën Themelore të Prishtinës. Rigjykimi filloi dhe më 12 shtator, Kryetarja e trupit gjykues njoftoi se do të caktohen tre ekspertë të rinj financiarë, gjë e cila do e zgjasë sërish gjykimin.

Në *Rastin Autostrada e Gjilanit*, çështja e ekspertit financiar mund po ashtu të rezultojë në kthimin e lëndës për rigjykim nga ana e GJA-së. Në këtë rast, PSRK-ja ka ngritur aktakuzë kundër katër zyrtarëve të Ministrisë së Infrastrukturës në Gjykatën Themelore të Prishtinës në shkurt të vitit 2021 për shkelje të pretenduara në lidhje me një proces tenderimi për ndërtimin e autostradës Prishtinë-Gjilan. Rasti bazohej në veprimet hetimore të ndërmarra nga ish-TFAK (tani NJHS). Pas një nisjeje fillestare të vonuar vitin e kaluar, rasti përparoi rregullisht gjatë këtij viti, ndërsa në shtator arriti në fazën e ekzaminimit të ekspertëve financiarë. Megjithatë, një ekspert kërkoi të tërhiqej për shkak të konfliktit të interesit të pretenduar. Vendimi i gjykatës është në pritje.

3.1.3 Sekuestrimi dhe konfiskimi

Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurive të përfituara nga veprimtari kriminale janë mjete vendimtare në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Ndërsa sekuestrimi i pasurisë përshkruan sekuestrimin e pasurisë gjatë hetimit, konfiskimi është konfiskim i përhershëm i pasurisë pas një vendimi të formës së prerë të gjykatës¹⁸. Këto instrumente sigurojnë që kryerësve t'u hiqet mundësia për ta shijuar dobinë e përfitur në mënyrë të paligjshme.

Sipas një dokumenti zyrtar të Ministrisë së Drejtësisë të muajit maji 2020¹⁹, pengesat për zbatimin e duhur të sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurisë nga gjyqësori lidhen kryesisht me mungesën e koherencës brenda kuadrit ligjor, numrin e pamjaftueshëm të prokurorëve dhe gjyqtarëve të specializuar, një numër i ulët i aktakuzave, numri i pamjaftueshëm i aktgjykimeve që përfshijnë konfiskimin e pasurisë dhe zvarritjet e procedurave gjyqësore²⁰.

18 Kodi aktual i Procedurës Penale përziën termat sekuestrim dhe konfiskim. Kodi i ri i Procedurës Penale, i publikuar më 17 gusht 2022 dhe që pritet të hyjë në fuqi më 17 shkurt 2023, bën dallimin e qartë mes dy instrumenteve.

19 Koncept dokument i Ministrisë së Drejtësisë për çështjen e pasurive të përfituara të pajustificueshme nga maji 2020.

20 Plani Strategjik i KGJK-së për zgjidhjen efikase të rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar 2022-2024, i cili ka hyrë në fuqi me vendimin e KGJK-së të datës 18 tetor 2021, si objektiva kryesore tregojnë rritjen e produktivitetit dhe efikasitetit dhe forcimin e kapaciteteve të gjyqësorit në trajtimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar. Plani strategjik gjendet në https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/decisions/44297_Vendimi_KGJK_se_Nr_292_2021_Miratohet_Plani_Strategjik_per_Zgjidhjen_Efikase_te_Lendeve_te_Korrupsionit_dhe_Krimit_te_Organizuar_2022-2024.pdf (qasur me 4 nëntor 2022).

EULEX-i kontaktoi Prokuroritë Themelore (PTH), Prokurorinë Speciale (PSRK) dhe Koordinatorin Kombëtar për luftimin e krimit ekonomik në kuadër të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit për të përcaktuar shkallën në të cilën janë duke u përdorë sekuestrimi dhe konfiskimi në rastet e korrupsionit dhe krimit të organizuar. Bazuar në të dhënat e marra²¹, Misioni ka vërejtur se PSRK-ja dhe PTH-të në fakt e përdorin instrumentin e sekuestrimit gjatë hetimit, por nuk ka mundur të vërtetohet nëse ky mjet është duke u shfrytëzuar në potencialin e tij të plotë²². Ndërsa prokuroria tenton të kërkojë sekuestrimin, vendimet përkatëse të gjykatës në procedurën paraprake shpesh mbeten në pritje për një kohë të gjatë, duke çuar në një situatë të pasigurt juridike për të gjithë të përfshirët. Edhe nëse kryhet sekuestrimi, shpesh ndodh që hapi tjetër, kërkesa për konfiskim, ose nuk paraqitet ose nuk arsyetohet siç duhet, gjë që e bën të pamundur vendosjen e konfiskimit nga gjykata²³. Konfiskimi varet nga nxjerrja e aktgjykimit të formës së prerë nga gjykatat, por këto vazhdojnë të jenë të rralla, veçanërisht në rastet e profilit të lartë, kështu që konfiskimet ndodhin rrallë.

Këto vrojtime pasqyrohen edhe në një raport²⁴ të Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike të publikuar së fundmi. Sipas këtij dokumenti, kryesisht janë PSRK-ja dhe PTH e Prishtinës që kishin më shumë potencial se PTH-të më të vogla për ta shfrytëzuar instrumentin e konfiskimit. Raporti sugjeron që KPK duhet të hartojë një plan për ta përmirësuar zbatimin e këtij instrumenti, ky kryesisht përfshihen Kryeprokurorët.

Rekomandime:

- Ministria e Punëve të Brendshme, në koordinim me menaxhmentin e lartë të Policisë së Kosovës, duhet ta merr rolin drejtues për qartësimin dhe legalizimin e mëtejme të pozitës së NJHS-së në kuadër të PK-së. Kjo mund të arrihet duke propozuar ndryshime në *Ligjin për Policinë*²⁵.
- Menaxhmenti i lartë i Policisë së Kosovës duhet të rrisë kapacitetet policore dhe hetimore financiare të NJHS-së të udhëhequr nga inteligjenca. NJHS duhet të mbajë linja të drejtpërdrejta komunikimi me Drejtorinë e Inteligjencës dhe Analizës dhe Agjencinë Kosovare të Inteligjencës në mënyrë që t'i sigurohet inteligjenca përkatëse.
- Menaxhmenti i lartë i PK-së duhet ta përmirësojë bashkëpunimin ndërinstucional të NJHS-së duke krijuar linja formale të komunikimit me organet si Administrata Tatimore, Dogana dhe Njësia e Inteligjencës Financiare.
- Koordinatorin Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik në bashkëpunim me PSRK-në dhe të gjitha PTH-të duhet ta integrojnë sistemin e krijuar të grumbullimit të dhënave në lidhje me sekuestrimin dhe konfiskimin siç pasqyrohet në 'Raportin mbi aktivitetet dhe

21 EULEX-i ka marrë informata nga PSRK-ja dhe PTH të Gjakovës, Pejës, Prishtinës, Prizrenit, Ferizajt. PTH e Mitrovicës dhe Gjilanit nuk kanë ofruar të dhëna.

22 Statistikat për këto aspekte janë të kufizuara edhe në BE. Shumat e mbledhura nga të ardhurat e krimit në BE duken të pamjaftueshme në krahasim me të ardhurat e vlerësuara, shih paragrafin 4 të pjesës hyrëse të Direktivës 2014/42/BE për ngrirjen dhe konfiskimin e instrumenteve dhe të ardhurave të krimit në BE.

23 Kushtet dhe procedura për shqiptimin e konfiskimit janë përmendur në Kodin e Procedurës Penale, 04/L-123, 1 janar 2013, Kapitulli XVIII, sekuestrimi dhe konfiskimi. Vetëm neni 282 i KPP-së i referohet një përjashtimi kur pasuria i nënshtrohet konfiskimit automatik, pavarësisht nga vendimi i gjykatës, përkatësisht pasuria që është në thelb e rrezikshme ose e paligjshme.

24 Koordinatorin nacional për luftimin e krimeve ekonomike nxjerr të dhëna publike në formë të raporteve tremujore (prokuroria-rks.org).

25 Ligji për Policinë, 04/L-076, 19 mars 2012, [KOSOVË \(rks.gov.net\)](http://rks.gov.net). (qasur më 16 shtator 2022).

rekomandimet e koordinatorit kombëtar për luftimin e krimit ekonomik' në një sistem për mbledhjen e të dhënave të krahasueshme. Ky sistem gjithashtu duhet t'i japë qasje të drejtpërdrejtë Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike.

- Kryeprokurorët e prokurorive duhet të marrin rolin drejtues për të siguruar që instrumentet e kërkesave për sekuestrim dhe konfiskim të përdoren nga çdo prokuror i caktuar. Koordinatori Kombëtar për luftimin e krimeve ekonomike dhe KGJK-ja duhet të intensifikojnë bashkëpunimin e tyre në lidhje me numrin e madh të vendimeve gjyqësore në pritje për sekuestrimet e kërkuara.
- KGJK-ja duhet ta plotësojë *Planin e saj Strategjik për Zgjidhjen Efikase të Rasteve të Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar 2022-2024* me qëllim të përmirësimit të zbatimit të sekuestrimit dhe konfiskimit në nivel gjyqësor në të gjitha rastet e pazgjidhura dhe të ardhshme të korrupsionit dhe krimit të organizuar.
- KGJK-ja në bashkëpunim me KPK-në, Prokurorinë e Shtetit dhe Odën e Avokatëve duhet të bëjnë vlerësimin e përdorimit të ekspertizës financiare në rastet e korrupsionit në mënyrë që të identifikohen arsyet pse ekspertiza është hartuar në mënyrë të pasaktë ose nuk vlerësohet si duhet nga gjykatat, të cilat shpeshherë rezultojnë në dërgimin e rasteve për rigjykim.

3.2 Korrupsioni në sistemin shëndetësor

Korrupsioni mund të përkufizohet si keqpërdorim i pushtetit të besuar për përfitime private. Ky fenomen e dëmton besimin ndaj institucioneve në mesin e popullatës, e dobëson demokracinë dhe e pengon zhvillimin ekonomik, duke e rritur më tej pabarazinë dhe ndasitë shoqërore²⁶. Korrupsioni është një vepër penale që ka një ndikim të dëmshëm në mbrojtjen dhe gëzimin e të drejtave të njeriut, si dhe në qasjen e barabartë në të mira dhe shërbime të lidhura me të drejtat e njeriut, si kujdesi shëndetësor, arsimi dhe drejtësia. Korrupsioni në sistemin e kujdesit shëndetësor është veçanërisht i dëmshëm pasi mund të ndikojë drejtpërdrejt në mirëqenien dhe jetën e më të varfërve dhe më të rrezikuarve. Për shembull, korrupsioni në prokurimin e barnave dhe pajisjeve mjekësore i rrit kostot dhe mund të çojë në përdorimin e produkteve jashtë standardeve ose të dëmshme, ndërsa pagesat jozyrtare për shërbime mjekësore mund të përjashtojnë në mënyrë efektive njerëzit e varfër nga qasja në shërbime të cilat kanë të drejtë t'i marrin pa pagesë ose me kosto më të ulët²⁷.

Të jetosh në një shoqëri të korruptuar me një mjedis të korruptuar të kujdesit shëndetësor mund të bëjë që profesionistët e kujdesit shëndetësor të veprojnë në mënyrë joetike, ndërkohë që pacientët mund ta perceptojnë këtë lloj sjelljeje si normale, gjë që çon në një sistem të paqëndrueshëm dhe jo të besueshëm të kujdesit shëndetësor.

Në vitin 2014, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) publikoi një studim²⁸ ku u analizuan rreziqet e mundshme të korrupsionit në sistemin e kujdesit shëndetësor në Kosovë. Rreziqet e identifikuar u ndanë në tri kategori kryesore: (1) pagesat joformale (duke

26 Transparency International, 'Çka është korrupsioni', <https://www.transparency.org/en/what-is-corruption>, (qasur më 16 shtator 2022).

27 Banka Botërore, 'Lufta kundër korrupsionit, tetor 2021', <https://www.worldbank.org/en/topic/governance/brief/anti-corruption>, (qasur më 16 shtator 2022).

28 Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, 'Vlerësimi i rrezikut të korrupsionit në sektorin e shëndetësisë në Kosovë, gjetjet dhe rekomandimet', Projekti i UNDP-së në Kosovë Mbështetje për përpjekjet kundër korrupsionit në Kosovë (SAEK), dhjetor 2014, <https://www.undp.org/kosovo/publications/saek-corruption-risk-assessment-health> (qasur më 16 shtator 2022).

iu referuar pagesave të bëra nga pacientët për shërbime mjekësore jashtë pagesave zyrtare), (2) çështjet e personelit mjekësor (që lidhen kryesisht me emërime abuzive, d.m.th. të politizuara, ose përndryshe emërime të papërshtatshme ose të pabazuara në merita, mungesa e personelit mjekësor ose referimet e paarsyeshme të pacientëve në spitalet private) dhe (3) prokurimi i barnave (prokurimi ose vjedhja e produkteve dhe pajisjeve medicinale).

Monitorimi i rregullt i Misionit gjatë viteve të fundit ka përfshirë edhe disa raste të pretenduara për korrupsion në sistemin shëndetësor. *Rastet Stenta*, të përmendura më parë në kapitullin për rastet e profilit të lartë, përfshijnë akuza për korrupsion kundër personelit mjekësor si në institucionet publike ashtu edhe në ato private, të përfshirë në referimin e pacientëve nga spitalet publike në ato private. Një nga *Rastet Stenta* ka të bëjë me ish-Ministrin e Shëndetësisë dhe Sekretarin e Ministrisë, të cilët së fundmi gjatë rigjyqimit u shpallën të pafajshëm nga akuzat për pretendimet se kishin nënshkruar marrëveshje për ofrimin e shërbimeve shëndetësore me dy spitale private pa shpallur tender. *Rastet Stenta* tjera në proces përfshijnë mjekë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) në Prishtinë të akuzuar për keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe marrje ryshfeti për gjoja marrjen e parave për dërgimin e pacientëve në spitale private, ndërsa mjekët në spitalet private përkatëse u paditën për dhënie ryshfeti.

Në një rast tjetër, në Gjykatën Themelore të Ferizajt²⁹, të pandehurit janë akuzuar se kanë kontrabanduar produkte medicinale nga Maqedonia e Veriut dhe më pas i kanë shitur në barnatore të ndryshme në Kosovë. Ata janë hetuar edhe për veprën penale të dhënies së ryshfetit, të cilat është dashur të ndërpriten për mungesë provash.

Për më tepër, në lidhje me emërimet e pretenduara abuzive të personelit mjekësor nga menaxhmenti i institucioneve shëndetësore, EULEX-i e ka përcjellë aktakuzën e ngritur në Gjykatën Themelore të Gjakovës kundër ish-Drejtorit të Qendrës për Mjekësi Familjare në Rahovec³⁰. Prokurorët e akuzuan atë për pretendimet se e kishte shpallur konkursin për pozitën e fizioterapeutit në qendrën mjekësore duke mos i respektuar rregulloret në fuqi dhe pasi e ka punësuar një kandidat të caktuar, për shkak se e ka ndërruar menjëherë pozitën e tij të fizioterapeutit për një tjetër në Departamentin e Infermierisë pa i përmbushur kriteret ligjore.

Korrupsioni në sistemin e kujdesit shëndetësor mund të marrë formën e keqpërdorimit të buxheteve shëndetësore, kryesisht në lidhje me procedurat e parregullta të prokurimit ose llojeve tjera të shpenzimeve të paarsyetuara. Vitin e kaluar, Policia e Kosovës ka filluar hetimet ndaj ish-Drejtorit të Qendrës Shëndetësore në Novobërdë dhe pronarit të një kompanie farmaceutike³¹, që ofronte produkte mjekësore për këtë qendër mjekësore. Aty pretendohet se kompania thjesht po i lëshonte fatura Komunës për të siguruar përfitime financiare, por pa i dorëzuar produktet mjekësore. Në një rast tjetër të monitoruar nga EULEX-i, dhe i cili aktualisht po gjykohet në Gjykatën Themelore të Prishtinës³², një ish-zyrtar i Ministrisë së Shëndetësisë dhe një ish-punonjës i Agjencisë Kosovare për Produkte Medicinale akuzohen për manipulim të paradhënies për udhëtime zyrtare jashtë vendit pasi pretendohet se i kanë shkaktuar buxhetit të Kosovës dëm prej mbi 1 milion euro.

Rastet e mësipërme paraqesin vetëm disa shembuj të korrupsionit të pretenduar në sistemin e kujdesit shëndetësor. Sipas informatave të vëna në dispozicion të EULEX-it nga institucionet vendase, nuk ekziston ndonjë bazë të dhënash e dedikuar për t'i përcjellë rastet e korrupsionit në sektorin e shëndetësisë. Kjo do të ishte e një rëndësie të veçantë, veçanërisht në nivelin e policisë,

29 Aktakuza nr. PP/I. nr.35/20 e ngitur nga PTH Ferizaj.

30 Aktakuza nr. PPI. 175/2020, e ngitur PTH Gjakovë.

31 Rasti nr. 2021-KE-260, PK Drejtoria e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit (DKEK).

32 Rasti Avanci (PPS 19/19 – Gjykata Themelore e Prishtinës, Departamenti Special).

e cila është hapi i parë në zinxhirin e drejtësisë penale pas paraqitjes së një raporti apo kallëzimi penal. Për më tepër, Misioni vuri në dukje sfidat e veçanta në mbledhjen e informacionit ose të dhënave për rastet e mundshme të korrupsionit të pretenduar që lidhen, për shembull, me pagesat joformale. Kjo është ose për shkak të një nën-raportimi sistematik të rasteve të tilla që mund të tregojë se një sjellje e tillë ishte e pranueshme nga shoqëria, të paktën në një masë të caktuar, ose mund të jetë për shkak se institucionet vendase nuk i kushtojnë vëmendjen e duhur rasteve të tilla edhe atëherë kur raportohen. Po ashtu, Inspektorati Shëndetësor i Kosovës³³ ka konfirmuar se rastet e pagesave joformale nuk janë duke u monitoruar nga ky institucion, por ka ofruar të dhëna statistikore për numrin e rasteve të referimeve në spitale private apo mungesës së stafit mjekësor nga spitalet publike për shkak të obligimeve të punës që i kanë në qendrat private. Në periudhën janar-gusht 2022, Inspektorati i ka kryer gjithsej 600 inspektime dhe ka evidentuar tre raste të referimeve të paarsyetuara nga pikëpamja mjekësore të pacientëve nga institucionet publike në ato private, si dhe gjashtë raste kur profesionistë shëndetësorë kanë punuar në klinika private në kohën kur ata është dashur që të jenë të pranishëm në institucionet shëndetësore publike. Gjithashtu, Inspektorati raportoi se i kishte shqiptuar 110 ndëshkime për parregullsi të ndryshme në periudhën e lartpërmendur, përfshirë mungesën e pjesshme ose të plotë apo skadimin e licencës së institucionit shëndetësor apo të personelit, referimin e paarsyetuar të pacientëve nga institucionet publike në ato private, mungesën nga vendi i punës në institucionet publike shëndetësore dhe ofrimin e shërbimeve shëndetësore në institucionet shëndetësore private, ose ofrimin e shërbimeve shëndetësore në një fushë shëndetësore në të cilën ofruesi nuk e kishte kualifikimin adekuat. Megjithëse këto shifra mund të mos duken të larta në krahasim me numrin e përgjithshëm të inspektimeve, kur vërtetohen me rastet penale të përmendura më sipër, është e qartë se këto nuk janë incidente të izoluar dhe se ato mund të tregojnë një model sjelljeje.

Korrupsioni në sistemin mjekësor është i lidhur ngushtë me shkeljen e të drejtave themelore të njeriut, të garantuara me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës, si dhe me instrumentet ndërkombëtare të aplikueshme në Kosovë, *mes tjerash*, të drejtën për jetë, të drejtën për siguri, ndalimin e diskriminimit ose të drejtën për gjykim të drejtë. Prandaj institucionet vendore duhet të bëjnë përpjekje për ta adresuar këtë fenomen në mënyrë më sistematike.

Rekomandime:

- Institucionet gjyqësore duhet të krijojnë instrumente për ta identifikuar dhe gjurmuar korrupsionin në sistemin e kujdesit shëndetësor (p.sh., të mbledhin statistika për rastet e korrupsionit në këtë fushë).
- Policia e Kosovës, Prokuroria Speciale dhe Prokuroritë Themelore duhet të krijojnë baza specifike të dhënave ku do të grumbullohen të gjitha rastet e korrupsionit në sistemin mjekësor në mënyrë që të ofrohet një pasqyrë reale dhe e përditësuar e kësaj dukurie dhe një pikënisje për trajtimin e tij.
- Qeveria e Kosovës duhet të identifikojë faktorët që favorizojnë korrupsionin në këtë fushë të veçantë dhe të përgatisin strategji për zvogëlimin e tyre (p.sh., rritja e nivelit të sensibilizimit publik, sigurimi i ndarjeve të mjaftueshme buxhetore për shërbimet shëndetësore, monitorimi i duhur i shpenzimeve publike, etj.).

³³ Inspektorati Shëndetësor i Kosovës është institucion publik përgjegjës për monitorimin, inspektimin, këshillimin, dhënien e rekomandimeve dhe ndërmarrjen e veprimeve ligjore që kanë të bëjnë me parregullsitë brenda sistemit shëndetësor.

3.3 Krimet nga e drejta ndërkombëtare

Hetimi, ndjekja penale dhe gjykimi i krimeve nga e drejta ndërkombëtare, si krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit, paraqesin sfida të veçanta krahasuar me veprat penale të tjera. Këto sfida lidhen me shkallën e gjerë të veprave në fjalë, e që mund të përfshijnë numrin e madh të viktimave dhe autorëve, kalimin e kohës, që i zvogëlon ndjeshëm provat e disponueshme, dhe rëndësinë e llogaridhënies për këto krime për sa i përket proceseve të drejtësisë tranzicionale.

Për shkak të numrit të madh të rasteve që janë ende në pritje dhe ndërlikueshmërisë së shumicës prej tyre, EULEX-i monitoron rregullisht dhe nga afër jo vetëm procedurat gjyqësore, por edhe menaxhimin e përgjithshëm dhe progresin e hetimeve të ndryshme para se ato të arrijnë në fazën e gjykimit.

Në vijim janë paraqitur gjetjet kryesore në lidhje me fazat e ndryshme të sistemit të drejtësisë penale gjatë periudhës së raportimit.

Faza e hetimeve:

Në vitin 2021 dhe 2022, Njësia për Hetimin e Krimeve të Luftës në Policinë e Kosovës (NJHKL) ka vazhduar digjitalizimin, analizimin dhe hetimin aktiv të rasteve të dorëzuara nga EULEX-i në vitin 2018, si dhe rasteve të reja.

Në vitin 2019, Policia e Kosovës, në bashkëpunim me PSRK-në, identifikuan dhe prioritzuan dhjetë raste të mëdha të krimeve të luftës duke përfshirë ato të shkallës së gjerë si Meja, Raçaku dhe Qyshku. Më shumë se tre vite pas fillimit të këtyre hetimeve, nuk është ngritur asnjë aktakuzë. Hyrja në fuqi e *Kodit të ri të Procedurës Penale* në shkurt 2023, i cili përmban një dispozitë për gjykimet në *mungesë*, mund të shpije në zhvillime konkrete në disa prej këtyre rasteve.

Paralelisht me këto hetime të shkallës së gjerë, NJHKL-ja vazhdoi të punojë në disa raste më të vogla të krimeve të luftës, të cilat në janë më të lehta për t'u hetuar dhe ndjekur penalisht në krahasim me rastet e mëdha. EULEX-i ka monitoruar një sërë zhvillimesh, duke përfshirë në veçanti ngritjen e dy aktakuzave në dhjetor 2021 dhe mars 2022, dhe finalizimin e afërt në fazën e procedurës paraprake të tri hetimeve të tjera (shih shtojcën e rasteve për më shumë detaje)³⁴. Këto të arritura u bënë përkundër faktit se NJHKL-ja ishte me staf të pamjaftueshëm dhe kishte mungesë të resurseve materiale. Një problem tjetër domethënës i vërejtur nga Misioni është ndërrimi i madh i hetuesve me përvojë të NJHKL-së, gjë që është problematike për këtë fushë të specializuar.

Faza e prokurorisë:

Departamenti i Krimeve të Luftës në PSRK aktualisht ka katër prokurorë. Megjithatë, dy prej tyre ende janë duke u marrë me gjykime për rastet që kanë pasur para transferimit të tyre në këtë departament, dhe jo me raste të krimeve të luftës. Për më tepër, përgjegjësitë e prokurorëve ndahen sipas zonave gjeografike, gjë që ndonjëherë çon në një çekuilibër në ngarkesën e punës. Nga ana tjetër, ndarja e prokurorëve nëpër zona gjeografike ka edhe ndikim pozitiv, pasi u lejon atyre të zhvillojnë njohuri dhe ekspertizë specifike për zonën.

Është shqetësues fakti se si NJHKL ashtu edhe Departamenti i Krimeve të Luftës në PSRK e konsiderojnë bashkëpunimin e tyre të pamjaftueshëm dhe vlerësojnë se ai është përkeqësuar gjatë vitit të kaluar.

³⁴ Hetimet kundër Duško Arsić, Časlav Jolić dhe Milorad Đoković dhe aktakuzat kundër Svetomir Bačević dhe Muhamet Alidema.

Sa i përket hetimeve të filluara, ku tre persona janë arrestuar nga PK-ja nën dyshimin se kanë kryer tri krime lufte të ndara, vlen të theksohet se në kohën e raportimit, të gjitha hetimet janë të përfunduara dhe rastet ishin në pritje të vendimit të prokurorisë ose për ndërprerje të rastit për shkak të mungesës së provave ose për ngritje të aktakuzave.³⁵

Faza e gjykatës:

Më 8 shtator 2022, pas një shqyrtimi gjyqësor dhjetëmujor, Departamenti Special në Gjykatën Themelore të Prishtinës nxori aktgjykim në procedurën kundër Svetomir Bačević, serb i Kosovës i akuzuar me pretendime se kishte marrë një peng gjatë konfliktit në Kosovë, dhe e dënoi atë me pesë vite burgim. Fatkeqësisht, Gjykata nuk arriti të jepte një arsytim të shkurtër me rastin e shpalljes së aktgjykimit, diçka që kërkohet me ligj³⁶. Për këtë arsye, është shumë herët të vlerësohet se si Gjykata ka trajtuar një sërë mospërputhjesh dhe kundërshtimesh në lidhje me provat të cilat janë monitoruar nga EULEX-i gjatë shqyrtimit kryesor.

Shqyrtimi kryesor kundër Muhamet Alidemës, një shqiptar i Kosovës i akuzuar me pretendime për pjesëmarrje në masakrën e Izbicës, është ende në vazhdim. Gjatë fazës së procedurës paraprake, Alidema është mbajtur në paraburgim për një periudhë pak më pak se një vit dhe aktakuza është ngritur një ditë para skadimit të afatit njëvjeçar të paraburgimit. Pak para seancës së parë fillestare, ai vendosi të ndryshojë avokatin e tij mbrojtës, që ishte shqiptar i Kosovës, dhe zgjodhi një avokat mbrojtës serb të Kosovës. Kjo ka ndikuar në fillimin e shqyrtimit kryesor për shkak të ndryshimit të gjuhës së përdorur në procedurë. Sido që të jetë, kjo çështje është trajtuar në mënyrë profesionale nga Gjykata, që e ka urdhëruar përkthimin e tërë dosjes së lëndës në serbisht pasi e drejta për përkthim vlen për të gjithë pjesëmarrësit në gjykim, duke përfshirë edhe avokatin mbrojtës, dhe jo vetëm për të pandehurin. Shqyrtimi kryesor për këtë rast ende nuk ka filluar.

Deri në shtator 2022, vetëm rasti *Svetomir Bačević* u finalizua në shkallë të parë, ndërsa dy raste të tjera u finalizuan në shkallën e Gjykatës së Apelit (GJA) dhe Gjykatës Supreme (GJS).³⁷ EULEX-i analizoi aktgjykimet dhe arriti në përfundimin se ato plotësojnë kriteret e përcaktuara me *Kodin e Procedurës Penale* (për shembull, ato adresojnë elementet e nevojshme të krimeve, pretendimet e palëve, shkeljet esenciale të pretenduara të procedurës, etj.).

Po ashtu, GJA ka nxjerrë një vendim për rastin *Zoran Vukotić IV*, të cilin EULEX-i e ka monitoruar që nga ngritja e aktakuzës në vitin 2020. Ishte aktakuza e parë për krime kundër njerëzimit e ngritur nga PSRK-ja. GJA ka vërejtur me saktësi se dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë ishte i paqartë dhe i pakuptueshëm dhe e ktheu lëndën në Gjykatën Themelore të Prishtinës për rigjykim.

Në anën tjetër, disa raste të krimeve të luftës, të cilat aktualisht janë duke u gjykuar në Gjykatën Themelore të Mitrovicës dhe në Gjykatën Themelore të Prizrenit, nuk kanë bërë asnjë përparim. Ish rastet e EULEX-it, si *Drenica I*, *Vukotić I* dhe *Vukotić III*, kanë mbetur në pritje për shumë vite pa ndonjë progres. Një rast tjetër që është në pritje për rigjykim në Gjykatën Themelore të Prizrenit është në proces e sipër për më shumë se pesë vite, ku gjatë katër prej këtyre pesë viteve i pandehuri, Remzi Shala, ka qenë në paraburgim.

³⁵ Në nëntor, PSRK ngriti aktakuzë kundër Duško Arsić.

³⁶ Sipas ligjit në fuqi në datën e shpalljes, Kodi i Procedurës Penale, 04/L-123, 1 janar 2013, neni 366, paragrafi 2, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2861>, (qasur më 16 shtator 2022). Dispozita përkatëse në Kodin e Procedurës Penale 08/L-032, publikuar më 17 gusht 2022 dhe që do të hyjë në fuqi më 17 shkurt 2023, është përcaktuar në nenin 365, paragrafi 2, [ActDetail.aspx](https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx) (rks-gov.net) (qasur më 16 shtator 2022).

³⁷ Aktgjykimet e nxjerra nga GJA në rastet e *Zoran Đokić* dhe nga GJS në rastin *Zlatan Krstić/Destan Shabanaj*. Aktgjykimet e GJA për rastin e *Goran Stanišić* është shpallur në tetor.

Si përfundim, PK-ja dhe prokuroria bënë një përparim të prekshëm në një numër të hetimeve aktive për raste më të vogla të krimeve të luftës, zhvillim ky pozitiv duke marrë parasysh mungesën e personelit dhe burimeve teknike. Për më tepër, në përputhje me rekomandimin e Misionit, gjyqtarët kanë përmirësuar cilësinë e aktgjykimeve të tyre dhe kanë adresuar të gjitha çështjet dhe pretendimet e rëndësishme të palëve. EULEX-i konstatoi se gjykimet në Prishtinë po kryheshin në mënyrë profesionale dhe efikase. Megjithatë, kjo nuk vlen plotësisht edhe për rajonet tjera. Një numër rastesh janë në pritje për shumë vite madje as pa filluar fare. Hetimet e rasteve kur të dyshuarit janë në paraburgim nuk finalizohen në kohën e duhur. Për fund, mungesa e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar për çështjet penale mbetet sfidë domethënëse meqë kjo po ngadalëson hetimet në shumë raste që kanë të bëjnë me krimet nga e drejta ndërkombëtare.

Rekomandime:

- PSRK dhe NJHKL duhet të përmirësojnë nivelin e tyre të bashkëpunimit në lidhje me hetimet në vazhdim.
- PSRK duhet t'i japë prioritet hetimeve paraprake në rastet kur të dyshuarit janë në paraburgim.
- Gjykata Themelore e Mitrovicës duhet të përshpejtojë rigjykimin e *rastit Drenica I* dhe rasteve të mbetura *Vukotić*, ndërsa Gjykata Themelore e Prizrenit duhet t'i japë prioritet rigjyimit të *rastit Remzi Shala*.
- Qeveria e Kosovës duhet të ndajë burime njerëzore shtesë dhe burime materiale për NJHKL e PK-së dhe PSRK-në për t'u mundësuar atyre të merren me hetimet e shumta.
- Autoritetet e Kosovës duhet të vazhdojnë të kërkojnë mënyra për të përmirësuar bashkëpunimin rajonal, veçanërisht me Serbinë, ku shumë të dyshuar dhe dëshmitarë banojnë.

3.4 Dhuna në baza gjinore

Zhvillimet e përgjithshme

Strategjia e re nacionale e Kosovës për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave 2022-2026, për të cilën Misioni kontribuoi në rol këshillues, u prezantua në janar. Strategjia përmban veprime dhe masa që synojnë mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe formave tjera të dhunës kundër grave (Strategjia e mëparshme ka pasur synim mbrojtjen e viktimave vetëm nga dhuna në familje), në përputhje me *Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit)*. Strategjia është e strukturuar në katër shtylla (I. Parandalimi dhe identifikimi i dhunës; II. Avancimi dhe harmonizimi i politikave publike me standardet ndërkombëtare; III. Fuqizimi institucional për parandalimin dhe adresimin e dhunës në familje; IV. Ofrimi i shërbimeve të përgjithshme dhe shërbimeve të specializuara mbështetëse për viktimat) dhe përmban gjithsej 140 aktivitete për zbatimin e saj.

Gjatë periudhës së raportimit, më shumë se 30 nga këto aktivitete veçse kanë qenë në zbatim e sipër dhe janë mbajtur takime të rregullta mujore të grupit koordinues ndërministror për dhunën në familje me raportim të detajuar nga palët relevante të interesit (Ministria e Drejtësisë,

PK, prokuroria, gjykatat, Zyrat për Mbrojtje dhe Ndhimë Viktimave, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Financave).

Prezantimi i *Strategjisë* dhe aktivitetet e shpalosura në këtë kontekst patën efekt anësor pozitiv për përdorimin e bazës së të dhënave për rastet e dhunës në familje të krijuar në kuadër të Zyrës së koordinatorit kombëtar kundër dhunës në familje. Më shumë institucione filluan të fusin të dhënat e nevojshme dhe përdorimi i bazës së të dhënave u përmirësua dukshëm. Rritja konstante vjetore prej rreth 20-22% e raportimit të rasteve të dhunës në familje duket se vazhdon, duke qenë se 2069 raste janë raportuar në vitin 2020 dhe 2456 në 2021, ndërsa deri në shtator 2022 janë raportuar 2067 raste. Megjithatë, përmirësimi i mëtejshëm është i nevojshëm, në veçanti gjykatat themelore duhet të sigurojnë që të dhënat e plota dhe të konsoliduara futen në bazën e të dhënave në mënyrë rutinore.

Aktualisht ende nuk ka sistem të unifikuar të raportimit dhe mbledhjes së të dhënave për format e tjera të dhunës në baza gjinore, veçanërisht për veprat e dhunës seksuale. Kjo mangësi u theksua në raportin e EULEX-it *Vlerësimi i trajtimit të rasteve të dhunimeve nga sistemi i drejtësisë në Kosovë*, i publikuar në korrik 2022. Kjo e bën të vështirë mbledhjen e të dhënave të sakta dhe reagimin adekuat ndaj formave të tjera të dhunës në baza gjinore.

Misioni e përshëndeti vendimin e Ministrisë së Drejtësisë në mars të vitit 2022, për themelimin e grupit punues përgjegjës për hartimin e *Protokollit* shumë të nevojshëm për referimin e rasteve të dhunës seksuale dhe që atëherë mbështet funksionimin e tij. Protokollin, i cili përcakton koordinimin e punës së të gjitha institucioneve të përfshira në referimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës seksuale (p.sh. PK, mjekët, Instituti i Mjekësisë Ligjore, prokuroria, gjykatat, Qendrat për Mirëqenie Sociale, Zyrat për Mbrojtje dhe Ndhimë Viktimave), pritet të finalizohet dhe të prezantohet gjatë fushatës 16 Ditët e Aktivizmit në vitin 2022.

Në kohën e hartimit të këtij raporti, *Ligji i ri për Dhunën në Familje dhe Dhunën ndaj Grave*, që synon përafrimin e *Ligjit të mëparshëm për Dhunën në Familje* me standardet e *Konventës së Stambollit*, ende ishte në fazën e hartimit në Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione.

Të gjeturat e monitorimit të rasteve të bashkësisë jashtëmartesore me personin nën moshën 16 vjeç

Gjatë periudhës së raportimit, Misioni, përveç fokusimit në monitorimin e rasteve të dhunimeve (neni 227 i *Kodit Penal*) i cili rezultoi me publikimin e raportit të sipërpërmendur në korrik, shqyrtoi në mënyrë specifike edhe rastet e bashkësisë jashtëmartesore me personin nën moshën 16 vjet (neni 240 i *Kodit Penal*).

Edhe pse ky krim bie nën veprat penale kundër martesës dhe familjes, ka implikime edhe sa i përket lidhjes së tij me veprën penale të dhunimit, pasi që sipas legjislacionit të Kosovës personi nën moshën 16 vjeçare nuk mund të japë pëlqim ligjërisht për akte seksuale.³⁸ Neni 240 i KP parasheh dënimin me burgim nga pesë deri në 20 vite kur vepra kryhet ndaj një fëmije mes moshës 14 dhe 16 vjeçare dhe të paktën dhjetë vite burg kur fëmija është nën moshën 14 vjeç.

³⁸ Kodi Penal, 06/L-074, 14 janar 2019, neni 225 paragrafi 1, <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/A5713395-507E-4538-BED6-2FA2510F3FCD.pdf> (qasur më 16 shtator 2022).

Këto dënime janë të barabarta me ato të përcaktuara në nenin 227, paragrafët 5 dhe 6 të KP, që përcakton veprën penale të detyrimit të personave nën moshën 16 vjeçare për kryerje të aktit seksual.

Sipas statistikave të PK-së, në PK janë raportuar 98 raste të këtilla në vitin 2020 dhe 2021. KGJK-ja ka raportuar se gjykatat në atë periudhë kanë pranuar 73 raste dhe kanë zgjidhur 28, prej të cilave tetë kanë përfunduar me lirim nga akuza, tri me refuzim të aktakuzës dhe 17 me aktgjykime fajësuese.

Për të kryer një analizë më të thelluar, Misioni ekzaminoi 13 raste gjatë periudhës 6 qershor 2021 deri më 22 janar 2022. U vu re se të gjitha viktimat ishin femra dhe të moshës 13 deri në 16 vjeçare, ndërsa të gjithë kryerësit e veprave ishin meshkuj dhe të moshës 16 deri në 29 vjeçare. Një nga çështjet kryesore që vihet re lidhet me vështirësitë në zbulimin e këtij fenomeni në fazat e tij të hershme. Në rastet e analizuara, 9 nga 13 viktimat kanë qenë shtatzëna, dhe rastet janë raportuar në PK vetëm kur ato kanë qenë në spital.

EULEX-i gjithashtu gjeti mospërputhje në mes të shkallës së dënimit të përcaktuar me ligj dhe dënimeve të shqiptuara që shpesh kanë qenë të buta. Të pyetur për ta konfirmuar këtë, prokurorët dhe gjyqtarët e intervistuar nga Misioni shprehën pikëpamjen se dënimi i përcaktuar me Kodin Penal nuk ishte zgjidhja e duhur, pasi në shumicën e rasteve kryerësi i veprës dhe viktimja jetonin së bashku si familje. Rrjedhimisht, dënimi i kryerësit të veprës me burgim të gjatë do t'i privonte fëmijët e lindur nga këto marrëdhënie nga babai për shumë vite, si dhe do të linte nënën/viktimën të vetme pa asnjë mbështetje ekonomike, duke pasur parasysh se shpesh babai/bashkëshorti ishte i vetmi që mbante familjen. Gjyqtarët e intervistuar konfirmuan se, duke qenë se gjykatat ishin të detyruara të merrnin parasysh interesat më të mira të fëmijës, dënimet me burgim rrallëherë janë shqiptuar.

Konkretisht, në një rast nga Gjykata Themelore e Gjilanit nga shkurti i vitit 2022, kryerësi i veprës ishte 31 vjeçar dhe viktimja 15. Në kohën e aktgjykimit ata ishin të martuar ligjërisht pasi vajza kishte mbushur 16 vjet dhe ata kishin një fëmijë shtatë muajsh. Kryerësi i veprës u dënua me gjashtë muaj burg, dhe dënimi ishte shndërruar në gjobë. Në një rast nga Gjykata Themelore e Gjakovës nga janari i vitit 2021, aktakuza ishte tërhequr nga prokurori për shkak se palët kishin një fëmijë së bashku dhe ishin martuar në ndërkohë. Kryerësi i veprës ishte 20 vjeçar dhe viktimja 15 vjeçare kur bashkëjetesa kishte filluar.

Për më tepër, EULEX-i konstatoi se dënimi minimal i kërkuar me ligj nuk ishte shqiptuar edhe në rastet kur palët nuk kishin fëmijë së bashku. Për shembull, në një aktgjykim të lëshuar nga Gjykata Themelore e Gjilanit në mars të vitit 2021, kryerësi i veprës që ishte 18 vjeçar ishte dënuar me tri vite burgim për bashkësi jashtëmartesore me një vajzë 13 vjeçare. Në gusht 2021, e njëjta gjykatë mori një vendim për një rast të ngjashëm me një burrë 25 vjeçar dhe një vajzë 13 vjeçare. Kryerësi i veprës është dënuar me dy vjet e gjashtë muaj burg. Rrethanat lehtësuese në të dyja rastet ishin pranimit i fajit, pendimi dhe kërkimi i faljes ndaj viktimës. Në rastin e parë, ishte premtimi i kryerësit të veprës për t'u martuar me viktimën që u konsiderua si rrethanë lehtësuese. Në rastin e dytë, rrethanë lehtësuese ishte se kryerësi i veprës kishte filluar bashkësi jashtëmartesore me pëlqimin e prindërve të viktimës. Ky është një shqetësim serioz veçanërisht sepse, sipas nenit 240 paragrafi 2 të KP, prindi, prindi adoptues, kujdestari ose personi tjetër që lejon ose nxit bashkëjetesën në bashkësi jashtëmartesore i nënshtrohet të njëjtit dënim si kryerësi i veprës. Megjithatë, PTH dhe gjykatat e informuan Misionin se prindërit

ishin paditur vetëm në një numër shumë të vogël të rasteve. Përkundrazi, siç tregon edhe rasti i lartpërmendur, leja nga prindërit e viktimës është parë si rrethanë lehtësuese.

Përveçse janë të paligjshme sipas KP, bashkësitë jashtëmartesore para moshës 16 vjeçare shkelin shumë nga të drejtat themelore të njeriut të viktimave, duke përfshirë të drejtën për arsimim, liri nga dhuna, qasje në kujdesin shëndetësor riprodhues dhe seksual, punësim, lirinë e lëvizjes, dhe të drejtën për martesë konsensuale, të gjitha këto të drejta të përcaktuara në instrumentet ndërkombëtare të drejtave të njeriut të aplikueshme në Kosovë sipas nenit 22 të Kushtetutës së saj³⁹. Viktimat janë të privuara nga fëmijëria e tyre, arsimimi i tyre, shëndeti i tyre rrezikohet nga shtatzënitë e hershme dhe lindjet e fëmijëve, dhe siguria e tyre kërcënohet pasi ato bëhen të varura nga kryerësi i veprës dhe, për rrjedhojë, kanë më shumë gjasa të ekspozohen ndaj dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës ndaj grave dhe vajzave. Gjithashtu, meqenëse disa kryerës janë vetëm 16 vjeçar, shtrohet pyetja nëse ata vetë janë viktimat të lidhjeve në çift të aranzhuara nga familjet. Për shkak të pasojave të veprës së tillë penale, parandalimi dhe zbulimi i hershëm i krimit është vendimtar. Një qasje gjithëpërfshirëse, me përfshirje të të gjitha palëve relevante, është e nevojshme për të adresuar këtë fenomen.

Rekomandime:

- Qeveria e Kosovës dhe palët tjera relevante (Policia e Kosovës, prokuroria, gjykatat, Zyrat për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave, Qendrat për Mirëqenie Sociale) duhet të vazhdojnë me zbatimin e *Strategjisë kombëtare për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave 2022-2026*.
- Gjykatat themelore dhe Zyra e koordinatorit kombëtar kundër dhunës në familje duhet të vazhdojnë bashkëpunimin për regjistrim efektiv dhe të saktë të të dhënave për dhunën në familje në bazën e të dhënave.
- Grupi punues përgjegjës për hartimin e *Protokollit për referimin e rasteve të dhunës seksuale* duhet të sigurojë finalizimin me kohë të tij dhe të vendosen të gjitha masat nga institucionet përkatëse (Policia e Kosovës, prokuroritë, gjykatat, Zyrat për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave, Qendrat për Mirëqenie Sociale, Instituti i Mjekësisë Ligjore, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Punëve të Brendshme) për zbatimin e menjëhershëm të tij.
- Komisioni i Kuvendit të Kosovës për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione duhet ta finalizojë draftin e *Ligjit të ri për Dhunën në Familje dhe Dhunën ndaj Grave* dhe ta përcjellë atë për procedurë të mëtutjeshme në Kuvend.
- Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Zyra e koordinatorit kombëtar kundër dhunës në familje dhe Qendrat për Mirëqenie Sociale duhet të organizojnë fushata informuese për të trajtuar bashkësinë jashtëmartesore me person nën moshën 16 vjeçare. Fushatat duhet të synojnë popullatën e re dhe prindërit e tyre, veçanërisht ata në zonat e thella të Kosovës dhe nga komunitetet me më pak qasje në informacion, me qëllim të sensibilizimit për fenomenin dhe pasojat e mundshme si për viktimat ashtu edhe për kryerësit e veprave.

³⁹ Deklarata Universale e OKB-së për të Drejtat e Njeriut, Konventa evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (KEDNJ) dhe Protokollet e saj, Konventa e OKB-së për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave (CEDAW), Konventa e OKB-së mbi të drejtat e fëmijës, Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit).

- Këshilli Prokurorial i Kosovës duhet të zhvillojë dhe të zbatojë udhëzime të unifikuara për Policinë e Kosovës veçanërisht për hetimin e krimit të bashkësisë jashtëmartsore me person nën moshën 16 vjeçare.
- Policia e Kosovës duhet të hetojë dhe ndjekë përgjegjësini penale të prindërve të përfshirë në bashkësinë jashtëmartsore të fëmijëve të tyre në përputhje me dispozitat ligjore.
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Policia e Kosovës duhet të prodhojnë statistika të sakta, të qasshme dhe të krahasueshme për bashkëjetesën jashtëmartsore me personat nën moshën 16 vjeçare në mënyrë që si shpeshësia e këtij krimi ashtu edhe mënyra e adresimit të këtij krimi nga prokuroria dhe gjykatat të zbulohen dhe analizohen si duhet.
- Gjykatat duhet të ndjekin unifikimin e caktimit të dënimeve dhe të shqiptojnë dënime siç është e përcaktuar në *Kodin Penal*.
- Qendrave për Punë Sociale dhe Zyrave për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave duhet t'u sigurohen burimet e duhura nga Qeveria për të mbështetur viktimat gjatë gjithë ciklit gjyqësor.

3.5 Ndjekja penale e rasteve të terrorizmit

Pas kthimit në Kosovë të personave që ishin larguar për në zonat e konfliktit në Lindjen e Mesme gjatë dhjetë viteve të fundit⁴⁰, autoritetet vazhduan të hetojnë, të ndjekin penalisht dhe të gjykojnë veprat e supozuara penale të ndërlidhura, duke përfshirë edhe gjatë periudhës raportuese.

Më 17 korrik 2021, Kosova riatdhesoi 11 persona nga Siria: gjashtë burra, një grua dhe katër fëmijë. Pas kthimit, të gjashtë burrat u vendosën në paraburgim kurse gruaja në arrest shtëpiak, për shkak të dyshimit se kishin kryer vepra penale të ndërlidhura me terrorizmin. Më pas u hoqën të gjitha masat e sigurisë. Në nëntor dhe dhjetor 2021, Prokuroria Speciale (PSRK) ka ngritur shtatë aktakuza në Departamentin Special në Gjykatën Themelore të Prishtinës⁴¹ kundër të gjithë të rriturve. Ata u akuzuan për 'pjesëmarrje në një grup terrorist' në përputhje me *Kodin Penal të 2012-ës (KP)*⁴² për shkak të shkuarjes së tyre në Siri në vitin 2014 për t'iu bashkuar ISIS-it. Burrat dyshohet se kishin ndjekur trajnime ushtarake, ishin pajisur me armë dhe kishin marrë pjesë në beteja. Njëri prej tyre dyshohej se ishte instruktor për snajper. Gruaja udhëtoi me burrin e saj në Siri për t'iu bashkuar me ISIS-in dhe dyshohet se ofroi mbështetje në familje.

Pesë të pandehur e pranuan fajësinë në seancën fillestare ose gjatë shqyrtimit gjyqësor kurse dy u deklaruan të pafajshëm. Që nga marsi 2022, të gjitha rastet janë përfunduar në shkallë të parë dhe të gjithë të akuzuarit u shpallën fajtorë për pjesëmarrje në një grup terrorist; burrat u dënuan me burgim nga dy vjet e gjashtë muaj deri në katër vjet e gjashtë muaj, ndërsa gruaja u dënua me dy vjet me kusht. Koha e kaluar në paraburgim në Siri u mor parasysh vetëm në lidhje me një të pandehur (ai që kishte marrë dënimin më të gjatë). Të gjitha dënimet e shqiptuara nga

⁴⁰ Sipas 'Strategjisë së Kosovës për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm 2015-2020', 300 individë janë larguar nga Kosova që nga viti 2015 (shih faqen 11 të strategjisë). Një raport i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë i titulluar 'Zbërthimi i përgjigjes së Kosovës ndaj të kthyerve nga zonat e luftës në Siri dhe Irak', i publikuar në janar të vitit 2020, tregon se numri i vlerësuar i individëve që janë larguar nga Kosova për në Siri dhe Irak ishte 403. Raporti përmend se numri i të riatdhesuarve deri atëherë ishte rreth 250 (shih faqen 9).

⁴¹ Departamenti Special është themeluar me Ligjin për Gjykatat, 06/L-054, i cili ka hyrë në fuqi në fillim të vitit 2019. Është departamenti i specializuar në Gjykatën Themelore të Prishtinës dhe në Gjykatën e Apelit që trajton ekskluzivisht rastet nga Prokuroria Speciale (PSRK), gjegjësisht rastet më të rënda penale

⁴² Kodi Penal, 04/L-082, 1 janar 2013, neni 143, paragrafi 2: "Kushdo që merr pjesë në aktivitetet të grupit terrorist dënohet me burgim prej pesë (5) deri në dhjetë (10) vjet", me korrespondent në Kodit Penal, 06/L-074, 14 prill 2019, neni 136 paragrafi 2.

gjykata ishin nën minimumin e dënimit të paraparë për veprën përkatëse me *Kodin Penal (KP)*, përkatësisht pesë vjet. Pranimi i fajësisë nga pesë të pandehurit është shfrytëzuar si rrethanë kryesore lehtësuese gjatë shqiptimit të dënimit⁴³.

Aktgjykimet e Gjykatës Themelore për gjashtë të pandehurit meshkuj janë ankimuar. Nga muaji mars deri në maj të këtij viti, Gjykata e Apelit (GJA) i ka konfirmuar aktgjykimet ndaj dy të pandehurve, e ka rritur dënimin me burgim nga dy vjet e gjashtë muaj në tre për një të pandehur, e ka ndryshuar aktgjykimin për dy të pandehur vetëm në lidhje me periudhën që duhet të llogaritet si kohë e kaluar në paraburgim gjatë qëndrimit në Siri dhe një rast e ka kthyer në Gjykatën Themelore për rigjykim.

Nga pikëpamja procedurale, EULEX-i ka konstatuar se këto raste janë trajtuar në mënyrë efikase dhe të shpejtë si nga PSRK-ja ashtu edhe nga Departamenti Special në Gjykatën Themelore të Prishtinës. Nuk janë vërejtur vonesa të konsiderueshme, gjë që ka një rëndësi të veçantë duke qenë se shumica e të pandehurve ishin në paraburgim.

Megjithatë, nga pikëpamja thelbësore, Misioni vuri në dukje se dënimet e shqiptuara nga Gjykata Themelore dhe më vonë të konfirmuara nga GJA ishin padyshim të buta dhe në të gjitha rastet nën minimumin e përcaktuar nga ligji penal në fuqi⁴⁴. Ndërsa kjo lejohet nga *Kodi i Procedurës Penale (KPP)*, mund të ngrihen pyetje legjitime në lidhje me balancimin e duhur nga gjykata të rrethanave lehtësuese dhe rënduese në procedurat penale për vepra penale të peshës së ngjashme.

Një çështje tjetër që vlen të theksohet janë vlerësimet kontradiktore nga gjykatat nëse koha e kaluar në paraburgim në Siri duhet të merret parasysh kur llogaritet koha e mbetur për t'u vuajtur pas një dënimi përfundimtar, një çështje që kërkon konsistencë për të siguruar zbatimin e barabartë të ligjit.

Rekomandime:

- Policia e Kosovës, PSRK-ja dhe Departamenti Special në Gjykatën Themelore të Prishtinës duhet të vazhdojnë trajtimin efikas të rasteve të terrorizmit që kanë të bëjnë me të kthyerit nga zonat e konfliktit në Lindjen e Mesme.
- Gjykatat duhet ta rishikojnë praktikën e diskutueshme të politikës së butë të dënimeve në rastet e terrorizmit që kanë të bëjnë me të kthyerit, duke i kushtuar vëmendjen e duhur nevojës për konsistencë në dënime.

3.6 Liria e shprehjes - krimet kundër gazetarëve

Kur gazetarët janë viktime të veprave penale, institucionet e sundimit të ligjit duhet të ndërmarrin veprimet e duhura për të siguruar që liria e shprehjes të mos cenohet. Duke e marrë parasysh këtë, EULEX-i ka vlerësuar kornizën ligjore dhe trajtimin e disa krimeve të monitoruara kundër gazetarëve në Kosovë.

Sipas Raportit të Komisionit Evropian për Kosovën 2022, 'për sa i përket lirisë së shprehjes, Kosova ka një nivel të përgatitjes dhe përfiton nga një mjedis mediatik pluralist dhe i gjallë. Megjithatë, ekzistojnë shqetësime në lidhje me fushatat e shpifjeve publike, kërcënimet dhe sulmet fizike ndaj gazetarëve'⁴⁵.

43 Kodi Penal, 04/L-082, 1 janar 2013, neni 74, paragrafi 3.10, me korrespondent në Kodin Penal, 06/L-074, 14 prill 2019, neni 70, paragrafi 3.10.

44 Vërejtja e njëjtë është bërë në një raport të mëparshëm në lidhje me të kthyerit në vitin 2019, shih EULEX, Raporti i monitorimit të drejtësisë, gjetjet dhe rekomandimet shtator 2019 – mesi i marsit 2020, faqet 11-12.

45 Komisioni Evropian, 'Gjetjet kryesore të Raportit të 2022 për Kosovën', *Vështrime të KE-së për vendin*, Bruksel, këndi i shtypit

Në vitet e fundit, autoritetet prokuroriale dhe gjyqësore të Kosovës kanë ndërmarrë masa të rëndësishme për adresimin e krimeve kundër gazetarëve, duke përfshirë emërimin e prokurorëve dhe gjyqtarëve të specializuar, mbledhjen e statistikave dhe prioritetizimin e këtyre rasteve. Në secilën prej Prokurorive Themelore (PTH) caktohet nga një prokuror si koordinator për rastet e krimeve ndaj gazetarëve. Koordinatori vepron si pikë kontakti, mbledh të dhëna dhe i raporton koordinatorit të Kosovës në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit. Udhëzimet e brendshme parashikojnë prioritetizimin e këtyre rasteve, i cili është përcaktuar edhe si një nga objektivat në *Planin Strategjik të Sistemit Prokurorial 2022-2024*⁴⁶.

Gjatë periudhës raportuese, EULEX-i ka kërkuar informata për tetë raste të krimeve të kryera kundër gazetarëve të raportuara në Policinë e Kosovës nga tetori 2021 deri në mars 2022 (nga të cilat pesë kanë arritur në gjykata deri në datën e raportimit). Duke pasur parasysh numrin e vogël të rasteve të identifikuara, EULEX-i kërkoi informacione për rastet e viteve të kaluara nga PTH-të dhe Gjykatat Themelore (GJTH), në mënyrë që të jetë në gjendje të analizojë më mirë kohëzgjatjen dhe rezultatin e procedurave në këtë lloj të rasteve⁴⁷. Të dhënat e mbledhura tregojnë se veprat penale më të shpeshta të kryera ndaj gazetarëve ishin kërcënimet dhe ngacmimet përmes telefonit apo mediave sociale. Megjithatë, EULEX-i ka monitoruar edhe tre raste të sulmeve më të rënda kundër gazetarëve, të cilat të gjitha janë ende në fazën e hetimit. Një rast ka të bëjë me rrahjen e një gazetareje jashtë shtetësisë së saj nga autorë të shumtë në maj 2017, rasti i dytë është rasti i të shtënave drejt një makine të parkuar e cila ishte në pronësi të një gazetari në tetor 2020, ndërsa i treti është rasti i rrahjes së një gazetari jashtë shtetësisë së tij në shkurt 2021. Në 18 prej rasteve viktime ishte mashkull dhe në tri prej rasteve viktime ishte femër (në dy prej këtyre rasteve akuzat janë kanosje dhe në një prej tyre lëndim i rëndë trupor). Viktimat kanë punuar për mediat në vijim: Bota Sot, Kossev, RTV Dukagjini, Zëri, Jepi Zë (tri raste), Insajderi, Koha Vizion, Korrespondenti, Sinjali (dy raste), Objektivi, Gazeta Express, Gazeta Shneta, T7, Infokus, Paparaci dhe Gazeta Metro. Në dy raste, media nuk është e ditur.

EULEX-i gjeti se në rastet që janë në fazën e hetimeve, policia dhe prokuroria në përgjithësi kanë vepruar shpejt pas marrjes së raportit për incidentin, i cili nganjëherë ka rezultuar në ngritjen e një aktakuze menjëherë pasi rasti ishte raportuar në polici. Aktakuza janë ngritur në 7 nga 11 rastet e iniciuara gjatë vitit 2021 dhe 2022 dhe të gjitha janë ngritur brenda tre muajve pas paraqitjes së kallëzimit penal. Megjithatë, kur nuk është identifikuar ndonjë i dyshuar gjatë fazave të hershme të hetimit, rastet nuk kishin prioritet. Për shembull, në një rast kur një gazetar u sulmua rëndë, u deshën pothuajse nëntë muaj para se të përfundonte analiza e mostrave nga vendi i krimit. Është shqetësues fakti se në këtë rast, po ashtu edhe në dy rastet e tjera të monitoruara të sulmeve më të rënda, nuk mund të vërehej ndonjë përparim thelbësor.



të KE-së, 2022, https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/country_22_6090, (qasur më 14 tetor 2022).

46 Këshilli Prokurorial i Kosovës, 'Plani strategjik i sistemit prokurorial 2022-2024', 2022, [https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/STRATEGJIK%20PLAN%20OF%20THE%20PROSECUTORIALEM%20PROSECUTORIALEM%20S20%20%202024PLANI%20STRATEGJIK%20NË%20SISTEMI%20PROSECUTORIAL%20\(2022-2024\).pdf](https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/STRATEGJIK%20PLAN%20OF%20THE%20PROSECUTORIALEM%20PROSECUTORIALEM%20S20%20%202024PLANI%20STRATEGJIK%20NË%20SISTEMI%20PROSECUTORIAL%20(2022-2024).pdf) (qasur më 16 shtator 2022).

47 Më 2 nëntor, *Prishtina Insight* publikoi një artikull të titulluar 'Hetimi i BIRN: Gjykatat injorojnë rrethanat rënduese kur sulmohen gazetarët', i cili analizoi aktgjykimet në rastet e kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve në vitet e fundit dhe dosjet e hapura nga Prokuroria e Shtetit të cilat ishin duke u proceduar në gjykata për sulme dhe kërcënime ndaj gazetarëve. Krahasimi i të dhënave për numrin e aktakuzave të ngritura në vitin 2020 dhe 2021 tregon një mospërputhje mes këtij raporti dhe atij të lëshuar nga BIRN. BIRN dhe EULEX janë informuar se katër aktakuza janë ngritur në vitin 2020 dhe tetë në vitin 2021. Megjithatë, pasi që EULEX-it nuk i janë ofruar informata shtesë për dy nga këto raste, ky raport analizon vetëm tri aktakuza nga viti 2020 dhe shtatë nga viti 2021. Duke krahasuar të dyja raportet, bëhet e dukshme një mospërputhje sa i përket numrit të aktgjykimeve të analizuara: BIRN ka analizuar pesë raste penale në të cilat viktimat ishin gazetarë, të cilat janë gjykuar në shkallë të parë në gjykatat e Kosovës nga viti 2016 e deri më sot, ndërsa ky raport analizon 11 aktgjykime të nxjerra nga viti 2020 e deri më tani. Dallimi thelbësor te numri i aktgjykimeve të analizuara ka të ngjarë të jetë për shkak të faktit se Misioni kishte patur kontaktim shtesë me prokuroritë dhe gjykatat për të marrë informacione për aktgjykimet.

Sa i përket rasteve të monitoruara që kanë arritur në fazën gjyqësore, katër nga pesë rastet e raportuara nga tetori 2021 deri në mars 2022 kanë rezultuar me aktgjykime dënuese brenda disa javësh, në disa raste brenda pak ditësh, pas ngritjes së aktakuzës. Vlen të përmendet se në të katër rastet prokurori kishte ngritur aktakuzë derisa i dyshuari ishte i paraburgosur. Në rastin e pestë, në të cilin të dyshuarit nuk ishin në paraburgim, aktgjykimi kundër tre nga katër të pandehurit është nxjerrë shtatë muaj pas ngritjes së aktakuzës. Në bazë të dhënave shpesh për rastet e iniciuara para tetorit 2021, mund të konstatohet se kur i dyshuari nuk ka qenë në paraburgim, rastet nuk janë trajtuar me prioritet nga gjykata⁴⁸. Sipas Kodit të Procedurës Penale (KPP)⁴⁹, seanca fillestare duhet të caktohet brenda 30 ditëve nga ngritja e aktakuzës, një afat që rrallëherë respektohet në cilindo nga rastet.

Dënimet e shqiptuara në aktgjykimet që EULEX-i ka mundur t'i shqyrtojë pasi i ka kërkuar nga gjykatat përkatëse janë vlerësuar si të arsyeshme, duke marrë parasysh peshën e veprës penale, por edhe rrethanat lehtësuese, si pranimi i fajësisë apo mungesa e dënimeve paraprake. Fakti që krimi është kryer ndaj një gazetari është konsideruar në disa raste si rrethanë rënduese. Në raste të tjera, motivi i krimit ose nuk u shtjellua ose ishte i balancuar nga rrethanat lehtësuese. Në rastet e kanosjes është shqiptuar ose gjobë ose dënim me kusht, gjë që është e arsyeshme duke qenë se në të gjitha rastet kërcënimet janë kryer përmes telefonit ose rrjeteve sociale dhe jo personalisht. Në shumicën e rasteve, përmbajtja e kërcënimit ishte me sa duket kriteri më i rëndësishëm për të vendosur nëse do të shqiptohej një gjobë apo një dënim me kusht. Në rastin e tentativës për zjarrvënie, dënimi i shqiptuar ishte nën minimumin (dënim me burgim prej dhjetë muajsh, ndërsa minimumi është një vit). Fakti që bëhej fjalë për një vepër penale në tentativë, në krahasim me veprën penale të kryer, i mundësoi gjykatës uljen e dënimit dhe gjithashtu mori parasysh pranimin e fajësisë së të pandehurit dhe mungesën e dënimeve paraprake si faktorë lehtësues.



48 Ekzemplar: PP II nr. 5954/21, PP II nr. 5849/20, PP II nr. 4308/20 (të gjitha në Gjykatën Themelore të Prishtinës).

49 Kodi i Procedurës Penale, 04/L-123, 1 janar 2013, neni 242, paragrafi 4, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2861> (qasur më 14 tetor 2022).

Rekomandime:

- Policia e Kosovës duhet t'i ketë më tutje prioritet hetimet e rasteve të sulmeve ndaj gazetarëve dhe prokurorët duhet të sigurojnë që hetimet të mos zvarriten në mënyrë të panevojshme.
- Gjykatat duhet t'i japin përparësi rasteve të sulmeve ndaj gazetarëve dhe të caktojnë seancën fillestare brenda afatit prej 30 ditëve të përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale.
- Gjykatat duhet të kenë parasysh motivin e veprës penale dhe të arsyetojnë se si peshohet ky faktor me rrethanat e tjera gjatë caktimit të dënimit.
- Sistemi i koordinatorëve brenda sistemit prokurorial duhet të ruhet për të siguruar mbledhjen e të dhënave për ecurinë e rasteve.
- Koordinatorët/pikat e kontaktit duhet të caktohen në çdo Gjykatë Themelore. Ata duhet të jenë përgjegjës për mbledhjen e të dhënave për rastet dhe raportimin te koordinatori i Kosovës në mënyrë që të sigurohet se të dhënat janë të plota.

3.7 Drejtësia për të miturit: aplikimi i 'masave të diversitetit' për kryerësit e mitur

Gjatë periudhës raportuese, Misioni vlerësoi zbatimin e 'masave të diversitetit' ndaj kryerësve të mitur.

Standardet ndërkombëtare të drejtave të njeriut si *Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës*, e cila është pjesë e kornizës ligjore të Kosovës në përputhje me nenin 22 të Kushtetutës, kërkojnë krijimin e ligjeve, procedurave, autoriteteve dhe institucioneve të zbatueshme në mënyrë specifike për fëmijët në konflikt me ligjin penal dhe të ndara nga ato për të rriturit.

Arsyeja për të pasur një sistem të veçantë drejtësie për të miturit është se 'fëmijët dallojnë nga të rriturit në zhvillimin e tyre fizik dhe psikologjik dhe nevojat e tyre emocionale dhe arsimore' dhe 'këto dallime përbëjnë bazën për fajësinë më të vogël të fëmijëve në konflikt me ligjin'⁵⁰.

Objektivat kryesore të sistemeve të drejtësisë për të miturit janë promovimi i mirëqenies së të miturit dhe garantimi i interesave të tij më të mira gjatë gjithë procedurave apo veprimeve të ndërmarra ndaj tij⁵¹. Një tipar i rëndësishëm i një sistemi të drejtësisë për të miturit në përputhje me të drejtat e njeriut është ai i 'diversitetit' nga sistemi i drejtësisë penale, ku të miturit që vijnë në kontakt me ligjin hiqen nga procesi i drejtësisë penale dhe ridrejtohen në rrugë alternative, duke përfshirë shërbimet mbështetëse të komunitetit apo shërbime sociale.

Korniza ligjore e sistemit të drejtësisë për të miturit në Kosovë është plotësisht në përputhje me standardet përkatëse ndërkombëtare. *Kodi i Drejtësisë për të Mitur i Kosovës* (KDM), kapitulli IV, rregullon në mënyrë specifike 'masat e diversitetit' dhe përcakton se qëllimi i këtyre masave 'është të parandalojë, kurdoherë që është e mundur, fillimin e procedurave gjyqësore kundër një kryerësi të mitur, për të ndihmuar rehabilitimin pozitiv dhe riintegrimin e të miturit në komunitetin e tij dhe në këtë mënyrë të parandalojë sjelljen recidiviste'⁵². Zbatimi i 'masave të diversitetit' sjell edhe efekte pozitive për sa i përket efikasitetit të përgjithshëm, pasi shmang rritjen e numrit të lëndëve të grumbulluara në sistemin e drejtësisë.

50 Komiteti i OKB-së për të drejtat e fëmijës (KDF), *Komenti i përgjithshëm nr. 10 (2007), Të drejtat e fëmijëve në drejtësinë për të miturit*, 25 prill 2007, faqe 24, <https://www.refworld.org/docid/4670fca12.html>, (qasur më 20 tetor 2022).

51 Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, *Rregullat standarde minimale të Kombeve të Bashkuara për administrimin e drejtësisë për të mitur ('Rregullat e Pekinit')*, 10 dhjetor 1985, *Rregullat standarde minimale të Kombeve të Bashkuara për administrimin e drejtësisë për të mitur (Rregullat e Pekinit) - Kombet e Bashkuara dhe Sundimi i ligjit*, (qasur më 14 tetor 2022).

52 Kodi i Drejtësisë për të Miturit, 06/L-006, 2 nëntor 2018, neni 4, [B5AFE545-3908-4F63-98E0-0A8DD593B499.pdf \(rks-gov.net\)](https://www.rks-gov.net/B5AFE545-3908-4F63-98E0-0A8DD593B499.pdf), (qasur më 5 tetor 2022).

Llojet e ndryshme të ‘masave të diversitetit’ që mund të zbatohen për të miturit janë të renditura në nenin 20 të KDM-së dhe sillen nga pajtimi ndërmjet të miturit dhe të dëmtuarit, duke përfshirë kërkimin e faljes nga i mituri, dëmshpërblimin për të dëmtuarin, kryerjen e punës pa pagesë në komunitet dhe angazhimi në aktivitete bamirësie⁵³. Kushtet për aplikimin e ‘masave të diversitetit’ nga prokurorët përcaktohen në nenin 21 të po këtij Kodi⁵⁴. Prokurorët zgjedhin ‘masën e zbatueshme të diversitetit’ bazuar në historikun personal të miturit, siç vlerësohet nga Shërbimi Sprovues i Kosovës (SHSK), ndërsa ky i fundit siguron zbatimin e vendimit të prokurorëve.

EULEX-i e ka analizuar shqiptimin e ‘masave të diversitetit’ në Kosovë në periudhën 2019 – 2021. Duhet pasur parasysh se masa të tilla duhet të konsiderohen si opsioni i parë nga prokurorët në ato raste kur ligji e lejon. Të dhënat e marra nga Prokuroritë Themelore (PTH) dhe nga Shërbimi Sprovues i Kosovës (SHSK), institucioni përgjegjës për zbatimin e ‘masave të diversitetit’, zbuluan një rënie të numrit të ‘masave të diversitetit’ të aplikuara gjatë këtyre tri viteve.

Raportet Vjetore të SHSK-së tregojnë se 888 ‘masa të diversitetit’ janë zbatuar nga PTH-të ndaj kryerësve të mitur në vitin 2019, që kanë rënë në 544 në vitin 2020 dhe në 386 në 2021.

Nga 16 masat e renditura në *Kodin e Drejtësisë për të Mitur*, më e aplikuara ishte ‘pajtimi ndërmjet të miturit dhe të dëmtuarit’. Kjo e paraqet gjysmën e masave të aplikuara në vit nga PTH-të gjatë periudhës së monitoruar. Arsyeja kryesore për përdorimin e gjerë të kësaj mase duket të jetë se nuk ka nevojë të merren parasysh faktorë shtesë, përveç vullnetit të kryerësit, gjë që ndryshon kur zbatohen ‘masa tjera të diversitetit’. Bazuar në të dhënat e mbledhura nga EULEX-i, është e qartë se prokurorët për të mitur e konsiderojnë këtë si masën më efektive për të parandaluar përsëritjen e veprës penale dhe është aplikuar në një larmi të madhe të veprave penale.

EULEX-i krahasoi numrin vjetor të ‘masave të diversitetit’ me rastet e hapura që përfshijnë kryerës të mitur për të vlerësuar shpeshësinë e zbatimit të masave. Sipas raporteve vjetore të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), në vitin 2019 janë hapur 2027 kallëzime penale për kryerës të mitur dhe në 43% të tyre janë zbatuar “masa të diversitetit”⁵⁵. Në vitin 2020 ka pasur 1356 kallëzime penale me të mitur dhe në 40% të rasteve janë zbatuar ‘masa të diversitetit’⁵⁶. Në vitin 2021 ka pasur 1749 kallëzime penale për të mitur, por “masat e diversitetit” janë zbatuar vetëm në 22% të tyre⁵⁷.

53 Kodi i Drejtësisë për të Miturit, 06/L-006, 2 nëntor 2018, neni 20, [B5AFE545-3908-4F63-98E0-0A8DD593B499.pdf \(rks-gov.net\)](#), (qasur më 5 tetor 2022):


‘ 1. Masat e diversitetit që mund të shqiptohen ndaj kryerësit të mitur janë: 1.1. pajtimi mes të kryerësit të mitur dhe palës së dëmtuar, duke përfshirë kërkim faljen nga i mituri ndaj palës së dëmtuar; 1.2. pajtimi mes të miturit dhe familjes së tij; 1.3. kompensimi i dëmit palës së dëmtuar në bazë të marrëveshjes së ndërsjellë ndërmjet të dëmtuarit, të miturit dhe përfaqësuesit të tij ligjor, në përputhje me gjendjen financiare të të miturit; 1.4. vijimi i rregullt në shkollë; 1.5. pranimi i punësimit apo trajnimit në një profesion adekuat me aftësitë dhe shkathësitë e tij; 1.6. kryerja e punës pa pagesë në dobi të përgjithshme në pajtim me aftësinë e kryerësit të mitur për kryerjen e punës së tillë. Kjo masë mund të shqiptohet me pëlqimin e të miturit në kohëzgjatje prej dhjetë (10) deri në gjashtëdhjetë (60) orë; 1.7. edukimi për rregullat e trafikut; 1.8. këshillimi psikologjik; 1.9. angazhimi në aktivitete bamirësie; 1.10. pagesa e një shume të caktuar të hollave të destinuara për qëllime bamirësie apo program për kompensim të viktimave në përputhje me gjendjen financiare të miturit; 1.11 angazhimi në aktivitete sportive dhe rekreative, 1.12 këshillimi mes familjeve të miturve; 1.13. përmbajtja nga çdo kontakt me individë të caktuar që mund të kenë ndikim negativ tek i mituri; 1.14. të mos vizitojë vende ose mjedise të caktuara që mund të kenë ndikim negativ tek i mituri, dhe 1.15. abstenimi nga përdorimi i drogës dhe i alkoolit; 1.16. vërejtja policore’.

54 Kodi i Drejtësisë për të Miturit, 06/L-006, 2 nëntor 2018, Neni 21, [B5AFE545-3908-4F63-98E0-0A8DD593B499.pdf \(rks-gov.net\)](#), (qasur më 5 tetor 2022): ‘ 1. Masat e diversitetit mund të shqiptohen nga prokurori, ndaj të miturit i cili ka kryer vepër penale për të cilën është paraparë dënimi me gjobë apo me burgim deri në tri (3) vite ose për vepër penale të kryer nga pakujdesia për të cilën është paraparë dënimi deri në pesë (5) vite burgim, me përjashtim të atyre të cilat sjellin si pasojë vdekjen. 2. Masa e vërejtjes policore nga paragrafi 1, nën paragrafi 1.16 i neni 20 të këtij Kodi mund të caktohet ndaj të miturit si kryes i veprës penale për herë të parë për vepra penale për të cilat është paraparë dënimi me gjobë ose dënimi me burg deri në tri (3) vite. 3. Vërejtjen policore si masë të diversitetit e shqipton zyrtari policor me lejen e prokurorit të shtetit për të mitur. Policia mban evidencën e vërejtjeve policore të shqiptuara, që nuk kanë karakter të evidencës sikur ato tek të miturit e dënuar, dhe nuk mund të përdoret në asnjë mënyrë që do ta dëmtonte të miturin. 4. Kushtet për shqiptimin e masës së diversitetit janë: 4.1. pranimi i përgjegjësisë për veprën penale nga i mituri; 4.2. shprehja e gatishmërisë nga i mituri që të pajtohet me palën e dëmtuar dhe 4.3. pëlqimi i të miturit ose i prindit, prindit adoptues ose kujdestarit në emër të miturit për të zbatuar masën e shqiptuar të diversitetit. 5. Mospërbushja e obligimeve të masës së diversitetit nga ana e të miturit raportohet menjëherë nga Shërbimi Sprovues tek autoriteti kompetent i cili mund të vendosë për rifillimin e ndjekjes penale të rastit’.

55 Raportet vjetore të KPK-së, 2019, 2020 2021, [Sistemi prokurorial \(prokuroria-rks.org\)](#), (qasur më 16 shtator 2022).

56 Këtu përfshihen 108 raste në të cilat është aplikuar masa e diversitetit në vitin 2020, por që janë bartur nga viti/vitet e mëparshëm.

57 Këtu përfshihen 62 raste në të cilat është aplikuar masa e diversitetit në vitin 2021, por që janë bartur nga viti/vitet e mëparshëm.



Raportet vjetore të KPK-së nuk ofrojnë të dhëna të ndara sipas gjinisë, ndërsa SHSK-ja filloi të publikojë statistika të ‘masave të diversitetit’ të aplikuara duke përdorur të dhëna të ndara sipas gjinisë nga viti 2020. Në vitin 2020, 399 ‘masa të diversitetit’ janë zbatuar për djemtë dhe 49 për vajzat. Pajtimi në mes të kryerësve të mitur dhe të dëmtuarit është zbatuar për 233 djem dhe 24 vajza. Në vitin 2021, u zbatuan 294 ‘masa të diversitetit’ për djemtë dhe 30 për vajzat. Nga kjo, ‘masa e pajtimit’ është aplikuar për 177 djem dhe 20 vajza.

Masa e dytë më e aplikuar ishte ‘kryerja e punës në dobi të përgjithshme’. Në vitin 2020 është aplikuar 57 herë për djemtë dhe pesë herë për vajzat, dhe në vitin 2021 është aplikuar 18 herë për djemtë dhe një herë për një vajzë. Masa e tretë më e aplikuar ishte ‘këshillimi psikologjik’, e cila u zbatua nga prokurorët për të mitur në vitin 2020 për 37 djem dhe dy vajza, ndërsa e njëjta masë u zbatua për 43 djem dhe tre vajza në vitin 2021⁵⁸.

Përveç kësaj më sipër, gjatë periudhës së monitoruar janë zbatuar masat e mëposhtme: ‘vijimi i rregullt në shkollë’, ‘kompensimi i dëmit palës së dëmtuar në bazë të marrëveshjes së ndërsjellë’, ‘angazhimi në aktivitete bamirësie’, detyrimi për t’u përmbajtur nga çfarëdo kontakti me individë të caktuar që mund të kenë ndikim negativ tek i mituri, ose të përmbahet nga përdorimi i drogës dhe i alkoolit.

Përderisa këto masa zbatohen nga prokurori pas konsultimit me SHSK-në, ekziston një ‘masë e diversitetit’ që mund të zbatohet nga policia, me miratimin e prokurorit, përkatësisht ‘vërejtja policore’. Kjo masë u fut në përdorim në Kosovë në vitin 2018 me hyrjen në fuqi të *Kodit të ri të Drejtësisë për të Mitur* dhe ngriti shumë shqetësime tek praktikuesit, të cilët kishin frikë se policia nuk ishte mjaftueshëm e trajnuar dhe e aftë për ta shqiptuar këtë masë⁵⁹. ‘Vërejtja policore’ ka për qëllim të përdoret në rastet penale të vogla kur policia dhe prokurori vendosin

⁵⁸ Sipas raporteve vjetore të SHSK-së.

⁵⁹ Kodi i Drejtësisë për të Miturit, 06/L-006, 02 nëntor 2018, neni 21, [B5AFE545-3908-4F63-98E0-0A8DD593B499.pdf \(rks.gov.net\)](https://www.rks.gov.net), (qasur më 16 shtator 2022):

Masa e vërejtjes policore [...] mund të caktohet ndaj të miturit si kryes i veprës penale për herë të parë për vepra penale për të cilat është paraparë dënimi me gjobë ose dënimi me burg deri në tri (3) vite. Vërejtjen policore si masë të diversitetit e cakton zyrtari policor me lejen e prokurorit të shtetit për të mitur. Policia mban evidencën e vërejtjeve policore të shqiptuara, që nuk kanë karakter të evidencës sikur tek të miturit e dënuar, dhe nuk mund të përdoret në çfarëdo mënyre që do ta dëmtonte të miturin.

se nuk nevojiten hetime të mëtejshme dhe se një vërejtje do të mjaftonte që një i mitur ta kuptojë peshën e veprës penale, të pendohet dhe të përmbahet nga sjellje të ngjashme në të ardhmen. Që nga hyrja e saj në fuqi në vitin 2018, kjo masë është aplikuar rrallë.

Rekomandime:

- Për t'i penguar efektet negative të procedurave të mëvonshme në administrimin e drejtësisë për të miturit (për shembull, stigma e dënimit dhe dënimi), prokuroritë dhe policia duhet të përdorin maksimalisht 'masat e diversitetit' siç i parashikon ligji.
- 'Masa e diversitetit' e 'vërejtjes policore' duhet të zbatohet më shpesh në rastet që i plotësojnë kriteret e nevojshme.
- Duke i marrë parasysh rezultatet e mira të arritura në vitet e kaluara, puna ekzistuese plotësuese e prokurorëve për të mitur dhe Shërbimit Sprovues të Kosovës duhet të vazhdojë të zhvillohet.
- Në mënyrë që të përfshihet aspekti gjinor në sistemin e drejtësisë për të mitur, duke përfshirë zbatimin e 'masave të diversitetit', Këshilli Prokurorial i Kosovës duhet të ndjekë shembullin e dhënë nga Shërbimi Sprovues i Kosovës dhe të përfshijë të dhëna të ndara sipas gjinisë në raportet vjetore të tij.

3.8 Të drejtat pronësore

Sipas *Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut* (KEDNJ), çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij/saj.⁶⁰ Gjatë periudhës raportuese, Misioni ka monitoruar 50 raste civile për konteste pronësore të ndryshme, si kthim i pronës, konfirmim i pronësisë, uzurpim i paligjshëm, transaksione mashtruese, kompensim i dëmeve dhe ekzekutim i aktgjykimeve të paraqitura nga paditës serbë të Kosovës, që pothuajse të gjithë banojnë jashtë Kosovës.

Misioni konstatoi se gjetja më shqetësuese ishte kohëzgjatja e tepruar e procedurave. Lëndët shpesh kanë qenë në pritje për shtatë ose tetë vite, disa prej tyre edhe për dhjetë vite, ku lënda më e vjetër në pritje është dërguar në gjykatë në vitin 2002. Neni 6(1) i KEDNJ kërkon që çdo rast duhet të gjykohet 'brenda një kohe të arsyeshme'⁶¹, ndërsa gjatë periudhës raportuese seanca dëgjimore janë mbajtur për shumë pak raste.

Numri i madh prej 70,000 lëndëve civile që janë në pritje nëpër gjykata është një arsye për këto vonesa. Për më tepër, gjykatat e shkallëve më të larta shpesh kthejnë lëndë për rigjykim, çka e

⁶⁰ Protokollin e Konventës për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, i miratuar më 20 Mars 1952, Neni 1, [Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut \(coe.int\)](#) (qasur më 4 nëntor 2022): 'Çdo person fizik ose juridik ka të drejtë të gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga pronat e tij, përveçse për interesin publik dhe sipas kushteve të parapara me ligj dhe parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare'.

⁶¹ Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ), neni 6 (1), e miratuar më 4 nëntor 1950, [Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut \(coe.int\)](#) (qasur më 4 nëntor 2022): 'Në përcaktimin e të drejtave civile dhe obligimeve të tij apo të çfarëdo akuze penale kundër tij, secili ka të drejtë për gjykim të drejtë dhe publik brenda një kohe të arsyeshme nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e themeluar me ligj. Vendimi do të shpallet publikisht, por shtypi dhe publiku mund të përjashtohen nga i gjithë gjykimi ose nga ndonjë pjesë e gjykimit në interes të moralit, rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, ku interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve e kërkojnë këtë, ose në masën tejet të domosdoshme sipas mendimit të gjykatës në rrethana të veçanta ku publiciteti do të cenonte interesat e drejtësisë'.

vonon më tej procedurën. Shumë nga 50 rastet e monitoruara u ngadalësuan në nivel të GJA. Praktikrat e ndryshme administrative, nganjëherë penguese, i bëjnë procedurat civile edhe më të rënda dhe për këtë arsye më të gjata. Për shembull, kur paraqitet një padi civile jo e plotë, nga monitorimi është vërejtur se gjykata shpesh kërkon dokumentet që mungojnë shumë kohë pas pranimit të padisë, ndonjëherë edhe pasi gjyqtarit të caktuar i është dorëzuar lënda. Kjo e shtyn edhe më tej procedurën gjyqësore, veçanërisht në rastet në të cilat paditësit janë serbë të Kosovës të cilët nuk banojnë në Kosovë dhe kështu shpesh marrin dokumente dhe thirrje gjyqësore me vonesa të konsiderueshme.

Burimet e pamjaftueshme të përkthimit nëpër gjykata kanë kontribuar gjithashtu në vonesa të konsiderueshme. Në disa raste, dokumentet nuk ishin përkthyer, ose seancat gjyqësore nuk janë caktuar për shkak se nuk kishte në dispozicion përkthyes/interpret gjyqësor. Në një rast, asnjë përkthyes/interpret gjyqësor nuk u caktua për tri vite, duke shkaktuar këtë vonesë të konsiderueshme. Në një rast tjetër, vendimi i gjykatës nuk ishte përkthyer në serbisht për më shumë se një vit, andaj nuk ka mundur t'i dorëzohet palës, duke shkaktuar vonesa të paarsyeshme në procedurën përmbartimore.

Procedurat civile në lidhje me shitblerje të tokave shpesh janë subjekt i vonesave duke pasur parasysh situatën specifike të regjistrave të tokës. Meqenëse shitblerjet e tokave ndërmjet serbëve të Kosovës dhe shqiptarëve të Kosovës nuk inkurajoheshin gjatë kohës së Jugosllavisë, ato shpesh nuk regjistroheshin siç duhet edhe pse marrëveshjet ishin bërë dhe paratë ishin paguar. Kjo ndonjëherë i bën procedurat të rënda pasi është e vështirë të verifikohen transaksionet.

Shkaqe shtesë për kohëzgjatjen e tepruar të procedurave në kontestet pronësore lidhen me vështirësitë për gjetjen e ekspertëve gjyqësorë, ndërrimet e shpeshta të gjyqtarëve të caktuar, çështjet që kanë të bëjnë me thirrjen e trashëgimitarit/përfaqësuesit ligjor të palës së vdekur dhe ndjeshmëritë ndëretnike në disa prej rasteve të monitoruara.

Rekomandime:

- KGJK duhet të vendosë një normë që përcakton numrin minimal të lëndëve që duhet të finalizohen nga secili gjyqtar brenda një afati kohor të caktuar.
- KGJK duhet të fuqizojë kapacitetin gjykatave për përkthim dhe interpretim në gjuhën serbe.
- Sistemi i ekspertëve gjyqësorë duhet të përmirësohet. Hap i parë do të ishte që KGJK të shpalltë si të papërshtatshëm për ekspertizë private ekspertin që refuzon pa arsye bashkëpunimin me gjykatën.
- Gjykatat t'i kushtojnë kujdes të shtuar rasteve etnikisht të ndjeshme pasi është tejet shqetësuese që shumë lëndë të monitoruara janë ende në pritje, në disa raste edhe me nga dy dekada pas paraqitjes së padisë, dhe ose nuk përparojnë fare ose përparojnë jashtëzakonisht ngadalë.

3.9 Privatizimi dhe likuidimi

EULEX-i ka monitoruar punën e ‘Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme’ (DHPGJS), e cila funksionon në kuadër të Gjykatës Supreme⁶² dhe ka juridiksion ekskluziv mbi të gjitha rastet që kanë të bëjnë me vendimet, aktivitetet ose punën e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) dhe Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM). Ajo gjithashtu ka juridiksion në procesin e privatizimit dhe likuidimit të ndërmarrjeve apo korporatave, duke përfshirë kërkesat e ish-punonjësve dhe çështjet që kanë të bëjnë me pronat nën administrimin e AKP-së.

Zbatimi i *Ligjit për DHPGJS për Çështjet që lidhen me Agjencinë e Privatizimit* ende nuk është përfunduar plotësisht, edhe pse kanë kaluar më shumë se tre vjet nga miratimi i tij më 30 maj 2019. Vetëm një kolegji apeli është në fuqi, ndërsa ligji kërkon dy⁶³. Arsyetimi i ofruar është se paneli i dytë nuk ka mundur të krijohej për shkak të mungesës së gjyqtarëve.

Sa i përket numrit të lëndëve të grumbulluara në DHPGJS, EULEX-i ka vërejtur një rënie të lehtë numerike të rasteve të zgjidhura dhe masave të përkohshme paraprake, nga 16,898 në mars 2021 në 16,027 në mars 2022. Paralelisht, AKP-ja, e cila është kontribuuesi kryesor në rastet e grumbulluara, është udhëzuar nga ana e qeverisë aktuale që t’i zvogëlojë aktivitetet e privatizimit, e cila si rezultat e uli ndjeshëm numrin e rasteve të reja.

Megjithatë, DHPGJS nuk do të jetë në gjendje të zgjidhë shumicën e rasteve brenda një kohe të arsyeshme. Shkaqet kryesore për këtë janë stafi i pamjaftueshëm i gjykatave (gjyqësor dhe administrativ) dhe mungesa e një norme të vendosur nga KGJK-ja e cila e tregon numrin minimal të rasteve që secili gjyqtar duhet t’i finalizojë brenda një afati të caktuar kohor.

EULEX-i ka vlerësuar rreth 80 aktgjykime të DHPGJS-së në mënyrë që të ketë një pasqyrë të cilësisë së aktgjykimeve dhe vendimeve të nxjerra nga kjo gjykatë. Çështja kryesore e vërejtur në rastet e analizuara lidhet me arsyetimet e dhëna nga Gjykata.

Në një rast, aktgjykimi i shkallës së parë përmbante katër faqe arsyetim duke cituar nene të ndryshme ligjore, por pa e dhënë një analizë të duhur pse dispozitat ligjore ishin të zbatueshme në këtë rast. Kështu, ishte e pamundur të identifikoheshin arsyet për refuzimin e ankesës si të pabazuar⁶⁴, një çështje që nuk u zgjidh nga kolegji i apelit.

Në një rast tjetër, ku aktgjykimi i shkallës së parë nuk analizoi dokumentet e provave të paraqitura nga paditësi (siç është vërejtur nga EULEX-i), kolegji i apelit në arsyetimin e tij arriti në përfundimin se ‘Aktvendimi për të ardhurat personale të tij nuk është provë e mjaftueshme që ai të përfshihet në listën përfundimtare të punonjësve të kualifikuar’⁶⁵, pa asnjë shpjegim të mëtejshëm.

Në një rast tjetër, ku arsyetimi i aktgjykimit të shkallës së parë mungonte plotësisht, kolegji i apelit dha arsyetimin e tij përfundimtar dhe e hodhi poshtë ankesën mbi bazën se ankuesi kishte arritur moshën e pensionit dhe kështu nuk kishte të drejtë për të ardhurat nga privatizimi.

Për më tepër, një çështje tjetër e vërejtur nga EULEX-i ishte se në shumë raste DHPGJS-ja vendosi

62 Ligji për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë e Privatizimit, 06/L-086, 12 korrik 2019, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=20290>, (qasur 13 tetor 2022).

63 . Ligji për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë e Privatizimit, 06/L-086, 12 korrik 2019, neni 4, paragrafi 10, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20290>, (qasur më 16 shtator 2022).

64 Lidhur me përmbajtjen e arsyetimit të një vendimi, ju lutemi referojuni GJEDNJ, Çështja Hiro Balani kundër Spanjës, Aktgjykimi i datës 9 dhjetor 1994.

65 Kjo ka të bëjë me një listë të punonjësve që konsiderohen të kualifikuar për të marrë një pjesë të të ardhurave nga privat-

të vazhdojë tutje pa mbajtur seancë dëgjimore me arsyetimin se palëve u ishte dhënë mundësia që t'i dorëzojnë deklaratat e tyre me shkrim. Megjithatë, kjo nuk është në përputhje me parimin e seancave gjyqësore publike⁶⁶. Aktualisht, veçanërisht pasi shumica e masave për COVID-19 janë hequr, nuk ka asnjë arsye që do të justifikonte një përjashtim nga ky rregull në këto raste.

Si përfundim, shumica e rekomandimeve të renditura në *Raportin e mëparshëm të EULEX-it për Monitorimin e Drejtësisë* nuk janë zbatuar. Vetëm dy gjyqtarë të rinj u rekrutuan, gjë që është e pamjaftueshme për ta zvogëluar numrin e madh të rasteve të grumbulluara brenda një periudhe të arsyeshme kohore.

Rekomandime:

- DHPGJS duhet të miratojë një strategji afatgjatë të zgjidhjes së rasteve të grumbulluara.
- DHPGJS duhet të miratojë një plan të mirëfilltë për ta zbutur mungesën e një numri të mjaftueshëm gjyqtarësh dhe zyrtarësh ligjorë. Rekrutimi i personelit për këto pozita duhet të ketë prioritet.
- KGJK-ja duhet të vendosë një normë për numrin e rasteve që pritet të përfundohen nga gjyqtarët e DHPGJS-së brenda një afati të caktuar kohor.
- DHPGJS duhet të vazhdojë të përdorë formularë model për trajtimin e kërkesave masive dhe të ngarkojë zyrtarët ligjorë për ta kryer punën përkatëse përgatitore, për shembull plotësimin paraprak të formularit, si një mjet për ta zvogëluar në mënyrë efektive numrin e rasteve të grumbulluara në një periudhë relativisht të shkurtër kohore.
- KGJK-ja duhet ta forcojë kapacitetin e gjykatave për përkthim dhe interpretim në gjuhën serbe, pasi që shumica e rasteve kanë të bëjnë me palët që kanë nevojë për përkthim/interpretim.
- DHPGJS duhet t'i kushtojë më shumë vëmendje arsyetimit dhe strukturës së vendimeve të saj. Arsyetimi duhet të jetë i kujdesshëm dhe në përputhje me jurisprudencën përkatëse të Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Arsyetimi duhet të jetë i kuptueshëm për palët, t'i përgjigjet të gjitha çështjeve të ngritura gjatë procedurës dhe të shmangë deklaratat kontradiktore.

izimi i kompanisë në fjalë.

66 Kodi i Procedurës Penale, 04/L-123, 01 janar 2013, neni 293, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2861>, (qasur më 27 tetor 2022).

SHTOJCA I – LISTA E RASTEVE TË MONITORUARA DHE TË REFERUARA

Pas themelimit të tij në vitin 2008, EULEX-it iu caktua mandat ekzekutiv në fushën e drejtësisë, që do të thotë se prokurorët dhe gjyqtarët ndërkombëtarë të EULEX-it kanë udhëhequr hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e rasteve të krimeve të luftës, krimit të organizuar, korrupsionit dhe krimeve tjera të rënda. Që nga qershori i vitit 2018, EULEX-i nuk e ka më këtë mandat dhe deri në dhjetor të vitit 2018 Misioni ka përfunduar transferimin e dosjeve përkatëse të rasteve tek autoritetet vendore të policisë, prokurorisë dhe gjyqësorit. Rastet e përmendura në këtë raport, dhe të cilat janë trajtuar nga EULEX-i gjatë mandatit të tij ekzekutiv, quhen ish-raste të EULEX-it.

ISH-RASTET E EULEX-IT⁶⁷

Rasti Olympus I (PKR 610/2016), i njohur edhe si ‘Rasti Toka’

Më 24 tetor 2016, prokuroria ka ngritur aktakuzë në Gjykatën Themelore të Prishtinës kundër Azem Sylës e të tjerë. Bëhet fjalë për 19 të pandehur të mbetur që janë aktualisht në proces gjyqësor. Rasti ka të bëjë me pronësinë e paligjshme të një pjese të madhe të pronave shoqërore në periudhën që nga viti 2006. Grupi dyshohet se ka arritur të regjistrojë pronësinë e pronave në favor të tyre përmes veprimeve korruptive duke shfrytëzuar persona në pozita kyçe nëpër gjykata, Zyrën Kadastrale dhe Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP). Vlera e përgjithshme e tregut e pronave llogaritet të jetë mbi 25 milionë euro. Nga nëntori i vitit 2018, Gjykata Themelore e Prishtinës ka mbajtur rregullisht seanca deri në mbylljen e lidhur me pandeminë COVID-19 në mes të marsit 2020. Pasi kryetari i trupit gjykues kaloi në Gjykatën e Apelit (GJA) në fund të vitit 2020, lënda iu caktua një kryetari të ri të trupit gjykues në fillim të vitit 2021 dhe gjykimi duhej të fillonte nga fillimi për shkak të kalimit të kohës që nga seanca e fundit. Në vitin 2022, një vonesë shtesë u shkaktua nga nevoja për përsëritjen e caktimit të një gjyqtari të ri, që prapë nënkuptonte rifillimin e shqyrtimit kryesor. Dy të pandehur kishin qenë në paraburgim (njëri për më shumë se shtatë vite dhe tjetri për më shumë se gjashtë vite), derisa në fund u liruan në arrest shtëpiak në qershor 2022. Gjykimi vazhdoi me seanca të rregullta dëgjimore dhe trupi gjykues vendosi të caktojë një ekspert psikiatrik për të vlerësuar nëse njëri nga të pandehurit ishte i aftë mendërisht për të dalë në gjyq.

Rasti Olympus II (PKR 611/2016)

Më 24 tetor 2016, prokuroria ngriti dy aktakuza në Gjykatën Themelore të Prishtinës në lidhje me rastet Olympus I dhe Olympus II në lidhje me pretendime për një grup të madh të organizuar kriminal që në mënyrë të kundërligjshme kishte fituar pronësinë e një pjese të madhe të pronës shoqërore në periudhën 2006 deri në 2016. Akuzat e aktakuzës së Rastit Olympus II kundër Baki Abdullahut, Haki Hysenit dhe 15 të pandehurve tjerë kufizohen në pastrimin e parave.

⁶⁷ Rastet e krimeve të luftës që EULEX-i i ka pasur në shqyrtim janë trajtuar në pjesën vijuese.

Më 3 shkurt 2020, gjykata bëri përpjekje të mbante seancën e parë, por kushtet ligjore nuk u plotësuan për shkak të mungesës së pesë të pandehurve, ku njëri prej tyre thuhet se jeton jashtë vendit. Seanca e 17 marsit 2020 u pezullua për shkak të pandemisë. Pas vonesave të gjata, seanca fillestare në këtë rast është mbajtur më 31 maj 2021. Pas seancës së dytë të këtij rasti, gjyqtari ka lëshuar aktvendim për hedhjen poshtë të aktakuzës më 22 korrik 2021. Ky aktvendim është apeluar nga Prokuroria Speciale (PSRK) dhe është rrëzuar nga Gjykata e Apelit (GJA) më 20 tetor 2021, e cila e ktheu lëndën në gjykatën e shkallës së parë. Aktualisht në këtë rast janë 16 të pandehur (një ka ndërruar jetë në ndërkohë), kryesisht të akuzuar për pastrim parash. Seancat dëgjimore janë zhvilluar rregullisht që nga maji 2022. Shpallja e aktgjykimit u bë më 7 nëntor 2022, të gjithë të pandehurit janë liruar nga akuza, ndërsa pronat e sequestruara do të lirohen.

Rasti Naser Kelmendi (PKR 32/2019)

Më 4 korrik 2014, prokuroria ka ngritur aktakuzë në Gjykatën Themelore të Prishtinës kundër Naser Kelmendit për krim të organizuar, vrasje të rëndë, për posedim, shpërndarje ose shitje të paautorizuar të narkotikëve dhe për prodhim dhe përpunim të paautorizuar të narkotikëve. Më 1 shkurt 2018, Gjykata e shpalli fajtor të pandehurin për veprën penale të posedimit, shpërndarjes ose shitjes së paautorizuar të narkotikëve dhe e dënoi me gjashtë vite burgim dhe e liroi nga të gjitha akuzat e tjera. Të dyja palët e apelian vendimin. Më 2 gusht 2018, GJA e dërgoi lëndën për rigjykim të kufizuar për veprën penale të posedimit, shpërndarjes ose shitjes së paautorizuar të narkotikëve, vërtetoi lirim nga akuza nga Gjykata Themelore për akuzat e tjera dhe urdhëroi ndërprerjen e paraburgimit për Naser Kelmendin. Më 6 nëntor 2019, më shumë se një vit pas këtij vendimi të GJA, u zhvillua seanca fillestare e rigjykimit dhe seanca e dytë u zhvillua më 29 dhjetor 2019. Rasti kaloi nga Departamenti i Krimeve të Rënda në Departamentin Special të Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe një seancë e re dëgjimore më në fund u mbajt më 26 janar 2022, e para që nga 29 dhjetori 2019. Që atëherë, gjykimi ka përparuar, pasi ka qenë joaktiv për gati tri vite.

Rasti Grande I (PKR 305/2016) dhe Rasti Grande II (PKR 254/19)

Më 16 dhjetor 2016, prokuroria ngriti aktakuzë kundër një grupi prej 20 të pandehurve, që përfshin Ukë Rugovën, djalin e ish-Presidentit Rugova, në Gjykatën Themelore të Prishtinës. Të pandehurit u akuzuan për organizim dhe pjesëmarrje në grup kriminal, kontrabandë të migrantëve dhe posedim, kontroll apo mbajtje të paautorizuar të armëve. Në aktakuzë pretendohet se të pandehurit kanë përdorur mjete mashtruese për të marrë viza Schengen për qytetarët e Kosovës nga Ambasada e Italisë në Kosovë, duke gjeneruar kështu përfitime të konsiderueshme materiale për veten e tyre.

Gjyqtari e ndau lëndën në korrik 2019 në dy të raste të ndara për ta bërë procedurën më efikase. Rasti *Grande I* tani përfshin pesë të pandehur, përfshirë Ukë Rugovën, ndërsa 15 të pandehurit e mbetur ishin grupuar në rastin *Grande II*. Gjykata zhvilloi rregullisht seanca për rastin *Grande I*, deri në mbylljen e lidhur me pandeminë COVID-19 në mesin e marsit 2020. *Grande I* ishte pothuajse në përfundim të procedurës së provave të shqyrtimit gjyqësor, pasi pothuajse të gjithë dëshmitarët (kishte dhjetëra dëshmitarë) ishin dëgjuar. *Grande II* po përparonte me një ritëm të arsyeshëm duke filluar nga janari 2020 deri në masat e mbylljes për shkak të pandemisë.

Të dyja rastet ishin udhëhequr nga i njëjti kryetar i trupit gjykues, i cili u degradua nga Departamenti i Krimeve të Rënda në shtator 2020, kështu që të dyja rastet u desh të rifillonin dhe iu caktuan një kryetari të ri të trupit gjykues. *Grande I* rifilloi më 16 prill 2021, me seanca dëgjimore të rregullta. Gjatë seancës së fundit, më 10 maj 2022, të pandehurit dhanë deklaratat e tyre përfundimtare dhe njëri prej tyre njoftoi gjykatën se ai ishte liruar nga akuza nga një gjykatë italiane për të njëjtat vepra penale, por aktgjykimi i pretenduar ende nuk është dorëzuar në Gjykatën Themelore të Prishtinës.

Procedurat gjyqësore aktuale të *Grande II* janë ende në fazën e provave. Seanca e caktuar për 6 maj 2021 ishte joproduktive. Më pas nuk u zhvilluan seanca të tjera deri më 6 prill 2022, kur edhe rifilluan seancat gjyqësore.

Rasti City Club (P 100/2018- P 253/2016 - PAKR 434/2018 - PKR 191/2020)

Më 21 korrik 2017, prokuroria ka ngritur aktakuzë kundër Granit Elshanit (në paraburgim që nga tetori 2016) në Gjykatën Themelore të Pejës. Ai është akuzuar se në janar të vitit 2010, në City Club në Pejë, kishte vrarë një person dhe kishte plagosur dy persona, përfshirë Valdet Kelmendin, i cili ishte cak i tij. Ky sulm u pa si i lidhur me një gjakmarrje në mes të familjeve Elshani dhe Kelmendi, e cila kishte vazhduar për 15 vite dhe gjatë së cilës ishin vrarë mbi njëzetë persona nga të dyja familjet. Më 30 maj 2018, Gjykata Themelore e Pejës (P 253/2016) e dënoi të pandehurin me dënim unik prej 25 vjetësh burgim për vrasje të rëndë, tentativë për vrasje të rëndë, shkaktim të rrezikut të përgjithshëm dhe përdorim dhe mbajtje të paligjshme të armës. I pandehuri apeloj vendimin dhe më 16 tetor 2018, GJA (PAKR 434/2018) e anuloi aktgjykimin e shkallës së parë. Rigjykimi filloi në janar 2019. Që atëherë, gjykata zhvilloi seanca të rregullta deri në masat e mbylljes të lidhura me pandeminë COVID-19 në mesin e marsit 2020.

Në fund të verës 2020, gjykata vazhdoi gjykimin dhe zhvilloi disa seanca. Shpallja e aktgjykimit ishte caktuar për datën 21 shtator 2020, por në vend të kësaj, kryetari i trupit gjykues ka rihapur shqyrtimin gjyqësor, me arsyetimin se procedura e provave nuk ishte shterur. Kryetari i trupit gjykues doli në pension në tetor 2020, dhe më pas Gjykata Themelore e Pejës e transferoi lëndën në Gjykatën Themelore të Gjakovës, pasi që e para nuk kishte mjaft gjyqtarë në Departamentin e Krimeve të Rënda. Rasti duhej të rifillonte në nëntor 2020 (PKR 191/2020) dhe që atëherë, seancat janë zhvilluar rregullisht. Shqyrtimi gjyqësor përfundoi me shpalljen e aktgjykimit më 14 mars 2022. I pandehuri është dënuar me dënim unik prej 24 vitesh burg për vrasje të rëndë, shkaktim të rrezikut të përgjithshëm dhe armëmbajtje pa leje. Aktgjykimi me shkrim u shpall më 2 qershor. Të dyja palët apeloan vendimin dhe lënda aktualisht ndodhet në GJA.

Rasti Toka 4 (PKR 130/2016)

Më 3 mars 2016, prokuroria ngri aktakuzë në Gjykatën Themelore të Prishtinës kundër 24 personave, ku përfshihen disa gjyqtarë. Rasti ka të bëjë me fitimin e paligjshëm të pronësisë së një pjese të madhe të tokës në pronësi shoqërore. Akuzat janë krim i organizuar, pastrim parash, nxjerrje e vendimeve gjyqësore të kundërligjshme dhe shpërdorim i pozitës zyrtare në lidhje me ri-regjistrimin e tokës në pronësi shoqërore. Më 27 nëntor 2014, gjyqtari i procedurës paraprake urdhëroi sekuestrimin e parcelave të tokës me vlerë rreth 20 milionë euro. Më 26 tetor 2017, u mbajt seanca e parë fillestare e vijuar nga dy seanca të tjera në prill dhe maj 2019. Rasti tani është në fazën e shqyrtimit kryesor, megjithatë asnjë seancë dëgjimore nuk ishte

caktuar deri më 20 maj 2022, kur disa pjesëmarrës, duke përfshirë një nga gjyqtarët, nuk ishin të pranishëm dhe seanca u shty. Seanca e caktuar për 20 korrik u anulua për shkak se kryetari i trupit gjykues ishte i sëmurë dhe që atëherë nuk janë caktuar seanca të tjera.

Rasti Arratisja nga spitali (PKR 685/2016)

Më 17 nëntor 2016, prokuroria ka ngritur aktakuzë në Gjykatën Themelore të Prishtinës kundër të pandehurve Emrush Thaqi, Sami Lushtaku dhe të tjerëve, me pretendime se ata kanë qenë pjesë e një grupi më të madh të të pandehurve të përfshirë në arratisjen nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK) në Prishtinë në maj 2014. Aktakuza i ngarkonte 24 të pandehurit për kryerjen e pretenduar të veprave penale të ndryshme, si arratisja e personave të privuar nga liria, mundësim të arratisjes së personave të privuar nga liria, keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar, lirim i paligjshëm i personave të privuar nga liria, dhënie e ndihmës kryerësve të veprave pas kryerjes së veprave penale, falsifikim i dokumenteve, pengim i dëshmisë apo procedurës zyrtare, frikësim gjatë procedurës penale dhe pjesëmarrje në grup të organizuar kriminal. Pas disa përpjekjeve të dështuara, seanca fillestare u mbajt më 6 dhjetor 2017. Gjatë gjykimit, në fund të vitit 2019, e pandehura Myrvete Hasani, bashkëshortja e Sami Lushtakut, pranoi fajësinë për mundësimin e arratisjes së personave të privuar nga liria në bashkëkryerje dhe ishte u dënua me gjashtë muaj burgim, i cili u shndërrua në një gjobë prej 3500 euro si pjesë e marrëveshjes për pranimin e fajësisë. Më 20 shkurt 2020, gjykata, me qëllim të përsheptimit të procedurës, vendosi të bëjë ndarje të procedurës kundër disa të pandehurve në lidhje me akuzat për frikësimin e dëshmitarëve. Që atëherë nuk është shënuar asnjë përparim në këtë pjesë të ndarë.

Më 14 prill 2020, Gjykata Themelore e Prishtinës shpalli aktgjykimin e saj për rastin kryesor, duke liruar nga akuza Sami Lushtakun dhe dy të akuzuarit e tjerë të profilit të lartë në *Rastin Drenica*, Sahit Jashari dhe Ismet Haxha, për arratisje nga paraburgimi në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) në Prishtinë nga 20 deri më 22 maj 2014. Edhe rojet e burgut të akuzuar se kanë ndihmuar në arratisjen e tyre janë liruar nga akuza. I pandehuri Sami Lushtaku dhe tre të akuzuarit tjerë, të cilët ishin punonjës të Qendrës së Paraburgimit në Dubravë, janë shpallur fajtorë dhe janë dënuar për dy raste të tjera të arratisjes të datës 21 gusht dhe 22 shtator 2015. Sami Lushtaku është dënuar me gjobë prej 12 mijë eurosh, ndërsa rojet e burgut u dënuan me nga 1000 euro secili.

Më 30 tetor 2020, GJA vendosi se ankesa e PSRK-së ishte pjesërisht e bazuar dhe e dërgoi rastin e dy prej të pandehurve, të cilët ishin liruar në shkallë të parë, për rigjykim në Gjykatën Themelore të Prishtinës. Bëhet fjalë për Emrush Thaçin, ish-Drejtor i Qendrës së Paraburgimit në Prishtinë, i akuzuar për keqpërdorim të pozitës, dhe Nexhib Shatri, mjek në Qendrën e Paraburgimit në Dubravë, i akuzuar gjithashtu për keqpërdorim të pozitës në lidhje me falsifikimin e dokumenteve dhe lehtësimin e arratisjes së personave të privuar nga liria. Po ashtu, GJA e pranoi pjesërisht ankesën e PSRK-së lidhur me dënimet e tre zyrtarëve korrektues të Dubravës dhe i ndryshoi ato me dënime me kusht prej gjashtë muajsh burgim, ndërsa Gjykata Themelore kishte shqiptuar vetëm gjoba prej 1000 euro. Vendimi i GJA konfirmoi gjithashtu parashkrimin e veprave kundër tre të pandehurve të profilit të lartë Sami Lushtaku, Sahit Jashari dhe Ismet Haxha, për arratisje nga paraburgimi në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) në Prishtinë nga data 20 deri më 22 maj 2014. Pjesa tjetër e aktgjykimit të shkallës së parë ka mbetur e pandryshuar.

Më 16 mars 2021, në Gjykatën Themelore të Prishtinës u mbajt seanca fillestare për rigjykimin e Emrush Thaçit dhe Nexhib Shatrit dhe seancat ishin zhvilluar rregullisht derisa të dy u liruan nga akuza më 21 shkurt 2022. Ky aktgjykim është ankimuar nga prokurori.

Rasti Medicus (PKR 315/2018)

Më 15 tetor dhe më 20 tetor 2010, prokuroria ngriti dy aktakuza në Gjykatën Themelore të Prishtinës (të bashkuara në një rast në nëntor 2010) kundër shtatë personave të akuzuar për trafikim me organe njerëzore, krim të organizuar dhe krime të tjera të rënda. Në aktakuzë pretendohet se dhjetëra transplantime ilegale të veshkave janë bërë në Klinikën Medicus gjatë vitit 2008. Të pandehurit kryesorë ishin urologu Lutfi Dervishi, i cili ishte pronar i klinikës, dhe djali i tij, Arban Dervishi, i cili e menaxhonte atë. Më 29 prill 2013, Gjykata Themelore e Prishtinës (trup gjykues me shumicë nga EULEX-i, d.m.th. shumica e gjyqtarëve të trupit gjykues ishin gjyqtarë ndërkombëtarë të EULEX-it) i shpalli të pandehurit fajtorë për trafikim me njerëz dhe krim të organizuar dhe e dënoi Lutfi Dervishin me tetë vite burgim dhe Arban Dervishin me shtatë vite e tre muaj. Një tjetër i pandehur në këtë rast, Sokol Hajdini, kryeanesteziolog i klinikës, është dënuar me tri vite burgim. Më 6 nëntor 2015, GJA (me trup gjykues me shumicë nga EULEX-i) konfirmoi vendimin.

Arban Dervishi dhe Lutfi Dervishi, më 8 mars 2016 dhe 5 prill 2016, përkatësisht, parashtruan kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër vendimit të GJA. Më 7 mars 2016, edhe Sokol Hajdini parashtroi ankesë kundër të njëjtit vendim të GJA. Më 20 shtator 2016, Gjykata Supreme (trup gjykues me shumicë nga EULEX-i) e liroi të pandehurin Sokol Hajdini nga akuzat për krim të organizuar dhe e shpalli fajtor për veprën penale të lëndimit të rëndë trupor. Më 15 dhjetor 2016, Gjykata Supreme, me trup gjykues tashmë të përbërë me shumicë të gjyqtarëve vendor, nxori vendimin për kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitura nga Arban dhe Lutfi Dervishi. Vendimi i anuloi dënimet për Lutfi dhe Arban Dervishin dhe Sokol Hajdinin dhe e ktheu lëndën në Gjykatën Themelore të Prishtinës për rigjykim. Të pandehurit e tjerë ose ishin liruar nga akuzat më parë, ose akuzat ishin hedhur poshtë. Më 11 janar 2017, Gjykata Themelore e Prishtinës caktoi masën e paraburgimit kundër Lutfi Dervishit, si dhe lëshoi një fletarrestim ndërkombëtar kundër Arban Dervishit, i cili ishte në arrati.

Më 24 maj 2018, Gjykata Themelore e Prishtinës (trup gjykues me shumicë nga EULEX-i) e shpalli Lutfi Dervishin fajtor për trafikim me njerëz dhe krim të organizuar dhe i shqiptoi një dënim prej shtatë vite e gjashtë muaj burgim, një gjobë prej 8000 euro dhe një ndalim të ushtrimit të profesionit të urologut për një periudhë dy vjeçare duke filluar nga dita e vuajtjes së plotë të dënimit me burg. Sokol Hajdini është shpallur fajtor për lëndim të rëndë trupor dhe është dënuar me një vit burgim.

Më 6 nëntor 2018, GJA, duke vendosur për ankesat e të pandehurve Lutfi Dervishi dhe Sokol Hajdini kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës të datës 24 maj 2018, e anuloi aktgjykimin dhe e dërgoi lëndën në rigjykim të dytë. Aktgjykimi i Sokol Hajdinit u anulua pasi vepra kishte arritur parashkrimin absolut. Arban Dervishi u kthye në Kosovë në vitin 2019 dhe urdhër arresti ndërkombëtar ndaj tij u pezullua.

Më 20 janar 2020 u shty seanca e parë e rigjykimit të dytë ndaj të pandehurve Lutfi dhe Arban Dervishi. Seanca u caktua më 2 mars 2020, por nuk u mbajt për shkak të kufizimeve të lidhura me pandeminë. Seanca e radhës u mbajt më 27 tetor 2020, pas së cilës gjykimi u shty për një

kohë të pacaktuar për të dhënë kohë për gjetjen e dëshmitarëve/palëve të dëmtuara. Pas më shumë se një viti pasiviteti për shkak të vështirësisë për gjetjen e numrit të konsiderueshëm të dëshmitarëve, një seancë ishte planifikuar të zhvillohej më 1 mars 2022, por u desh të anulohet për shkak të grevës së stafit të administratës në gjykatë. Po ashtu, gjyqtari kishte bërë disa kërkesa për përjashtim nga rasti për arsye të ndryshme, të gjitha të refuzuara nga Kryetari i Gjykatës Themelore të Prishtinës. Një seancë e re dëgjimore u caktua për datën 9 shtator 2022, kur rigjykimi duhej të fillonte nga fillimi duke qenë se seanca e fundit produktive ishte zhvilluar në vitin 2020. Në këtë drejtim, seanca të mëtejme janë duke u planifikuar.

ISH-RASTET E KRIMEVE TË LUFTËS TË EULEX-IT

Rasti Drenica I (PKR 74/2018)

Më 6 nëntor 2013, prokuroria ngriti aktakuzë në Gjykatën Themelore të Mitrovicës kundër shtatë të pandehurve të akuzuar për kryerjen e krimeve të luftës kundër popullatës civile gjatë periudhës qershor deri shtator 1998 në lidhje me Qendrën e Paraburgimit të UÇK-së në Likoc të Skenderajt. Më 27 maj 2015, gjykata e shkallës së parë i liroi nga akuza të pandehurit Sabit Geci, Ismet Haxha, Sahit Jashari dhe Avni Zabeli, që u konfirmua në shkallë të dytë nga ana e Gjykatës së Apelit më 15 shtator 2016. Sami Lushtaku u shpall fajtor me aktgjykim të shkallës së parë për vrasje të rëndë dhe përgjegjësi komanduese për cenim të integritetit trupor dhe shëndetit të një numri të pidentifikuar të civilëve dhe e apeloj aktgjykimin. Ai u lirua nga akuzat për vrasje në shkallë të dytë me aktgjykimin e lartpërmendur të GJA të datës 15 shtator 2016. Më pas, së bashku me Sylejman Selimin, ai u lirua edhe nga akuza e mbetur e përgjegjësisë komanduese me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të datës 3 korrik 2017, pas së cilës ai u lirua. Ai aktgjykim i Gjykatës Supreme për rastin 'Drenica I' konfirmoi dënimin e Gjykatës së Apelit më 15 shtator 2016 të Jahir Demakut (i cili në shkallën e parë ishte liruar nga akuza por pas ankesës së prokurorisë u shpall fajtor nga GJA) dhe Sylejman Selimit për cenim të integritetit trupor dhe shëndetit të një mashkulli të pidentifikuar nga zona e Shipolit në Mitrovicë duke e rrahur atë vazhdimisht.

Më 11 qershor 2018, Gjykata Supreme e dërgoi lëndën për rigjykim në Gjykatën Themelore të Mitrovicës (pasi aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese i datës 7 qershorit 2018 kishte rrëzuar aktgjykimin e Gjykatës Supreme të datës 19 korrik 2017 në lidhje me rastin *Drenica II* dhe e kishte dërguar atë për rishqyrtim) dhe të dy të pandehurit e dënuar janë liruar nga vuajtja e dënimit. Mirëpo, Jahir Demaku dhe Sylejman Selimi vazhduan burgimin për të vuajtur dënimin e shqiptuar në lidhje me aktgjykimin *Drenica II*, derisa me vendimet e Panelit për Lirim me Kusht të 24 tetorit 2018 dhe 25 janarit 2019 janë liruar me kusht. Pas krijimit të Departamentit Special në Gjykatën Themelore të Prishtinës⁶⁸, Gjykata Themelore e Mitrovicës e dërgoi rastin në Departamentin Special në Gjykatën Themelore të Prishtinës, duke konsideruar se nuk ishte më nën juridiksionin e saj. Në prill të vitit 2019, Departamenti Special në Gjykatën Themelore të Prishtinës e kishte kthyer lëndën në Gjykatën Themelore të Mitrovicës, me arsyetimin se kjo e fundit tashmë kishte filluar gjykimin e këtij rasti dhe prandaj duhet ta përfundojë atë. Më 6 nëntor 2019, janë emëruar dy anëtarë të trupit gjykues në Gjykatën Themelore të Mitrovicës,

⁶⁸ Departamenti Special është themeluar me Ligjin për Gjykatat, 06/L-054, i cili ka hyrë në fuqi në fillim të vitit 2019. Është departament i specializuar në Gjykatën Themelore të Prishtinës dhe në Gjykatën e Apelit që merret ekskluzivisht me raste

por seanca fillestare e caktuar për 26 dhjetor 2019 është shtyrë për më 25 mars 2020, me kërkesë të prokurorit. Për shkak të kufizimeve të lidhura me pandeminë, seanca dëgjimore e datës 25 mars 2020 nuk u zhvillua. Seanca e caktuar për 7 dhjetor 2020 u anulua gjithashtu pasi u konfirmua se kryetari i trupit gjykues ishte infektuar me COVID-19. Pensionimi i gjyqtarit, në fund të prillit 2021, shkaktoi vonesa shtesë. Si përmbledhje, kanë kaluar më shumë se katër vite që kur Gjykata Supreme e ktheu rastin për rigjykim në Gjykatën Themelore të Mitrovicës më 11 qershor 2018 pa pasur asnjë progres.

Rasti Zoran Vukotić I (P 57/2019)

Më 20 prill 2017, prokuroria ka ngritur aktakuzë në Gjykatën Themelore të Mitrovicës kundër Zoran Vukotić. Ai është akuzuar me pretendime të pjesëmarrjes, si pjesëtar i forcave policore serbe dhe si roje burgu, në bashkëkryerje me pjesëtarë të tjerë të paidentifikuar të policisë serbe, në paraburgimin e paligjshëm të një numri të madh civilësh, shqiptarë të Kosovës, në burgun e Smrekovnicës në rajonin e Mitrovicës, nga maji deri në fillim të qershorit 1999, ku siç raportohet i kishte nënshtruar ata në torturë dhe trajtime të tjera çnjerëzore. Më 25 maj 2018, Gjykata Themelore e Mitrovicës ka nxjerrë aktgjykimin me të cilin të pandehurin e ka shpallur fajtor dhe ka shqiptuar dënimin me gjashtë vite e gjysmë burgim. Aktgjykimi u ankimua nga i pandehuri. Më 30 janar 2019, Gjykata e Apelit ka anuluar pjesërisht aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Mitrovicës, dhe lënda është dërguar në Gjykatën Themelore për rigjykim të pjesshëm. Pas kësaj date nuk është mbajtur asnjë seancë.

Rasti Zoran Vukotić III (P 86/2017)

Më 23 qershor 2017, prokuroria ka ngritur aktakuzë kundër Zoran Vukotić në Gjykatën Themelore të Mitrovicës. Ai u akuzua me pretendime se më 17 prill 1999, në Vushtrri, duke vepruar si pjesëtar i forcës policore serbe dhe në bashkëkryerje me pjesëtarë të tjerë të paidentifikuar të asaj force, kishte marrë pjesë në plaçkitjen e popullatës civile shqiptare të Kosovës dhe kishte vrarë një djalë 13-vjeçar shqiptar i Kosovës. Seanca fillestare është mbajtur më 15 dhjetor 2017. Pas kësaj date nuk është mbajtur asnjë seancë.

RASTE QË NUK JANË TRAJTUAR NGA EULEX-I NË TË KALUARËN⁶⁹

Rastet Stenta (PKR 40/2018)

Më 14 qershor 2016 Prokuroria ngriti aktakuzë pranë Gjykatës Themelore të Prishtinës kundër 60 të pandehurve dhe dy personave juridikë për veprat penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, marrje dhe dhënie ryshfeti, trajtim mjekësor i papërgjegjshëm, ushtrim i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore apo farmaceutike dhe shmangie nga tatimi.

Në bazë të aktvendimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës, rasti është ndarë për shkak të numrit të madh të akuzuarve të përfshirë.

Ferid Agani, ish-ministër i shëndetësisë dhe Gani Shabani, ish-sekretar i përgjithshëm i

nga Prokuroria Speciale (PSRK), gjegjësisht rastet më të rënda penale.

69 Rastet e krimeve të luftës që nuk janë shqyrtuar nga EULEX-i në të kaluarën janë trajtuar në pjesën vijuese.

ministrisë janë akuzuar në rastin *Stenta I* për keqpërdorim të pozitës zyrtare. Me aktgjykimin e shkallës së parë të prillit 2019, atyre iu ishin shqiptuar dënime prej 2 vite e gjysmë dhe 2 vite burgim, përkatësisht. Megjithatë, GJA e ktheu rastin në Gjykatën Themelore të Prishtinës për rigjykim. Në vitin 2020 nuk ishte caktuar asnjë seancë, por në qershor 2021, rasti filloi me një ritëm mjaft efikas deri në fund të korrikut, kur edhe përfundoi rigjykimi. Para se të prezantonte fjalën përfundimtare të saj, prokurorja ndryshoi aktakuzën, që vlen të theksohet, në atë se dëmi i pretenduar ndaj buxhetit të Kosovës ishte zvogëluar nga rreth 4.5 milionë euro në 11 mijë euro. Më 1 gusht, aktgjykimin u shpall dhe të dy të pandehurit u liruan nga akuzat.

Në rastin *Stenta II*, 45 të pandehur, pothuajse të gjithë mjekë, u akuzuan për shpërdorim të pozitës zyrtare në bashkëkryerje dhe për marrje ryshfeti. Më pas, ky rast është ndarë në dy pjesë: *Stenta II.1*, me shumicën e të pandehurve, dhe *Stenta II.2*, me vetëm gjashtë të pandehur, të cilët gjatë gjyqimit kanë munguar pjesërisht për shkaqe shëndetësore. Në këtë të fundit seancat janë shtyrë në vazhdimësi kryesisht pasi të pandehurit kanë munguar për arsye shëndetësore. Nga ana tjetër, *Stenta II.1* rifilloi me një seancë produktive në dhjetor 2021 dhe vazhdoi deri në maj 2022, megjithëse me ritme të ngadalta me seanca të shumta që shtyheshin për shkak të mungesës së të pandehurve. Gjithashtu, për këtë rast është dashur të caktohet një kryetar i ri i trupit gjykues për shkak të problemeve shëndetësore të kryetarit të mëparshëm, gjë që ka shkaktuar vonesa të mëtejshme.

Rasti *Stenta III* lidhet me pjesën tjetër të të pandehurve (persona fizik dhe juridik). Ata përballen me akuzat për dhënie ryshfeti, trajtim mjekësor të papërgjegjshëm, ushtrim të paligjshëm të veprimtarisë mjekësore dhe evazion fiskal, individualisht dhe në bashkëkryerje. Disa nga të pandehurit janë shtetas të huaj (p.sh. Turqia dhe Maqedonia e Veriut). Pas një periudhe të gjatë për konfirmimin e aktakuzës, seanca hapëse e shqyrtimit gjyqësor ishte dashur të mbahej në tetor të vitit 2020, por ajo u caktua për një afat tjetër dhe u shty për një kohë të pacaktuar për shkak se mbrojtja pretendonte se nuk kishte qasje në shkresat e lëndës. Në nëntor 2021, seancat u caktuan përsëri, por u shtynë për shkak të çështjeve që kishin të bënin me përkthimin e shkresave të lëndës për të pandehurit e huaj. Prandaj, lënda është joaktive pasi që përkthimi i shkresave të lëndës është ende në pritje.

Rasti Avanci (PPS 19/19)

Më 6 tetor 2020, prokuroria ka ngritur aktakuzë në Gjykatën Themelore të Prishtinës kundër personave Mendim Sojeva dhe Ganimete Gashi-Ahmeti, njëri zyrtar në Agjencinë Kosovare për Produkte Medicinale (AKPM) dhe tjetri punonjës i Ministrisë së Shëndetësisë (MSH), me pretendime për veprat penale të përvetësimit në detyrë dhe ndërhyrjes në sistemet kompjuterike. Sipas prokurorit, dëmi i pretenduar ndaj buxhetit kap vlerën mbi 1 milion euro të fituara nga keqpërdorimi i pagesave të avancit për udhëtime zyrtare jashtë vendit. Shqyrtimi gjyqësor aktualisht është në fazën e administrimit të provave. Deri në fund të periudhës raportuese, ishin mbajtur një numër i seancave, ku u thirrën shumë dëshmitarë për të dëshmuar, shumica prej tyre kishin qenë të dyshuar në fillim të hetimeve (por më vonë u liruan nga akuzat pasi nuk u gjetën prova kundër tyre në lidhje me ndonjë veprimtari të paligjshme). Rasti ka qenë aktiv që nga ngritja e aktakuzës dhe caktimi i seancave ka qenë i rregullt. Megjithatë, përkundër numrit të ulët të të pandehurve, numri i dëshmitarëve dhe provave materiale është i madh, gjë që

kontribuon për procedurë të gjatë.

Rasti Gani Rama dhe Pal Lekaj (PKR 110/2021)

Më 25 maj 2016, prokuroria ka ngritur aktakuzë kundër Gani Ramës në Gjykatën Themelore të Gjakovës. Në cilësinë e zyrtarit të Komunës së Gjakovës gjatë periudhës 2008-2012, i pandehuri dyshohet se kishte tejkaluar kompetencat e tij zyrtare në lidhje me subvencionet dhe prokurimin në dobi të tij apo të personave të tjerë, duke i shkaktuar dëm buxhet të komunës në shumë prej gjithsej 218,956,67 euro. Më 13 shkurt 2017, Gjykata Themelore e liroi nga akuza të akuzuarin me arsyetimin se nuk ishte e mundur të vërtetohej se ai kishte kryer veprën penale për të cilën akuzohej. Ky vendim u ankimua nga prokuroria dhe GJA e ktheu lëndën për rigjykim. Më 9 shkurt 2018, Gjykata Themelore përsëri e liroi të pandehurin nga akuza, me të njëjtat arsye si në shqyrtimin e parë. Prokuroria apeloj sërish dhe më 1 nëntor 2018, GJA miratoi ankimin dhe e ktheu lëndën për rigjykim të dytë, me arsyetimin se gjykata e shkallës së parë e kishte bazuar vendimin e saj tërësisht në mendimin e ekspertit financiar, i cili nuk kishte dhënë një deklaratë të qartë dhe opinion konkret në lidhje me pozitën e mbajtur dhe kompetencat e ushtruara nga i pandehuri në kohën kur janë kryer veprat e pretenduara.

Më 7 nëntor 2019, filloi rigjykimi i dytë, pasi gjykata e kishte bashkuar atë me rastin kundër ish-kryetarit të Komunës së Gjakovës dhe Ministrit të Infrastrukturës Pal Lekaj et al. (PKR 16/2018). Pal Lekaj akuzohej edhe për veprën penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar. Që nga fillimi i gjykimit të bashkuar, janë mbajtur seanca të rregullta deri në mbylljen e lidhur me COVID-19 në mes të marsit 2020. Seancat rifilluan në verën e vitit 2020 dhe më 19 shkurt 2021 Gjykata dënoi Pal Lekajn dhe zyrtarin komunal Ismet Isufin me nga një vit dhe gjashtë muaj burgim me kusht dhe Gani Ramën me një vit burg me kusht. Veli Hajdaraga është dënuar me një vit e tetë muaj burgim me kusht dhe 8 mijë euro gjobë për veprat penale të mashtrimit me subvencione dhe evazion fiskal. Dënimet me burgim nuk do të ekzekutoheshin nëse brenda afatit të verifikimit prej dy vitesh nuk do të kryenin vepër tjetër penale. Pal Lekaj, Ismet Isufi dhe Gani Rama iu ndalua ushtrimi i funksioneve në administratën publike apo shërbimet publike për një periudhë dyvjeçare nga dita e hyrjes në fuqi të aktgjykimit. Të katër të pandehurit janë obliguar që bashkërisht të dëmshpërblejnë Komunën e Gjakovës me një shumë prej 69,786 euro brenda një viti nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Më në fund, gjykata e detyroi Veli Hajdaragën të dëmshpërblejë organet tatimore në shumën 21,283 euro (tatime të papaguara) dhe 3,435 euro (kontribut pensional). Ndërkohë, të pandehurit e apeloan vendimin dhe më 23 gusht 2021, GJA vendosi një rigjykim të ri për të cilin seanca fillestare ishte caktuar më 27 tetor, por që nuk u mbajt. Më pas, seancat gjyqësore u mbajtën më 8 nëntor 2021, 13 dhjetor 2021 dhe 18 janar 2022. Më 21 janar 2022, aktgjykimi u shpall dhe të gjithë të pandehurit u liruan nga akuzat. Pas ankimit nga prokuroria, Gjykata e Apelit ka konfirmuar lirim nga akuza më 22 gusht 2022.

Rasti i Autostradës Gjilan (PPS 34/2019)

Në shkurt të vitit 2021, prokuroria ngriti aktakuzë kundër katër zyrtarëve të Ministrisë së Infrastrukturës në Gjykatën Themelore të Prishtinës për shkelje në lidhje me një proces tenderimi për ndërtimin e autostradës Prishtinë-Gjilan. Të pandehur janë Betim Reçica (ish-sekretar i Ministrisë së Infrastrukturës), Isa Berisha, Leonora Limani dhe Mirdit Emiri, të gjithë zyrtarë të Ministrisë së Infrastrukturës të përfshirë në procesin e prokurimit. Betim Reçica akuzohet për disa vepra penale, duke përfshirë ushtrim të ndikimit, keqpërdorim të pozitës apo autoritetit

zyrtar dhe pastrim parash. Tre të pandehurit e tjerë akuzohen për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar. Ky rast ka ardhur si rezultat i veprimeve hetimore të ish-Task Forcës Kundër Korrupsionit (TFAK). Ka pasur disa përpjekje për të filluar shqyrtimin gjyqësor që nga shtatori i vitit 2021, por shqyrtimi gjyqësor përfundimisht filloi më 10 janar 2022. Pas fjalës hyrëse, u caktuan seanca gjyqësore të rregullta me shumë dëshmitarë të thirrur në kuadër të procedurës së provave. Seancat ishin të gjitha produktive dhe në fund të periudhës raportuese gjykimi ishte afër fundit të marrjes në pyetje të dëshmitarëve.

Rasti 3% (P 2022/2017)

Më 28 prill 2017, prokuroria ngriti aktakuzë në Gjykatën Themelore të Prishtinës kundër Bujar Bukoshit (ish-kryeministër i Kosovës), Naser Osmanit (ish-deputet) dhe Atdhe Gashit (ish-këshilltar i Bujar Bukoshit). Të pandehurit dyshohet se kanë keqpërdorur para nga buxheti i 'donacioneve 3%' (kontribut vullnetar, kryesisht nga diaspora për mbështetjen e Kosovës) gjatë periudhës 2006-2015 (Bujar Bukoshi dyshohet për rreth 91,000 euro, Naser Osmani dhe Atdhe Gashi së bashku dyshohen për rreth 154,000 euro). Rasti ndaj Bujar Bukoshit më pas është ndarë për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore të tij, ku ai po trajtohet jashtë vendit. Më 3 dhjetor 2018, gjykata hodhi poshtë kërkesën e Naser Osmanit dhe Atdhe Gashit për hedhjen poshtë të aktakuzës. GJA refuzoi ankesat e tyre më 17 janar 2019. Më 15 gusht 2019, gjykimi filloi me seanca të rregullta deri në fund të tetorit 2019. Rasti vazhdoi më 31 janar 2020 dhe vazhdoi më tej vetëm në korrik 2020 për shkak të vonesës në dorëzimin e një raporti nga një ekspert financiar (i cili ishte kërkuar nga gjyqtari). Rasti pati vonesa të mëtejshme për shkak të pandemisë COVID-19. Vetëm në fund të tetorit dhe fillim të nëntorit 2020, gjykata ka mundur të mbajë dy seanca, pasuar nga seanca e mbajtur më 11 nëntor në të cilën gjykata ka shpallur aktgjykimin për këtë rast. Gjykatësi i shpalli fajtorë të pandehurit Naser Osmani dhe Atdhe Gashi për veprën penale të keqpërdorimit të parave. Të dy u dënuan me tre vjet burgim dhe janë urdhëruar që të kthejnë në buxhetin e Kosovës shumën prej 154,132,47 euro. Sa i përket veprës penale të evazionit fiskal, gjyqtari ka refuzuar nxjerrjen e aktgjykimin për shkak të parashkrimit absolut të veprës penale. Lënda është në pritje në Gjykatën e Apelit.

RASTE TË KRIMEVE TË LUFTËS QË NUK JANË TRAJTUAR NGA EULEX-I NË TË KALUARËN

Rasti Svetomir Bačević (PPS 108/2020)

Më 9 nëntor 2021, prokuroria ngriti aktakuzë pranë Departamentit Special në Gjykatën Themelore të Prishtinës⁷⁰ kundër Svetomir Bačević me akuza se kishte kryer krim lufte kundër popullatës civile. Aktakuza pretendonte se i pandehuri, pa qenë pjesëtar i forcave jugosllave të armatosura, kishte marrë peng një civil në periudhën korrik-gusht 1998 në fshatin Bellopojë. Gjykimi nisi me seancën fillestare më 17 nëntor 2021. Më 8 shtator 2022, Departamenti Special në Gjykatën Themelore të Prishtinës shpalli aktgjykimin me të cilin të pandehurin e shpalli

⁷⁰ Departamenti Special është themeluar me Ligjin për Gjykatat, 06/L-054, i cili ka hyrë në fuqi në fillim të vitit 2019. Është departament i specializuar në Gjykatën Themelore të Prishtinës dhe në Gjykatën e Apelit që merret ekskluzivisht me rastet nga Prokuroria Speciale (PSRK), gjegjësisht rastet më të rënda penale.

fajtor si të akuzuar dhe e dënoi me pesë vjet burgim.

Rasti Muhamet Alidema (PPS 42/2021)

Më 29 mars 2022, prokuroria ngri aktakuzë kundër të pandehurit Muhamet Alidema në Gjykatën Themelore të Prishtinës, duke e akuzuar atë me tri akuza për kryerjen e krimeve të luftës kundër popullatës civile si pjesëtar i forcave jugosllave të armatosura gjatë konfliktit të armatosur në Kosovë. Aktakuza pretendoi se (1) më 28 mars 1999, në fshatin Izbicë, i pandehuri ka marrë pjesë dhe ka kontribuar në vrasjen e civilëve, se (2) dy muaj më vonë dhe në të njëjtin vend, së bashku me pjesëtarë të tjerë të forcat jugosllave të armatosura, i ka zhvarrosur trupat dhe më pas i ka transportuar me disa kamionë në drejtim të panjohur dhe se (3) më 28 mars 1999, në të njëjtin fshat, së bashku me pjesëtarë të tjerë të forcave jugosllave të armatosura, ka kryer trajtim çnjerëzor, cenim të integritetit trupor dhe shëndetit dhe zhvendosje, plaçkitje dhe shkatërrim të pasurisë së popullatës civile.

Më 12 prill 2022, Departamenti Special në Gjykatën Themelore të Prishtinës mbajti seancën e parë fillestare dhe më vonë nxori aktvendim me të cilin konfirmoi aktakuzën kundër të pandehurit. Seanca e dytë fillestare u mbajt më 13 korrik dhe aktvendimi i kryetarit të trupit gjykues për kundërshtimet ndaj provave ishte ende në pritje.

Rasti Duško Arsić (PPS 118/2021)

Më 8 dhjetor 2021, në pikëkalimin e përbashkët Rudnicë/Jarinjë, Policia e Kosovës arrestoi Duško Arsić, i cili dyshohej si autor i krimit të luftës gjatë konfliktit të armatosur në Kosovë. Në të njëjtën ditë, Departamenti i Krimeve të Luftës i PSRK-së nxori vendimin për fillimin e hetimeve, duke e akuzuar Duško Arsić për dy pika, të dyja krime lufte kundër popullatës civile sipas nenit 142 në lidhje me nenin 22 të Kodit Penal të Jugosllavisë (KPRSFJ). Në aktakuzë thuhet se i pandehuri ka marrë pjesë në dëbimin dhe shpërnguljen me forcë të banorëve të Prishtinës dhe rrethinës, pastaj ka marrë pjesë në plaçkitjen dhe djegien e shtëpive dhe keqtrajtimin e civilëve. Ai dyshohet se e kreu këtë krim midis janarit dhe qershorit 1999 në bashkëkryerje me anëtarë të tjerë të forcave jugosllave të armatosura. Pika e dytë në aktakuzë ka të bëjë me paraburgimin, abuzimin dhe torturimin e supozuar të një të mituri 15-vjeçar më 20 prill 1999, pasojat e rënda të së cilës ishin ende të pranishme. Në fund të periudhës raportuese, rasti ishte ende në pritje në fazën e hetimit.

Rasti Časlav Jolić (PPP 23/2022)

Më 2 qershor 2022, Policia e Kosovës arrestoi Časlav Jolić, i cili dyshohej se kishte kryer krime lufte kundër popullatës civile gjatë konfliktit të armatosur në Kosovë sipas nenit 142, në lidhje me nenin 22 të Kodit Penal të Jugosllavisë (KPRSFJ), dhe nenit 3 të Konventave të Gjenevës. Në dy raste, së pari në fund të marsit 1998 dhe së dyti në maj 1998, ai dyshohej se kishte rrahur një civil shqiptar të Kosovës, ndërsa herën e dytë viktimja ishte pa ndjenja për 20 minuta si pasojë e rrahjes. Po të njëjtën ditë, Departamenti i Krimeve të Luftës në PSRK ka nxjerrë aktvendim për fillimin e hetimeve. Në fund të periudhës raportuese, rasti ishte ende në pritje në fazën e hetimit.

Rasti Milorad Đoković (PPS 47/2022)

Më 27 qershor 2022, Policia e Kosovës arrestoi Milorad Đoković, i cili dyshohej se kishte kryer krime lufte kundër popullatës civile. Një ditë më vonë, Departamenti Special në Gjykatën Themelore të Prishtinës i caktoi të pandehurit masën e paraburgimit. Ai dyshohet se ka marrë pjesë, si pjesëtar i forcave jugosllave të armatosura, në një operacion në fshatin Ozdrim më 7 maj 1999, gjatë të cilit u vranë nëntë shqiptarë të Kosovës dhe pesë të tjerë u zhdukën. Aktualisht rasti është ende në pritje në fazën e hetimeve.

Rasti Remzi Shala (P 181/2016), i njohur edhe si ‘Rasti Molla Kuqe’

Në tetor të vitit 2016, prokuroria ka ngritur aktakuzë në Gjykatën Themelore të Prizrenit kundër Remzi Shalës për krime lufte kundër popullatës civile gjatë konfliktit të armatosur në Kosovë. I pandehuri ishte pjesëtar i UÇK-së dhe dyshohet se, së bashku me gjashtë pjesëtarë të tjerë të paidentifikuar të UÇK-së, kishin rrëmbyer dhe vranë një person më 26 qershor 1998. Më 3 korrik 2019, Gjykata e shpalli të pandehurin fajtor për veprën penale të krimeve të luftës kundër civilëve dhe e dënoi me 14 vite burgim. I pandehuri e apeloj aktgjykimin. Më 26 nëntor 2019, GJA miratoi pjesërisht ankimin dhe ndryshoi aktgjykimin duke e ndryshuar dënimin në dhjetë vite burgim. Pjesa tjetër e aktgjykimit ka mbetur e pandryshuar, ndërsa ankesa e palës së dëmtuarit është refuzuar si e pabazuar. Mbrojtësi i të pandehurit kundër këtij aktgjykimi ka parashtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale. Më 2 mars 2020, Gjykata Supreme ka ndjekur kërkesën dhe i ka anuluar të dy aktgjykimet dhe e ka kthyer lëndën për rigjykim në Gjykatën Themelore të Prizrenit, ku aktualisht është në vazhdim.

Rasti Zoran Đokić (PPS 23/2018)

Më 31 maj 2019, prokuroria ngriti aktakuzë për krime lufte pranë Departamentit Special të Gjykatës Themelore të Prishtinës kundër Zoran Đokić. Pretendohet se më 28 mars 1999, në Pejë, duke vepruar së bashku me një grup të organizuar kriminal serb, të veshur me uniformë policore, paraushtarake dhe ushtarake, për të shkaktuar vuajtje të mëdha, ka cenuar integritetin trupor apo shëndetin e shqiptarëve të Kosovës dhe ka aplikuar masa të frikësimit ndaj popullatës civile të cenueshme duke plaçkitur, vranë dhe dëbuar popullsinë civile. Me këtë rast, ai dyshohet se ka hyrë në shtëpitë e shqiptarëve të Kosovës, i ka detyruar ata të largohen nga vendbanimet e tyre me familjet e tyre, u ka shkaktuar vuajtje psikike, ka konfiskuar para dhe sende me vlerë dhe i ka keqtrajtuar fizikisht dhe mendërisht.

Shqyrtimi gjyqësor filloi më 4 dhjetor 2019 dhe përfundoi, pas disa vonesave të lidhura me pandeminë, më 4 shkurt 2021 me fjalët përfundimtare të palëve. Më 11 shkurt 2021, Gjykata Themelore e Prishtinës shpalli aktgjykimin. Zoran Đokić u shpall fajtor dhe u dënua me 12 vite burgim për veprën penale të krimeve të luftës kundër popullatës civile nga neni 142 në lidhje me nenin 22 të KPRSFJ, në lidhje me nenin 3 të Konventave të Gjenevës. I pandehuri e apeloj vendimin dhe më 12 tetor 2021, GJA zhvilloi seancën e ankimit. Më 8 nëntor 2021, GJA mori vendimin duke lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë. Kundër këtij vendimi i pandehuri ka bërë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe më 15 shkurt 2022, Gjykata supreme e ka rrëzuar

atë dhe ka vërtetuar vendimin e GJA.

Goran Stanišić (PPS 14/2018)

Më 6 shkurt 2020, prokuroria ngriti aktakuzë në Gjykatën Themelore të Prishtinës kundër Goran Stanišić, me akuza për krime lufte kundër popullatës civile të kryera gjatë konfliktit të armatosur në Kosovë. Në prill 1999, i pandehuri dyshohet se ka marrë pjesë në një sulm në shkallë të gjerë të forcave jugosllave të armatosura në dy fshatra në komunën e Lipjanit dhe ka marrë pjesë në dëbimin dhe vrasjen e civilëve.

Për shkak të masave të kufizimit rreth pandemisë në mars 2020 dhe shtyrjes së mëvonshme të procedurave gjyqësore, shqyrtimi gjyqësor filloi disa muaj më vonë dhe u zhvillua në kohën e duhur. Një vonesë e shkurtër ka ndodhur në periudhën ndërmjet prillit 2021 dhe majit 2021 për shkak të pamundësisë së administratës së Gjykatës Themelore të Prishtinës që t'i sigurojë avokatit mbrojtës përkthimin e procesverbaleve të seancave të mbajtura në gjuhën serbe. Shqyrtimi kryesor ka rifilluar më 27 maj 2021 me intervistimin e dëshmitarëve. Më 30 tetor 2021, palët dhanë fjalët e tyre përfundimtare dhe më 5 tetor 2021, Gjykata Themelore e Prishtinës shpalli aktgjykimin. Goran Stanišić u shpall fajtor si i akuzuar dhe u dënua me 20 vite burgim. Seanca dëgjimore në GJA pas ankimit të bërë nga i pandehuri u zhvillua më 27 shtator 2022 dhe në fund të periudhës raportuese gjykimi i shkallës së dytë ishte në pritje.

Rasti Zoran Vukotić IV (PPS 09/2018)

Më 6 mars 2020, prokuroria ngriti aktakuzë për krime lufte kundër Zoran Vukotić në Gjykatën Themelore të Prishtinës. Është pretenduar se më 22 maj 1999, ai mori pjesë, si pjesëtar i forcës policore serbe, në një sulm sistematik të gjerë nga forcat ushtarake, policore dhe paramilitare serbe kundër popullatës civile shqiptare të Kosovës në komunën e Vushtrrisë, si dhe në dëbimin e popullatës civile shqiptare të Kosovës, ku dyshohet se kishte kryer dhunë fizike, psikologjike dhe seksuale ndaj një femre shqiptare të Kosovës. Vukotić është ekstraduar më parë nga Mali i Zi dhe është në vuajtje të një dënimi për *Rastin Vukotić I* dhe ka një numër tjetër të rasteve në pritje në faza të ndryshme në Gjykatën Themelore të Mitrovicës (rigjykimi për pjesën e *rastit Vukotić I*, për të cilin fillimisht ishte liruar nga akuza nga shkalla e parë, rigjykimi i *rastit Vukotić II* dhe gjykimi i *rastit Vukotić III*). Shqyrtimi kryesor filloi më 15 qershor 2020. Një vonesë e shkurtër ndodhi ndërmjet 1 prillit 2021 dhe 30 qershorit 2021 për shkak të pamundësisë së administratës së Gjykatës Themelore të Prishtinës për t'i ofruar avokatit mbrojtës përkthimin e procesverbaleve të seancave në gjuhën serbe. Shqyrtimi gjyqësor rifilloi më 30 qershor 2021 me fjalën përfundimtare të palëve. Më 5 korrik 2021, Gjykata Themelore e Prishtinës shpalli aktgjykimin, duke e shpallur të pandehurin fajtor sipas akuzave dhe e dënoi me 10 vite burgim.

Aktgjykimi u ankimua nga të gjitha palët. PSRK-ja dhe viktima kërkuan nga Gjykata e Apelit dënimin me 20 vite burgim, ndërsa Zoran Vukotić dhe avokati i tij, në dy ankesa të ndara, kërkuan lirim nga akuza. Më 21 korrik 2022, Gjykata e Apelit ka vendosur që lëndën ta kthejë në Gjykatën Themelore të Prishtinës për rigjykim. Më 11 nëntor, Gjykata Themelore e Prishtinës nxori një aktgjykim, duke e dënuar të pandehurin përsëri me dhjetë vjet burgim.

Rasti Zlatan Krstić/Destan Shabanaj (PPS 17/2019)

Në dhjetor 2019, prokuroria ngriti një aktakuzë në Gjykatën Themelore të Prishtinës me disa pika të akuzës kundër Zlatan Krstić dhe Destan Shabanaj, të dy pjesëtarë të forcës policore serbe gjatë konfliktit në Kosovë. Zlatan Krstić u akuzua për shkelje të rregullave të së drejtës ndërkombëtare humanitare (Konventa e Gjenevës). Është pretenduar se më 26 mars 1999, në një fshat të komunës së Ferizajt, me vetëdije dhe me qëllim, duke vepruar sipas planit dhe urdhrave të eprorëve të tij, ai mori pjesë drejtpërdrejt në një sulm kundër popullatës civile. I pandehuri dyshohet se ka marrë pjesë në keqtrajtimin e rëndë të anëtarëve të familjes Nuha, i ka larguar me dhunë nga shtëpia e tyre, i ka trajtuar në mënyrë çnjerëzore, ka marrë pjesë në shkatërrimin e paligjshëm dhe të qëllimshëm të pronës së familjes, dëbimin e 15 anëtarëve të familjes dhe në marrjen peng të katër personave dhe kontribuoi në mënyrë thelbësore në trajtimin mizor të tyre, keqtrajtimin, torturimin, gjymtimin dhe përfundimisht vrasjen e tyre. Destan Shabanaj u akuzua për shkelje të rregullave të së drejtës ndërkombëtare humanitare ndaj civilëve. Ai dyshohet se, më 1 prill 1999, urdhëroi që trupat e viktimave të luftës të varroseshin pa dinjitet dhe në kundërshtim me rregullat e luftës, duke urdhëruar pjesëtarët e tjerë të policisë që t'i zhvendosnin kufomat nga morgu i Prishtinës dhe t'i hidhnin në një varrezë masive të pashënuar.

Shqyrtimi kryesor u zhvillua gjatë gjithë vitit 2020 dhe në fillim të vitit 2021. Më 23 mars 2021, Departamenti Special në Gjykatën Themelore të Prishtinës shpalli aktgjykimin, duke i shpallur të dy të pandehurit fajtorë sipas akuzave. Zlatan Krstić u dënua me 14 vite e gjashtë muaj burgim dhe Destan Shabanaj me shtatë vite burgim. Të dy e apeluan vendimin në Gjykatën e Apelit. Më 8 nëntor 2021, Gjykata e Apelit i hodhi poshtë të dyja ankesat, duke lënë në fuqi aktgjykimin e shkallës së parë. Të dy të pandehurit kanë paraqitur kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme. Më 23 qershor 2022, Gjykata Supreme miratoi kërkesën e Destan Shabanaj dhe e liroi nga akuza. Kërkesa e bërë nga Zlatan Krstić është refuzuar.



 www.eulex-kosovo.eu

 [@eulex.kosovo](https://www.facebook.com/eulex.kosovo)

 [@eulexkosovo](https://twitter.com/eulexkosovo)

 [eulexkosovo](https://www.youtube.com/eulexkosovo)